



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*



AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

RAPORTI VJETOR

I AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

2024



Prishtinë, 2024



RAPORTI **VJETOR**

I AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

2024

Prishtinë, 2024

SHKURTESAT

AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
DL	Drejtorati Ligjor në AKK
DK	Drejtorati i Kadastrit në AKK
DFA	Drejtorati i Financave dhe Administratës
DTI	Drejtorati i Teknologjisë së Informacionit
NJIP	Njësia e Implementimit të Projekteve
ZKK	Zyrat Kadastrale Komunale
IKIH	Infrastruktura Kombëtare e Informacioneve Hapësinore
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
RK	Rindërtimi i Kadastrit
UA	Udhëzime Administrative
DRC	Qendra për Rimëkëmbje në Rast Fatkesqësish, Ang. Disaster Recovery Center
DTM	Modeli Digjital i Terrenit, Ang. Digital Terrain Model
SOA	Arkitekturë e Orientuar në shërbime, Ang. Services Oriented Architecture
SIKTK	Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë
SIKTK HK	Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë — Harta Kadastrale
SIKTK T	Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë - Tekstuale
ARIS	Sistemi i Informacioneve për Regjistrin e Adresave
SUUSHK	Sistemi i Unifikuar i Ueb Shërbimeve Kadastrale
KOPOS	Sistemi i Pozicionimit Satelitor në Kosovë
GG	Platforma e Interoperabilitetit, Ang. Government Gateway
REGIP	Projekti për Regjistrimin e Pronës dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore, Ang. Real Estate Cadastre & Geospatial Infrastructure Project
GIS	Sistemi i Informacioneve Gjeografike
ASHI	Agjencia për Shoqëri të Informacionit
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
ZGJC	Zyra e Gjendjes Civile
KGJK	Këshilli Gjygjësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
BB	Banka Botërore

1	FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV	8		
	FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV	8		
2	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	12		
	2.1 Mandati dhe përgjegjësitë	12		
	2.2 Struktura organizative	13		
3	AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE	18		
	3.1. Ligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme	18		
	3.2. Udhëzimet Administrative	19		
	3.3. Strategjia për Infrastrukturë Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH)	22		
	3.4. Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës	24		
	3.5. Udhëzuesi i punës matje, krijim, ndryshim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës)	28		
4	ORGANIZIMET/AKTIVITETET NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT NËRINSTITUCIONAL	32		
	4.1. Komitetet Ndërmimore për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor në Republikën e Kosovës	32		
	4.2. Takimet koordinuese të donatorëve	36		
	4.3. Takimet koordinuese ndërinstitucionale me kryetarët e të gjitha Komunave të Republikës së Kosovës	37		
	4.4. Komitetet për praktika të mira në kuadër të Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës	43		
	4.5. Takime koordinuese me zyrtarët e Zyreve Kadastrale Komunale	45		
	4.6. Takime koordinuese me gjeodetë dhe kompani gjeodete të licencuara	47		
	4.7. Thellimin e bashkëpunimit me Institucione të ndryshme publike nëpërmjet Marrëveshjeve të bashkëpunimit	49		
	4.7.1. Memorandumet e bashkëpunimit me Kryetarët e Komunave për Rindërtimin e Kadastrit	49		
	4.7.2. Memorandum bashkëpunimi me Shoqatën e Gjeodetëve të Shqipërisë	50		
	4.7.3. Memorandum bashkëpunimi me Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Institutin Arkeologjik të Kosovës	50		
	4.7.4. Memorandum bashkëpunimi me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit	51		
	4.7.5. Memorandum bashkëpunimi me ATRC-në në kuadër të projektit PIAKOS	52		
	4.7.6. Marrëveshje për Procedurat Standarde të Operimit mes AKK-së, ARC-së dhe ASHI-së	52		
5	PROJEKTET KAPITALE	54		
	5.1. Rilevimi aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës	55		
	5.2. Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive	61		
	5.3. Avancimi i sistemeve kadastrale	64		
	5.4. Zgjerimi i Qendrës me Hardware dhe Software	75		
	5.5. Korrektimi/përmirësimi i të dhënave në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë - Pjesa Tekstuale (SIKTK-T)	80		
	5.6. Zhvillimi i Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) dhe përditësimi i Gjeoportalit ekzistues të AKK-së	80		
	5.7. Konvertimi i të dhënave në SIKTK për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave	83		
	5.8. Analizimi, korigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaborateve të shpronësimi	84		
	5.9. Mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave	86		
	5.10. Ndërlidhja e qytetarit me adresë	87		
	5.11. Vendosja e numrave dhe emrave të rrugëve	97		
	5.12. Implementimi i Planit të Veprimit për Informim Publik	100		
	5.13. Skanimi dhe indeksimi i dokumenteve arkivore kadastrale	104		
6	ZHVILLIMET/AVANCIMET NË SISTEMET KADASTRALE DHE NGRITJA E KUALITETIT TË TË DHËNAVE	108		
	6.1. Deklarimi i adresës zyrtare të vendbanimit	108		
	6.2. Sistemi për licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete	108		
	6.3. Korigjimi i numrave kadastral (9000, 90000 dhe 0) në Hartën Kadastrale	110		
7	PËRFAQËSIMI NË KONFERENCA, PUNËTORI, GRUPE PUNUESE DHE VIZITA STUDIMORE	114		
	7.1. Konferenca "Avancimet në Digjitalizimin e Shërbimeve Kadastrale"	114		
	7.2. Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Land Portal	121		
	7.3. Pjesëmarrja në Forumin e 10-të të EUPOS	123		
	7.4. Pjesëmarrja në Konferencën Rajonale SPATIAL II	123		
	7.5. Pjesëmarrja në Konferencën Rajonale për Teknologjitë Gjeohapësinore	124		
	7.6. Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar dhe Konferencën INTERGEO	125		
	7.7. Vizita studimore në Kadastrin Holandez	126		
	7.8. Pjesëmarrja në Konferencën Vjetore të Bankës Botërore "World Bank Land Conference 2024", në Washington	126		
	7.9. Vizitë studimore në Kroaci dhe Slloveni	127		
	7.10. Pjesëmarrja në Asambleenë e Përgjithshme të EuroGeographics	128		
	7.11. Pjesëmarrja në Konferencën rajonale "Dita e Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore-2024"	128		
	7.12. Pjesëmarrja në Konferencën Regjionale për Zvogëlimin e Barrës Administrative	129		
	7.13. Pjesëmarrës në punëtorinë për implementimin e programit të legalizimit të ndërtimeve pa leje	129		
8	KOORDINIMI I PROJEKTEVE	132		
	8.1. Projekti REGIP	132		
	8.2. Bashkëpunimi me USAID-in	138		
	8.3. Bashkëpunimi me GIZ-in	138		
	8.4. Bashkëpunimi me Qeverinë Holandeze — Projekti Spatial II për Ballkanin Perëndimor	138		
	8.5. Bashkëpunimi me OSBE-në	139		
9	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	142		
	9.1. Mirëmbajtja e dhomës së serverëve	142		
	9.2. Aktivitetet rreth sigurisë	142		
	9.3. Monitorimi	145		
	9.4. Testimi i ngritjes së shërbimeve në DRC	146		
	9.5. Administrimi i Sistemeve të Informacionit (SI), databazave dhe qasjeve.	146		
10	BUXHET DHE FINANCA	148		
	10.1. Buxheti	148		
	10.2. Ndarja dhe realizimi i buxhetit	148		
	10.3. Prokurimi publik	154		

10	BUXHET DHE FINANCA _____	148
	10.1. Buxheti	148
	10.2. Ndarja dhe realizimi i buxhetit	148
	10.3. Prokurimi publik	154
11	TRAJNIMET E OFRUARA _____	156
	11.1. Trajnimet e gjeodetëve	156
	11.2. Trajnimet e stafit për ndërlidhjen e qytetarit me adresë zyrtare	156
	11.3. Trajnimet e shfrytëzuesve të SIKTK nga institucionet tjera	157
12	LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODETE _____	160
	12.1. Reformimi i procesit të licencimit	160
	12.3. Zhvillimi dhe funksionalizimi i aplikacionit për aplikim përmes e-Kosovës	160
13	MONITORIMI I ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE, KOMPANIVE TË LICENCUARA GJEODETE DHE GJEODETËVE TË LICENUAR _____	168
	13.1. Monitorimi i punës dhe aktiviteteve të Zyreve Kadastrale Komunale	168
	13.2. Monitorimi i Kompanive të licencuara gjeodete dhe Gjeodetëve të licencuar	168
14	PËRMBLEDHJE E SHËRBIMEVE DHE STATISTIKAVE PËR TË DHËNAT E OFRUARA NGA AKK _____	174
	14.1. Shpronësimi	174
	14.2. Statistika nga SIKTK	175
	14.3. Statistika për numrin e kërkesave nga institucionet	178
	14.4. Statistika nga shkëmbimi i të dhënave me institucionet e jashtme	179
15	MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN DHE GJITHËPËRFSHIRJE _____	182
	15.1. Intervistat në media	182
	15.2. Uebfaqja zyrtare e AKK-së	184
	15.3. Profili zyrtar i AKK-së në Facebook	185
	15.4. Gjeoportali shtetëror	186
	15.5. Barazia gjinore	187
	15.6. Qasja në dokumente publike	187
16	KALENDARI ME NGJARJE TË NDRYSHME _____	190

17	PËRMBYLLJE _____	214
18	PLANI I PUNËS PËR VITIN 2025 - REFORMAT DHE PROJEKTET _____	226



1 | FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV

Të nderuar/a,

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) pati përmbyllur vitin e 2023 me zotimin që viti 2024 do të jetë viti i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, zotim ky që jo vetëm që u arrit por edhe u tejkalua.

Qysh në fillimvit filluan sukseset e para, menjëherë në Janar 2024 nga Presidentja e vendit u dekretua Ligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme. Pas fuqizimit të ligjit, sukseshëm u vazhdua me hartimin dhe aprovimin e 11 Udhëzimeve administrative si dhe dy Udhëzuesve të punës, për të kompletuar kështu mes sfidash e angazhimesh për vite me radhë, reformën ligjore në fushën e kadastrit.

Po këtë vit nga Qeveria e Kosovës u aprovua edhe Strategjia për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës 2024-2028 dhe Plani i Veprimit 2024-2026, njëherit u aprovua edhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Fokusi im si Drejtor i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) këtë vit ka qenë të përmbylim me sukses ndryshimet e planifikuara në legjislacion dhe realizimin me sukses të mbi 13 projekteve kapitale. Edhe ky vit ka vënë në pah sfida e vështirësi, por që me këmbëngulje e përkushtim kemi arritur që bashkë me stafin e AKK-së, të gjejmë zgjidhje, të fokusohemi në punë, e të vazhdojmë me përkushtim për arritjen e secilës objektive të cilën ia kemi parashtruar vetes.

Këtë vit, kemi përfunduar me sukses disa prej projekteve kapitale, përfshirë Rilevimin Aerofotogrametrik të territorit të vendit, Rrjetin e nivelimit dhe Zgjerimin e Qendrës me HW+SW, e gjithashtu në faza të ndryshme të realizimit janë edhe projektet si: Zhvillimi/Avancimi i sistemeve kadastrale, Zhvillimi i Gjeoportalit, Prodhimi dhe instalimi i tabelave me adresa të rrugëve dhe numrat e hyrjeve të objekteve, Lidhja e qytetarit me adresë zyrtare, Skanimi masiv i dokumenteve arkivore kadastrale, Korrektimi i të dhënave, Konvertimi i të dhënave në SIKTK për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave, Regjistrimi i elaborateve të shpronësimit, etj. Po ashtu, këtë vit pritet që të fillojë Projekti i Rindërtimit të kadastrit, për të cilin projekt jam shumë optimist që do jetë një ndër projektet më të sukseshme të rindërtimit të realizuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), edhe për faktin se janë realizuar ndryshime të mëdha ligjore që të mundësojnë realizimin e tërësishëm të projektit.

Mbështetja dhe përkrahja ndër-institucionale, është manifestuar me mbështetje konkrete edhe këtë vit. Agjencia Kadastrale e Kosovës ka vazhduar serinë e takimeve periodike dhe ka gëzuar përkrahjen nga Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu, edhe në organizimet e Komiteteve ndërministrorë për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, gjithashtu takimeve me kryetarë të komunave e edhe takimet me gjeodetë të licencuar.

Përmes këtyre takimeve kemi shënuar një bashkëpunim të thellë e të ndërsjellë, në angazhimin e plotë të Ministrisë dhe Agjencisë për transformimin dhe fuqizimin e kadastrës në vend.

Një ngjarje shumë e veçantë e viti 2024 ishte organizimi i Konferencës së parë ndërkombëtare me tematikë “Avancimet në digjitalizimin e shërbimeve kadastrale”, me më shumë se 150 pjesëmarrës nga institucionet vendore, rajonale dhe jo vetëm, meqë pjesëmarrës kishte edhe nga institucionet e larta të kadastrit nga Turqia, Holanda, Norvegjia, Sllovenia, ekspertë të Bankës Botërore, nga USAID-I, ekspertë nga platforma “Land Portal”, si dhe akterë të tjerë nga Universiteti i Prishtinës e institucionet tjera vendore, të nivelit qëndrorë e lokal.

Duke kombinuar inovacionin, bashkëpunimin rajonal dhe mbështetjen e donatorëve, ky event i jashtëzakonshëm solli në pah arritjet e shumta të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, shkëmbime të vlefshme të përvojave e eksperiencave të ndryshme me të gjithë pjesëmarrësit dhe frymëzim për suksese të mëtutjeshme në digjitalizimin e shërbimeve dhe të ardhmen e kadastrit.

Me qëllim të avancimit të digjitalizimit të shërbimeve dhe lehtësimit të procedurave administrative për qytetarët, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka ndërmarrë një sërë inovacionesh gjatë këtij viti, disa prej të cilave janë përfunduar e disa janë në proces. Një prej tyre është edhe digjitalizimi i formës së aplikimit për licencim të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete, i cili sistem është zhvilluar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe GIZ-it ku qëllimi kryesor i sistemit është të thjeshtojë proceset e aplikimit, të rrisë transparencën dhe të mbështesë zhvillimin profesional të gjeodetëve.

Përveç kësaj, edhe në vitin 2024 ka vazhduar monitorimi i performancës së Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK), Kompanive të Licencuara Gjeodete dhe Gjeodetëve të Licencuar. Jemi në përgatitje dhe dorëzim të gjetjeve të monitorimit tek ZKK-të dhe gjeodetët e licencuar, bashkë me vërejtjet dhe rekomandimet sipas legjislacionit në fuqi.

Si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm për të garantuar cilësinë dhe saktësinë e të dhënave kadastrale, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, përfshirë korigjimin/unifikimin e personave të regjistruar dy ose më shumë herë në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë me të njëjtin numër personal, si dhe unifikimin e emërtimeve të personave juridikë.


Edhe pse viti 2024 ka adresuar një mori çështjesh dhe janë shënuar rezultate fantastike, ende mbetet punë për t'u bërë. Në vitin 2025, planifikojmë të përmbylim me sukses shumicën e projekteve të filluara vitin e kaluar. Përkundër sfidave dhe volumit të madh të punëve dhe aktiviteteve që priten për Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK), ne jemi të angazhuar të shfrytëzojmë kapacitetin maksimal për të arritur të gjitha qëllimet tona, për të realizuar me sukses të gjitha projektet, për të avancuar infrastrukturën teknike dhe për të vazhduar digjitalizimin e shërbimeve. Po ashtu, do të vazhdojmë bashkëpunimin dhe koordinimin me të gjithë partnerët tanë, vendorë dhe ndërkombëtarë, për t'u ofruar qytetarëve shërbime kadastrale të nivelit më të lartë.

Për vitin 2025, misioni dhe vizioni i Agjencisë Kadastrale do të jetë digjitalizimi i të gjitha shërbimeve kadastrale. I përqendruar në realizimin e një sistemi kadastral tërësisht të digjitalizuar si një hap kyç në ofrimin e shërbimeve më të avancuara, ky proces transformues do të mundësojë shërbime më të shpejta, më të sakta dhe më të sigurta. Duke shfrytëzuar teknologjitë më të avancuara, Agjencia do të rrisë transparencën, njëherit përmirësojë komunikimin me qytetarët dhe kontribuojë në ndërtimin e një infrastrukture kadastrale më të qëndrueshme dhe më të besueshme për të gjithë. Viti 2025 do të jetë një vit i transformimit të thellë, që do të vendosë themelin për një sistem kadastral modern e të digjitalizuar, në përputhje me standardet më të larta.

Avni AHMETI
Drejtore Ekzekutive
Agjencia Kadastrale e Kosovës



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



2

2 | PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

2.1. | Mandati dhe përgjegjësitë

Agjencia Kadastrale e Kosovës vepron si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Qeverisë së Kosovës, njëherit Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, hartografi dhe GIS, sistemin e unifikuar të adresave, infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave.


Si institucion i nivelit qendror, AKK ka kompetenca për nxjerrjen e udhëzuesve të punës lidhur me të gjitha veprimtaritë kadastrale, është përgjegjëse për trajnimin dhe certifikimin e zyrtarëve në Zyrat Kadastrale Komunale për operim në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovës (SIKTK) dhe për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete për ofrimin e shërbimeve kadastrale.

Duke u bazuar në ligjin në fuqi AKK, ka deleguar tek Zyrat Komunale Kadastrale detyrat për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave në SIKTK sipas legjislacionit në fuqi, të cilat ofrojnë shërbime për person fizik dhe juridik, si dhe për institucionet publike tashmë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Të drejtat, përgjegjësitë dhe në përgjithësi mandati i AKK-së është i rregulluar me Ligjin për Kadastër të Pronës Paluajtshme dhe me akte të tjera nënligjore, të gjitha të qasshme përmes linkut:

<https://akk.rks-gov.net/sq/dokumente/legjislacioni>.

2.2. | Struktura organizative

Struktura organizative e AKK-së është konceptuar për të garantuar efikasitet, koordinim dhe transparencë, duke reflektuar standardet më të larta të administrimit publik.



Organizimi i AKK-së përfshin pesë departamente kryesore, secila me role dhe përgjegjësi të qarta në përputhje me fushën e veprimtarisë institucionale:

- 1 Departamenti për Kadastër,
- 2 Departamenti për Gjeoinformacion,
- 3 Departamenti për Teknologji të Informacionit dhe Shërbime të Përgjithshme,
- 4 Departamenti Ligjor
- 5 Departamenti për Buxhet dhe Financa



Më poshtë do të përshkruhet shkurtimisht veprimtaria e secilit departament:

1. | Departamenti për Kadastër

Përgjegjës për administrimin, menaxhimin, mirëmbajtjen e regjistrave/sistemeve digjitale dhe analoge të informacioneve kadastrale dhe informacioneve hapësinore (SIKTK-T dhe SIKTK-HK) dhe inspektimin. Ky departament merret me mbikëqyrjen dhe monitorimin e punëve dhe aktivitete të ZKK-ve, gjeodeteve të licencuar si dhe kompanive gjeodete të licencuara, jep rekomandime, si dhe urdhëra për eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë mbikëqyrjes.

2. | Departamenti për Gjeoinformacion

Përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) dhe Gjeoportalit shtetëror, Regjistrin e Adresave përmes Sistemit të Unifikuar të Adresave (ARIS), krijimin e të dhënave hartografike, si dhe menaxhimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor të Kosovës.

3. | Departamenti për Teknologji të Informacionit dhe Shërbime të Përgjithshme

Përgjegjës për sigurimin i infrastrukturës së qëndrueshme dhe të sigurt të Teknologjisë së Informacionit, duke përfshirë Qendrën e Parë dhe të Dytë të të Dhënave, administrimin e sistemeve të informacionit, llogarive të përdoruesve, databazave dhe shërbimeve elektronike që menaxhohen nga AKK, si dhe përkrahjen nga aspekti i Teknologjisë së Informacionit për të gjithë përdoruesit nga AKK, ZKK-të dhe për përdoruesit e jashtëm të autorizuar.

4. | Departamenti Ligjor

Përgjegjës për koordinimin e procesit të hartimit të legjislacionit në fushën e veprimtarisë së AKK-së. Ky departament siguron përputhshmërinë me standardet për hartimin e legjislacionit dhe ofron këshilla ligjore e mbështetje profesionale për strukturat e tjera brenda AKK-së. Përgjegjës për koordinimin e procesit të hartimit të legjislacionit nga fushëveprimi AKK-së, duke siguruar respektimin e teknikave dhe standardeve për hartimin e legjislacionit, të ofroj mbështetje profesionale, këshilla ligjore dhe rekomandime.


5. | Departamenti për Buxhet dhe Financa

Përgjegjës për planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe rregulloret përkatëse. Ky departament luan një rol kyç në administrimin financiar të AKK-së.

AVANCIMI

KORNIZA LIGJORE

AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE



3 | AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE

Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë vitit 2024 ka hapur një kapitull të ri në fushën të cilën e mbulon duke hartuar ligjin dhe aktet tjera nënligjore me të cilat është synuar t'u jepet zgjidhje çështjeve të rëndësishme në fushën pronëso- juridike. Këtë vit është dekretuar Ligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme dhe janë miratuar 11 Udhëzime administrative për implementimin e Ligjit.

3.1. | Ligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme

Ligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme synon të eliminojë mangësitë ekzistuese, të cilat në të kaluarën kanë paraqitur problem në realizim të të drejtave pronësore.

Me Ligjin Nr.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme janë definuar shumë çështje, përfshi integrimin e dispozitave të dy ligjeve ekzistuese (Ligjin Nr.04/-L-013 për Kadastër dhe Ligjin me Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe plotësim ndryshimet e tij) dhe organizimi vertikal duke bashkuar AKK-në dhe 38 ZKK-të në një institucion të integruar, me një strukturë vertikale të menaxhimit.

Në aspektin profesional ky ligj rregullon tre elemente themelore të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm dhe avancimin e fushës së kadastrit në veçanti dhe proklamimin e të drejtave pronësore në përgjithësi.

Ligji për Kadastër të Pronës Paluajtshme adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin e kadastrës përfshi organizimin institucional të kadastrës në Republikën e Kosovës, përmbajtjen e kadastrit, matjet kadastrale, regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe të drejtave pronësore mbi ato prona në kadastër, rindërtimin e informacioneve kadastrale etj.

Elementet themelore që ky ligj i trajton dhe rregullon janë:

- Procedura e unifikuar administrative në ZKK, pasi që aktualisht ekzistojnë dy ligje (Ligjin Nr.04/-L-013 për Kadastër dhe Ligjin me Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe plotësim ndryshimet e tij), ndërsa me këtë projektligj, do të kemi një procedurë unike dhe të integruar në një sistem,
- Organizimi vertikal institucional përmes përfshirjes së Zyrate Kadastrale Komunale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës me qëllim të rritjes së performancës, përgjegjësisë në punë, bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë, duke u bazuar në sistemin kadastral të shteteve të rajonit dhe më gjerë dhe
- Trajtimi problemit më të theksuar në të drejtat pronësore që është informaliteti i lartë, ku përfshihen trashëgimit e pa kryera dhe transaksionet e pa zyrtarizuara. Formalizimi i të drejtave pronësore është synim parësor në sektorin e të drejtave pronësore pasi që të drejtat pronësore të pa formalizuara janë jashtë qarkullimit juridik, e cila do të realizohet me fuqizimin e rolit të komisionit për Rindërtimin e informacioneve kadastrale.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, miraton Ligjin për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, me datë 14.12.2023, i cili shpallet me dekretin Nr. DL-210/2023, datë 28.12.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu, ndërsa ka hy në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Data e publikimit në gazetën zyrtare 2/2024 është 09.01.2024, ndërsa datë e hyrjes në fuqi konsiderohet data 25.01.2024

Për zbatimin e këtij ligji, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues, në një periudhë afërsisht 5 mujore ka nxjerr 11 Udhëzime Administrative, prej të cilave një është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa të tjerat janë miratuar nga Ministri i Ministrisë Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu. Hartimi i këtyre udhëzimeve është bërë nga grupe profesionale të ekspertëve nga AKK, ZKK-të, gjeodetë të licencuar dhe zyrtar nga organet tjera qeveritare qendrore.

3.2. | Udhëzimet Administrative

1. Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 04/2024 për Tarifat për Produktet Shërbimet Kadastrale Gjeodezike dhe Regjistrimit të Pronave, përcakton tarifën për produktet dhe shërbimet kadastrale, gjeodezike dhe për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme, i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Tarifën e përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ kanë ndikim financiar të drejtë për drejtë të qytetarët në regjistrimin e të drejtave pronësore në kadastër.
2. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 05/2024 për Certifikimin e Personave Zyrtar për Matjet Kadastrale dhe Regjistrimin e të Dhënave Kadastrale, përcakton procedurat, kushtet dhe kriteret e certifikimit të personave zyrtar në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Zyrate Kadastrale Komunale dhe të personave zyrtar nga institucionet publike.
3. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 06/2024 për Dhënien e Lejes Kompanive Gjeodezike dhe Licencimin e Gjeodetëve, përcakton procedurat, kushtet dhe kriteret e dhënies së lejes kompanisë gjeodezike dhe licencimit të gjeodetit, emërimi, përbërja dhe puna e Komisionit për leje dhe licencim si dhe tarifën për dhënien e lejes dhe licencës.
4. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 07/2024 për Përcaktimin e Përmbajtjes së të Dhënave dhe Mënyrën e Krijimit të Njësive Kadastrale, përcakton përmbajtjen e të dhënave dhe mënyrën e krijimit të njësive kadastrale, procedurat për ndarjen, bashkimin dhe regjistrimin e parcelës, ndërtesës, pjesës së ndërtesës dhe përçojave.
5. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 08/2024 për Komisionet për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrimit të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, përcakton mënyrën e zgjedhjes dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për t'u emëruar kryesues, zëvendës kryesues apo anëtar të komisionit, apo nën komisioneve, mandatin, përgjegjësit, kompetencat dhe mënyrën e marrjes së vendimeve të Komisioneve për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrimit të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme.

6. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr.09/2024 për Përmbajtjen dhe Procedurat e Ndarjes dhe Bashkimit të Zonave Kadastrale, përcakton përmbajtjen dhe procedurat e krijimit përmes ndarjes, bashkimit si dhe ri rregullimit të kufirit të zonave kadastrale.
7. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr.10/2024 për Procedurat e Regjistrimit, Modifikimit dhe Fshirjes së Hipotekës, Barrës dhe Ngarkesave tjera, përcakton procedurat e regjistrimit, modifikimit dhe fshirjes së hipotekës, barrës dhe ngarkesave tjera në Regjistrin e të Drejtave të Pronës Paluajtshme.
8. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr.11/2024 për Procedurën e Rindërtimit të Kadastrit përcakton procedurat për rindërtimin e kadastrit, analizimin, vlerësimin dhe rindërtimin e të dhënave kadastrale dhe të dhënave në RDPP, si dhe bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe lokale për realizimin e rindërtimit të kadastrit.
9. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr.12/2024 për Matjet Kadastrale dhe Gjeodezike, Tarifën për Kryerjen e Matjeve, Formen dhe Madhësinë e Shenjave Kufitare dhe Pikave Gjeodezike, përcakton standardet për matjet kadastrale për regjistrimin ose korrigjimin e të dhënave për njësitë kadastrale në kadastër, matjeve gjeodezike për qëllime inxhinierie, matjet shtetërore, tarifën për kryerjen e matjeve dhe përcaktimin e formës dhe madhësisë së shenjave kufitare dhe pikave Gjeodezike.
10. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 13/2024 për Caktimin dhe Ri-rregullimin e Kufirit të Parcelës, përcakton kriteret, formatin, tolerancën e lejuar dhe procedurën e caktimit dhe ri-rregullimit të kufirit të parcelës kadastrale.
11. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr.14/2024 për Mënyrën e Ndërveprimit të Sistemeve dhe Përdoruesve të Jashtëm me Sistemet e Informacioneve Kadastrale, përcakton mënyrën e ndërveprimit të sistemeve dhe përdoruesve të jashtëm me sistemet e informacioneve kadastrale.

Gjatë sesioneve të punës për hartimin e këtyre Udhëzimeve Administrative në vizitë ishte edhe Ministri i MMPHI-se, Liburn Aliu, me të cilin janë zhvilluar diskutime të hollësishme mbi progresin e punës, në trajtimin e Udhëzimeve Administrative, me qëllim të finalizimit të tyre brenda një afati sa më të shkurtër kohor. Sipas tij këto udhëzime shërbejnë në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin e kadastrit, duke besuar se ky përkushtim ka krijuar kushte të favorshme për themelimin e një sistemi kadastral të rregullt e të saktë, që do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit.



3.3. | Udhëzuesi i punës për matje, krijim, ndryshim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës)

Udhëzuesi i punës për matje, krijim, ndryshim dhe regjistrim të njësive kadastrale, i nxjerrë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) në vitin 2024 është hartuar sipas Ligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme dhe Udhëzimeve Administrative të nxjerra po në këtë vit, duke adresuar një sërë çështjesh dhe procedurash për regjistrimin dhe menaxhimin e njësive kadastrale. Ky udhëzues përcakton detaje për ndarjen e bashkëpronësisë, procedurat e regjistrimit, formën dhe përmbajtjen e raporteve gjeodezike, si dhe aspektet e tjera teknike dhe ligjore që lidhen me matjen dhe regjistrimin e njësive kadastrale.

Me këtë udhëzues janë sqaruar këto çështje:

- ndarja e bashkëpronësisë në zonat urbane të krijuara deri në vitin 2019;
- përcaktimi i formatit dhe përmbajtjes së raportit gjeodezik për regjistrim të njësive kadastrale;
- përcaktimin e formës dhe mënyrës së para regjistrimit të objektit ndërtimor;
- përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së ekspertizës;
- përcaktimin e formës dhe madhësisë së shenjave kufitare dhe pikave gjeodezike;
- përcaktimin e formës dhe mënyrës së publikimit të të dhënave;
- përmbajtjes së lëndës për caktim apo ri-rregullim të kufirit,

si dhe për standardizimin e çështje të tjera për matjen, krijimin, ndryshimin dhe regjistrimin e njësive kadastrale, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka nxjerrë Udhëzuesin e punës 01/2024.

Përveç çështjeve të cekura më lartë në këtë udhëzues janë përcaktuar llojet e lëndëve të cilat krijohen dhe regjistrohen; përcaktimi i parashtrimit të kërkesës ZKK apo gjeodeti/kompania gjeodezike; formati standard i protokollit për kërkesat e pranuar nga gjeodeti/kompania gjeodezike; mënyra e krijimit të lëndës duke përshtetur secilin hap nga parashtrimi i kërkesës të gjeodeti i licencuar/kompania gjeodezike e pajisur me leje deri te dorëzimi i lëndës për regjistrim; procedurat e matjes kadastrale; shtojcat për secilin ndryshim; korigjimi i gabimeve për njësi kadastrale dhe pronarin/shfrytëzuesin; kontrollimi, trajtimi dhe regjistrimi i lëndës nga ZKK; certifikimi i instrumenteve gjeodezike; regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e barrave, ngarkesave, servitutit, hipotekës; dhe elemente tjera.

Ky udhëzues është nxjerrë në shtator të vitit 2024 dhe është hartuar në pajtim me ligjet ekzistuese, udhëzimet administrative, standarde si dhe dokumentacione tjera teknike. Në përgatitjen e këtij udhëzuesi kanë marrë pjesë zyrtarë nga AKK, Zyra Kadastrale Komunale, po ashtu edhe gjeodetët nga sektori privat dhe përfaqësues së institucioneve tjera relevante që kanë interesa të njëjta në ngritje të cilësisë së të dhënave.

Udhëzuesi është dokument teknik i detajuar për procedura dhe si i tillë është i obligueshëm për zbatim nga të gjitha palët e përfshira në proces.

Grupet që përfitojnë nga ky udhëzues janë:

- Agjencia Kadastrale e Kosovës, pasi e njëjta ka bërë standadrizimin e procedurave të lartëcekura;
- Zyrat Kadastrale Komunale, kanë një standard për kontrollimin dhe regjistrimin e njësive kadastrale dhe të ndarkesave e të drejtave, trajtimin e lëndës, aprovimin, pezullimin dhe refuzimin e lëndës;
- Pronarët e paluajtshmërive, për të kuptuar procedurat që duhet ndjekur për ndryshimet në pronën e tyre;
- Trashëgimtarët, për të kuptuar të drejtat e tyre për cilat mundësi kanë krijimin e njësive pastaj trajtimin e trashëgimisë;
- Palët tjera që mund të fitojnë të drejtën pronësore, me ç'rast kuptojnë kur kanë të drejtë të parashtrorin kërkesat e tyre;
- Gjeodetët/Kompanitë gjeodezike, kanë të përcaktuar secilin element përmbajtësor nga parashtrimi i kërkesës deri të finalizimi, mënyrën e parashtrimit të kërkesës dhe ankesës;
- Këshilli gjyqësor, duke përcaktuar formatin e ekspertizës gjeodezike që ajo të jëtë e zbatueshme pa pasur nevojë të ri-trajtohet nga gjeodeti;
- Palët tjera, në publikimin e të dhënave kadastrale, etj.

Udhëzuesi mund të gjendet në linkun në vijim:

<https://akk.rks-gov.net/storage/app/media/udhezuesi-2024-me-isbn-final.pdf>

ose skano QR-Code më poshtë.



3.4. | Strategjia për IKIH

Në vazhden e ndërtimit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës në përputhshmëri me Direktivën INSPIRE (2007/2/EC) e transpozuar në Ligjin Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, me nenin 6, pika 3 është përcaktuar hartimi i Strategjisë së IKIH për periudhën pesë (5) vjeçare me mundësi të rishikimit pas se paku tri (3) vite pas miratimit.

Strategjia për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës dhe Plani i Veprimit ka për qëllim që për qytetarin, informacioni hapësinor të jetë efektiv, i kombinuar me informacione të tjera, përkthehet në shërbime të shpejta të emergjencave në vendin e duhur, në njohjen e vendndodhjes së shërbimeve lokale, shmangien e bllokimeve në trafik dhe aftësinë për të menaxhuar më mirë jetën duke pasur qasje në informacion më të gjerë.

Për komunitetet, informacioni hapësinor mundëson financim të barabartë për rigjenerim dhe mundëson zgjidhje që problemet siç janë privimi, krimi dhe çrregullimi të trajtohen në mënyrë efektive dhe të përbashkët. Për pushtetin lokal, informacioni hapësinor mbështet partneritetet, ndihmon në ofrimin e shërbimeve publike më të mira dhe më efikase, dhe krijon efikasitet duke ndihmuar në drejtimin e burimeve të duhura në vendet e duhura; kjo nga ana tjetër i fuqizon qytetarët që të jenë më të pavarur. Për pushtetin qendror, informacioni hapësinor mbështet formulimin dhe vlerësimin efektiv të politikave; është i domosdoshëm në mbështetje të qasjes ndaj ndryshimeve klimatike, në menaxhimin e emergjencave në mbarë Kosovën.

Ky dokument strategjik i referohet praktikave të shteteve të Bashkimit Evropian në drejtim të përmbushjes së detyrimeve në procesin e integriteteve evropiane të vendit.

Bashkimi Evropian në vitin 2007 ratifikoi Direktivën INSPIRE, duke hedhur themelet për një Infrastrukturë të Informacionit Hapësinor në tërë Komunitetin Evropian. Kjo direktivë përshkruan bashkëpunimin dhe zgjidhjet kolektive për shërbimet digjitale dhe shkëmbimin e të dhënave. Kosova ka inkorporuar parimet e Direktivës INSPIRE në Ligjin e saj për Informacionin Hapësinor. Digjitalizimi në rritje në fusha të ndryshme sjell perspektiva të reja për mbledhjen, analizimin dhe krijimin e njohurive — si dhe inkurajimin e shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndërmjet palëve të interesit.

Strategjia për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës 2024-2028 dhe Plani i Veprimit 2024-2026, është hartuar në bazë të rregullave të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës, po ashtu janë marr në konsiderat rekomandimet dhe sygjerimet e eksperteve vendor dhe ndërkombëtar.




Foto 1 Struktura e qeverisjes së IKIH-së

Ky dokumenti strategjik i cili mbulon një periudhë pesëvjeçare nga viti 2024 deri në vitin 2028 dhe e përfshin Planin e Veprimit trevjeçar nga viti 2024 deri në vitin 2026, synon t'i zbatoj Objektivat Strategjike siç janë:

- Standardizimi i Informacioneve hapësinore** duke u fokusuar kryesisht në të dhënat hapësinore në kuadër të IKIH-së së Kosovës. Ai ofron detaje mbi objektivat që ndërlidhen me kontributet e të dhënave kolektive përmes infrastrukturës, duke theksuar qasshmërinë dhe hapjen, sistemin kombëtar të referimit hapësinor dhe procedurat e raportimit.
- Avancimi i Teknologjisë dhe shërbimeve** përshkruan objektivat që ndërlidhen me sigurimin e një rrjedhe të pandërprerë të të dhënave, nxitjen e zgjidhjeve të përbashkëta, ruajtjen e standardeve të sigurisë dhe cilësisë, adresimin e marrjes së të dhënave, eksplorimin e dimensioneve të reja, përmirësimin e përpunimit të të dhënave dhe përgatitjen për standardet e ardhshme.
- Bashkëpunimi** thekson nevojën për rritje të koordinimit dhe bashkëpunimit të përshtatshëm për të gjithë kontribuuesit dhe përdoruesit. Ai gjithashtu përcakton qëllimet që kanë të bëjnë me inovacionin dhe kërkimin, zhvillimin e njohurive dhe ekspertizës, dhe thekson disa parametra strukturorë.

Vizioni i kësaj strategjie është:

“Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Hapësinor (IKIH) do ta bëjë të disponueshëm informacionin hapësinor të harmonizuar dhe me cilësi të lartë për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave të komunitetit dhe që qytetarët të kenë qasje në informacionin hapësinor, qoftë lokal, kombëtar apo ndërkombëtar.”

Në Strategjinë për IKIH 2024-2028 dhe Planin e Veprimit 2024-2026, trajtohet çështja e gjendjes ekzistuese, jepen zgjidhje për përmirësimin e gjendjes ekzistuese, përfshirjen e të gjithë akterëve dhe adresimin e kërkesave të tyre në drejtim të përmbushjes së nevojave të tyre, si dhe paraqet qasjen e qeverisë ndaj Infrastruktura Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) në Kosovë duke përfshi hapin e ardhshëm drejt realizimit prioritetëve strategjike kombëtare. Strategjia për Infrastruktura Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës 2024-2028 dhe Planin e Veprimit 2024-2026 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe është në fuqi nga tetori 2024.




Foto 2 dhe 3 Miratimi ne Mbledhjen e Qeverise dhe Vendimi i Kryeministrit për miratimin e Strategjisë së IKIH-së

Strategjia mund të gjendet në linkun:

<https://akk.rks-gov.net/storage/app/media/strategjia-per-zhvillimin-e-infrastruktura-kombetare-te-informacionit-hapesinor-ikih-ne-republiken-e-kosoves-final.pdf>

ose skano QR-Code më poshtë.



3.5. Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës që nga vitit 2014 nuk ka patur rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Me miratimin e rregullores (ZKM) Nr. 13/2024 e cila ka hy në fuqi me datën 15.08.2024, është hapur rruga për standardizimin dhe përmirësimin e procesit të klasifikimit të pozicioneve të punës brenda AKK-së për të siguruar një strukturë më të drejtë dhe transparente për të gjithë punonjësit, duke vendosur kritere të qarta marrë parasysh përgjegjësitë, kompleksitetin e detyrave, dhe kompetencat e kërkuara për secilin pozicion. Ky hap përfaqëson një përpjekje të rëndësishme për të ndërtuar një mjedis pune më të drejtë dhe të balancuar për të gjithë zyrtarët e AKK-së, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe motivimit të të gjithë stafit, për të krijuar një vend pune ku të gjithë ndihen të vlerësuar dhe të respektuar.

Në kuadër të 5 departamenteve të cekura më lartë, është parapa të jenë gjithsej 14 sektorë të specializuar. Çdo sektor ka një strukturë të mirëpërcaktuar përgjegjësisish dhe kompetencash për të siguruar efikasitet maksimal në realizimin e objektivave institucionale.

Sipas rregullores aktuale, AKK-ja ka një kuotë prej 62 zyrtarësh të aprovuar, duke reflektuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhat e mëparshme. Kjo rritje pasqyron angazhimin e institucionit për të adresuar kërkesat në rritje për shërbime cilësore dhe për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm.

Struktura organizative e AKK-së është dizajnuar për të garantuar një ndarje të qartë të përgjegjësisive dhe për të mbështetur qëndrueshmërinë operacionale. Me këtë organizim, AKK-ja synon të rrisë efikasitetin, të përmirësojë transparencën dhe të avancojë cilësinë e shërbimeve për qytetarët dhe institucionet partnere.

Agjencia Kadastrale e Kosovës vepron në bazë të Rregullores me Nr. 20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, të aprovuar me datë 08.12.2014. Bazuar në këtë rregullore AKK në strukturën e saj organizative ka gjithsej 5 Drejtori dhe 14 sektorë.

Numri i të punësuarve të aprovuar nga Buxheti për vitin 2024 është 52 punëtorë. Numri aktual i të punësuarve është 46, prej tyre: 31 Meshkuj & 15 Femra.


Pozitat vakante janë pozita e asistentes në zyrën e drejtorit ekzekutiv, Drejtor i Drejtoratit Ligjor, Drejtor i Drejtoratit për Gjeoinformacion si dhe një Shef Sektori.

Në Agjencinë Kadastrale janë të angazhuar edhe njëzet e nëntë (29) zyrtarë si staf mbështetës të cilët janë të financuar nga Huamarrja e realizuar nga Banka Botrore, prej tyre janë 17 meshkuj dhe 12 femra.


Po ashtu në njësitin e adresave janë të angazhuar edhe 55 zyrtar të cilët janë të angazhuar në 34 Komuna, financuar po ashtu nga Huamarrja-BB.

Roli i tyre në AKK është shumë i rëndësishëm ata japin përkrahje në zhvillimin e projekteve të AKK-së.


Profili i moshës së nëpunësve



Gjinia e nëpunësve




Përkatësia etnike e nëpunësve





ORGANIZIMET/AKTIVITETET
NË KUADËR
TË BASHKËPUNIMIT
NDËRINSTITUCIONAL



4 ORGANIZIMET/AKTIVITETET NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL

4.1. Komitetet Ndërministrore për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor në Republikën e Kosovës

Me Vendimin Nr. 10/94 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 24 gusht 2022, është formuar Komiteti për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës. Komiteti kryesohet nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ai është organ koordinues, këshillimor dhe ushtron veprimtarinë e tij sa herë që është e nevojshme për këshillimin e autoritetit përgjegjës lidhur me Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Komitetit janë:

- Ofrimi i këshillave për orientimet kryesore lidhur me administrimin e tokave dhe zhvillimin e avancimin e sistemit të IKIH në Republikën e Kosovës;
- Identifikimi i politikave dhe çështjeve strategjike;
- Ofrimi i këshillave dhe propozimi i politikave të reja, autoriteteve përgjegjëse që kanë të bëjnë me administrimin e tokave dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor të Republikës së Kosovës;
- Koordinimi dhe monitorimi i të gjitha iniciativave brenda fushës së administrimit të tokës dhe IKIH-së me qëllim të sigurimit dhe harmonizimit të politikave nacionale, lokale, publike dhe private, promovimit të çështjeve specifike për bashkëpunim dhe partneritet publiko privat;
- Bashkëpunimi me institucionet përkatëse në hartimin e Strategjisë së Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor të Republikës së Kosovës;
- Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për kadastrë dhe zhvillim të qëndrueshëm, planit të veprimit si dhe Strategjisë për infrastrukturën kombëtare të informacionit hapësinor.

Komiteti për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2024 ka mbajtur takimin e tretë dhe katërt me radhë që nga themelimi i tij. Paraprakisht nën organizim të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, janë mbajtur takime të ndara me përfaqësuesit e institucioneve që janë pjesë e këtij Komiteti për të diskutuar dhe përcaktuar draft agjendën e takimeve të Komitetit.

Takimi i tretë me radhë është mbajtur me datë 06 qershor 2024, në hapjen e punimeve të Komiteti ka marr pjesë Zv. Ministri i MMPHI-së z. Hysen Durmishi i cili ka theksuar që administrimi më i mirë i tokës, krijimi i politikave adekuate për rritje të qëndrueshmërisë ekonomike, për siguri më të mirë si për ngritje të mirëqenies sociale dhe dhënies së mundësive ekonomike për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës etj.

Drejtori ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti ka theksuar që Republika e Kosovës është duke implementuar një infrastrukturë moderne të administrimit të tokës dhe është duke ndjekur praktikën më të mirë të shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian.

Janë shënuar edhe një varg arritjesh e plotësimeve reformash legjislative përfshirë këtu aprovimin e Ligjit për kadastrë, përgatitjen e 11 Udhëzimeve Administrative, si dhe përpunimin e Udhëzuesve dhe doracakëve të punës etj.

Në këtë takim kanë prezantuar zyrtarë të AKK-së, Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave, Ministrisë së Financave dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Temat e diskutuara ishin: Implementimi i Ligjit për kadastrë të pronës së paluajtshme, Mandati i AKKVP-së, Sistemi i Tatimit në Pronë dhe atij të vlerësimit të pronave të paluajtshme, aktivitetet në rregullimin e fushës së vlerësimit të pronave, Komasoni si proces i papërmbyllur dhe adresimi i tij.

Në takim të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Bankës Botërore, USAID - Aktiviteti i Qeverisjes së Pronës dhe përfaqësues nga institucione të tjera vendore.

Në fund të Komitetit u nxjerrën edhe disa rekomandime për aktivitetet e radhës në këtë fushë, gjëgjësisht diskutimet mbi mandatin e AKKVP-së, adresimin dhe ngritjen e çështjes së Komasonit në nivele më të lartë, ndërlidhjen me të dhënat nga Departamenti të Vlerësimit të Pronave të Paluajtshme.





Ndërsa takimi i katërt me radhë i Komitetit për Administrimin e Tokës, dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor në Republikën e Kosovës është mbajtur me datë 17 tetor 2024.

Në hapjen e këtij Komiteti para të pranishmëve në fjalën e tij, zv. Ministri i MMPHI-së, Jeton Raka, theksoi se përveç miratimit të Ligjit për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor, në mbledhjen e fundit të Qeverisë miratuar Strategjinë për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (2024-2028), si dhe Planin e Veprimit (2024-2026), të cilat synojnë të ofrojnë informacion hapësinor efikas për qytetarët. Ky informacion, në përputhje me të dhëna të tjera relevante, do të shërbejë për ofrimin e shërbimeve emergjente në kohën dhe në vendin e duhur, për identifikimin e vendndodhjeve të shërbimeve lokale, për shmangien e bllokimeve në trafik dhe do të kontribuojë në menaxhim më të mirë të jetës në përgjithësi, duke siguruar qasje më të gjerë në informacione etj.

Në fjalën e tij hyrëse, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Avni Ahmeti, theksoi se në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-010 për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor, jemi të angazhuar maksimalisht, për të implementuar një infrastrukturë moderne të administrimit të tokës, duke ndjekur praktikat më të mira të Bashkimit Evropian. Si AKK, vetëm për këtë vit kemi realizuar një sërë numër të projekteve dhe reformave legislative. Është thelbësore tani që të shqyrtojmë ndryshimet në Ligjin për Administrimin e Pushtetit Lokal, për të siguruar funksionalizimin e plotë të ligjit të ri për kadastrën, përkritazi organizimin vertikal etj.

Gjatë këtij takimi të komitetit përveç tjerash u zhvilluan diskutime të ndryshme prej zyrtarëve të AKK-së, përfaqësues të Bankës Botërore, USAID, GIZ, OSBE, UN Habitat, e Dutch Kadaster. Po ashtu, u prezantuan tema si: "Sistemi i Adresave dhe Ndërlidhja e Qytetarit me Adresë", "Praktikat e Konsolidimit të Tokës Bujqësore", "Metodat Inovative për të dhëna koherente", si dhe "Qeverisja e Pronës", ku u paraqitën ide dhe rekomandime të vlefshme që do të udhëheqin edhe aktivitetet e ardhshme.



4.2. Takimet koordinuese të donatorëve

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të asistencës financiare e zhvillimore për Administrimin e Tokës në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2024, AKK-ja ka mbajtur dy takime koordinuese me donatorë, gjegjësisht me 05 qershor 2024 dhe 16 tetor 2024.

Të pranishëm në këto takime ishin përfaqësues nga Banka Botërore, USAID - Aktiviteti Qeverisja e Pronës, OSBE, Dutch Kadaster, Drejtorati francez për marrdhënieve ndërkombëtare dhe UN Habitat. Pjesëmarrësit në këto takime diskutuan mbi fazat aktuale dhe ato të ardhme lidhur me aktivitet në fushën e kadastrit, programet ekzistuese dhe programet e reja të financimit, të cilat kanë për qëllim avancimin dhe përmirësimin e sektorëve të rëndësishëm në fushën e kadastrit. Donatorët nga ana tjetër kanë vlerësuar punën, angazhimin dhe rezultatet në projektet në realizim e sipër nga AKK-ja dhe premtuan vazhdimin e mbështetjes dhe koordinimit, me qëllim të arritjes së të gjitha objektivave të planifikuara nga AKK-ja për këtë periudhë kohore.

Takimet me donatorë do të ndihmojnë Agjencinë Kadastrale të Kosovës në planifikimin e aktiviteteve të rëndësishme, të cilat do të jenë të përqendruara në përmirësimin e sistemit kadastral, përmirësimin e infrastrukturës si dhe në mbështetje e financim të projekteve kapitale në Republikën e Kosovës.



4.3. Takimet koordinuese ndërinstitucionale me kryetarët e të gjitha Komunave të Republikës së Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë vitit 2024 ka mbajtur disa takime me kryetarë të të gjitha komunave me qëllim të koordinimit të punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta.

Me 08 mars 2024 është mbajtur takimi i dytë koordinues ndërinstitucional me Kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës. Të pranishëm në takim ishin Kryetarët e komunave, Nënkryetarët dhe Drejtorët e drejtorive të kadastrit nga shumica e Komunave të Republikës së Kosovës. Takimi është organizuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe kryesuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përfaqësues të zyrës së USAID, përfaqësues të Asocioacionit të Komunave, etj.

Takimi kishte për qëllim vazhdimin koordinimit të ngushtë me çdo Komunë për të përmbushur nevojat e qytetarëve të Republikës së Kosovës në fushën e kadastrit dhe pronës së paluajtshme. Gjithashtu gjatë takimit Kryetarët e Komunave u informuan në hollësi lidhur me aktivitetet dhe projektet e parapara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, e sidomos projekti i Rindërtimit të Kadastrit në 115 Zona Kadastrale, ku përfitues të drejtpërdrejtë nga ky projekt do të jenë qytetarët e zonave kadastrale të përzgjedhura në të gjitha Komunitat.





Takimi i radhës për informim dhe koordinim sa më të mirë me Komunitet është organizuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë bashkërisht me Agjencinë Kadastrale të Kosovës me 01 tetor 2024, duke ftuar në takim Kryetarët e të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Pjesëmarrës në takim përveç Kryetarëve të Komunave, nënkryetarëve, drejtorëve të zyreve komunale relevante, ishin edhe Shefja e kabinetit të Ministrit të Punëve të Brendshme, si dhe Drejtori i Agjencisë së Regjistrimit Civil.

Qëllimi i këtij takimi ishte që Komunitet të njoheshin lidhur me fillimin e zbatimit të projektit "Ndërlidhja e qytetarit me adresë zyrtare", i cili projekt realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Regjistrimit Civil, respektivisht Zyreve të gjendjes civile në nivel lokal.





Me qëllim të koordinimit, thellimit të bashkëpunimit dhe zgjerimit të mëtutjeshëm të komunikimit ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, u zhvillua takimi i shtatë i rregullt i Qeverisë së Republikës së Kosovës e takimi i tretë i Agjencisë me Kryetarët e Komunave të Kosovës, ku bashkë me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti, morën pjesë Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, si dhe Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti.

Gjatë këtij takimi, Drejtori i AKK-së Avni Ahmeti, theksoi disa prej reformave kryesore në kadastër, përfshirë këtu Ligjin për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, njëherit organizimin vertikal, ku theksoi rëndësinë e shqyrtimit të kërkesës për plotësim/ndryshimin e Ligjit për Administrimin e Pushtetit Lokal. Ai njoftoi për arritjet e fundme të Agjencisë, në veçanti për matjen e rreth 797,165 metrave rrugë, si dhe digjitalizimin e rreth 70,000 adresave të reja, duke theksuar se tani janë në procesin e plotësimit të adresave të tjera në komunat e mbetura.

Ahmeti shprehu rëndësinë e projektit për ndërlidhjen e qytetarëve me adresë zyrtare, i cili do të ofrojë shërbime shumë më efikase dhe do të reduktojë problemet ekzistuese. Ai uroi qytetarët dhe komunat për këtë iniciativë dhe theksoi rolin e komunave në mirëmbajtjen e sistemit të adresave, me ç'rast theksoi se tani jemi në proces të kompletimit të adresave me tabela të emërtimeve të rrugëve dhe numrave të adresave në komunat e mbetura.

"Procesi i ndërlidhjes së qytetarit me adresë është shumë i rëndësishëm, ku përmes këtij procesi, qytetarët pajisen me adresë zyrtare dhe unike, e më pas do të pasoj me ofrimin e shërbimeve më kualitative dhe më të shpejta për qytetarët, rrjedhimisht duke evituar shumë probleme që janë shfaqur deri më tani. Qëllimi kryesor i të gjitha aktiviteteve dhe mbështetjes për komuna sa i përket kompletimit të adresave, duke përfshirë edhe këtë projekt, ka të bëjë me pajisjen e qytetarëve me adresë unike dhe zyrtare.", theksoi mes tjerash drejtori Avni Ahmeti.

Ndërsa Kryeministri Kurti theksoi: "Një çështje për të cilën i gëzohemi, është projekti "Ndërlidhja e qytetarit me adresë zyrtare". Ky projekt synon përmirësimin e administratës publike dhe shërbimeve për qytetarët, duke krijuar adresa unike dhe zyrtare. Kjo do të lehtësojë proceset e regjistrimit të adresave, do të rrisë sigurinë dhe do të ndihmojë planifikimin e qëndrueshëm të komunave. Me këtë sistem, qytetarët nuk do të kenë më nevojë për dokumente shtesë për regjistrim, fatura, por do të mund të deklarojnë adresën vetëm me emërtimet zyrtare të rrugëve, duke bërë administratën më të organizuar e gjithësi edhe më efikase."





4.4. | Komitetet për praktika të mira në kuadër të Aktivitetit për Qeverisjen e Pronës në Partneritet me USAID-in dhe Komunitet

Agjencia Kadastrale e Kosovës, në bashkëpunim me USAID-in dhe komunitet, ka organizuar një seri punëtorishë në kuadër të Aktivitetit për Qeverisjen e Pronës. Qëllimi kryesor i këtyre punëtorive ishte prezantimi i rezultateve të deritanishme, identifikimi i sfidave dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e funksionimit të Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK) në fushën e të drejtave pronësore. Këto aktivitete synojnë të kontribuojnë në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve kadastrale, duke përmirësuar në këtë mënyrë mbështetjen për qytetarët dhe administratën lokale.

Në punëtori morën pjesë përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Aktiviteti për Qeverisjen e Pronës i mbështetur nga USAID-i, si dhe përfaqësues nga Zyrat Kadastrale Komunale. Diskutimet kryesore në këto punëtori u fokusuan në gjetjet e Raportit të USAID-it për ZKK-të, ku u analizuan aspekte të ndryshme të organizimit të brendshëm të zyrave, proceseve të menaxhimit të lëndëve, respektimin e afateve kohore dhe kushteve të punës.

Disa sfida me të cilat përballen ZKK-të, siç janë nevoja për përmirësimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve teknike, të cilat ndikojnë në cilësinë e shërbimeve të ofruara. Po ashtu, u dhanë rekomandime për hapat që duhet të ndërmerren në të ardhmen për të përmirësuar shërbimet kadastrale dhe për të siguruar një qasje më të lehtë dhe transparente për qytetarët.

Përmirësimi i komunikimit dhe rritja e investimeve në infrastrukturën teknologjike u konsideruan si faktorë kyç për rritjen e efikasitetit të shërbimeve.

Në përfundim të punës, u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet komunave, Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë si USAID-i, për të siguruar një sistem kadastral që shërben më mirë qytetarëve dhe përmirëson qeverisjen lokale.

Gjatë vitit 2024, USAID-i, në partneritet me Agjencinë Kadastrale dhe komunat, ka realizuar një kontroll në shtatë komuna, dhe sipas gjetjeve të këtij kontrollimi, janë organizuar takime ndërmjet USAID-it dhe komunave për të përmirësuar performancën e tyre në fushën e shërbimeve kadastrale.

Gjithashtu, janë mbajtur edhe dy takime për praktikën e mira me përfaqësuesit e komunave. Gjatë këtyre takimeve, janë trajtuar dhe diskutuar problemet që vështirësojnë regjistrimin e të drejtave pronësore në Kadastër.

USAID-i mbështet Agjencinë Kadastrale në organizimin e shumë takimeve të tjera për prezantimin e udhëzimeve administrative dhe udhëzuesve të punës.



4.5. Takim koordinues me Zyret Kadastrale Komunale

Në vazhden e takimeve dhe punës të organizuara midis AKK-së dhe ZKK-ve me mbështetje të OSBE-së, me 12,13 dhe 15 shkurt 2024 janë organizuar tre punëtori me drejtorë të ZKK-ve për prezantimin e Ligjit për kadastrë të pronave të paluajtshme dhe projekt Udhëzimeve administrative. Gjithashtu në këto punëtori u prezentuan shkurtimisht edhe punët dhe aktivitetet e ZKK-ve të realizuara në vitin 2023, statistika për numrin e lëndëve, të hyrat e inkasuara si dhe sfidat e projektet e planifikuara për vitin 2024.



Gjithashtu Agjencia Kadastrale e Kosovës me mbështetjen e USAID ka organizuar dy punëtori me karakter informues dhe koordinues me përfaqësuesit e Zyrave Komunale Kadastrale. Takimet u mbajtën më 7 dhe 12 nëntor 2024, duke përfshirë përfaqësues nga të gjitha ZKK-të në nivel të vendit. Në këto takime Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) prezantoi projektet, aktivitetet kryesore dhe udhëzuesin e punës. Përveç kësaj, u diskutuan zhvillimet më të fundit, duke përfshirë fokusin në ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, të cilat përbëjnë një përparësi kyçe të AKK-së. Në këto takime gjithashtu u theksua nevoja e rritjes së cilësisë së shërbimeve në të gjitha ZKK-të, duke identifikuar problematikat e ZKK-ve, duke sjellë rekomandime për përmirësim dhe rritje të cilësisë së shërbimeve dhe sigurimin e një trajtimi më të drejtë e transparent për qytetarët e Republikës së Kosovës.



4.6. Takime koordinuese me gjeodetët dhe kompani gjeodete të licencuara

Me qëllim të informimit dhe diskutimit, për punët dhe aktivitetet që janë duke u realizuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, me 26 qershor 2024 është mbajtur takim me përfaqësuesit e kompanive të licencuara gjeodete. Nga AKK u kërkua që kompanitë gjeodete respektivisht gjeodetët e licencuar të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet që janë duke u realizuar në mënyrë që të kemi produkte dhe dokumente sa më kualitative.



Punëtori me Gjeodetët e Licencuar për Reformën Legjislative në Fushën e Kadastrit

Ngjarja - Data	Numri i pjesëmarrësve	Donator
"Prezantimi i Ligjit për kadastër të pronave të paluajtshme dhe projekt Udhëzimeve administrative". 12.02.2024, Obiliq	52	OSBE
"Prezantimi i Ligjit për kadastër të pronave të paluajtshme dhe projekt Udhëzimeve administrative". 13.02.2024, Gjilan	43	
"Prezantimi i Ligjit për kadastër të pronave të paluajtshme dhe projekt Udhëzimeve administrative". 15.02.2024, Gjakovë	24	
"Trajnimi i zyrtarëve të ZKK-ve". 07.11.2024, Lipjan	91	USAID
"Trajnimi i zyrtarëve të ZKK-ve". 12.11.2024, Prishtinë	121	

Ministri i MMPHI-se, Liburn Aliu, dhe Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Avni Ahmeti, zhvilluan një diskutim intensiv me gjeodetët e licencuar mbi reformat kadastrale dhe arritjet gjatë periudhës së qeverisjes. Gjatë këtij takimi, u prezantua miratimi i Ligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme nga Kuvendi i Kosovës në fund të vitit 2023 dhe finalizimi i Udhëzimeve Administrative, të cilat krijuan mundësitë për krijimin e një kadastrit konkurrues rajonal, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare në vend.

Bashkëpunimi me të gjithë akterët, veçanërisht me gjeodetët, të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe përballen me sfidat e punës në terren, u vlerësua si thelbësor. Palët ranë dakord për të vazhduar bashkëpunimin e ndërsjellë dhe për të dhënë kontributin maksimal në përfundimin e procedurave të mbetura, përmirësimin e udhëzimeve dhe realizimin e projekteve të planifikuara për vitin 2024 dhe më tej.



4.7. | Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme

Marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të AKK-së dhe Institucioneve Publike kanë për qëllim përmirësimin e proceseve administrative dhe zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve publike në sektorin e kadastrës. Ky bashkëpunim është një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të shërbimeve dhe transparencës, duke lehtësuar qasjen në informacionin kadastral dhe duke rritur efikasitetin e administratës publike. Pjesëmarrësit e kësaj marrëveshjeje angazhohen për të ndihmuar njëri-tjetrin në implementimin e projekteve dhe aktiviteteve që ndihmojnë zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit kadastral në vend.

4.7.1. | Memorandumet e bashkëpunimit me Kryetarët e Komunave për Rindërtimin e Kadastrit

Me 19 Korrik 2024 është mbajtur një takim midis Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencisë Kadastrale të Kosovës me Kryetarët e Komunave. Në këtë takim të përbashkët u nënshkruan Memorandumet e bashkëpunimit mes Komunave dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës për projektin e Rindërtimit të Kadastrit.

Në këtë takim u theksua rëndësia e bashkëpunimit midis nivelit lokal dhe MMPHI-së nëpërmjet Agjencisë Kadastrale në mënyrë që projekti të zbatohet me sukses dhe që përfitimet e qytetarëve të jenë sa më të mëdha. Përndryshe pjesë e këtij projekti parashihet të jenë 32 komuna me gjithsej 115 zona kadastrale në tërë Kosovën në të cilat do të realizohet shqyrtimi i trashëgimisë, zyrtarizimi i transaksioneve joformale - shitblerje me shtrëngim duarsh, matje edhe për objekte për procesin e legalizimit dhe aktivitete të tjera që parashihen me ligj. Në kuadër të këtyre 114 zonave kadastrale përfshihen rreth 260,000 parcela dhe rreth mbi 70,000 objekte të cilat do të maten e për të cilat do të krijohet dokumentacioni i plotë për të aplikuar për legalizim.



4.7.2. Memorandum bashkëpunimi me Shoqatën e gjeodetëve të Shqipërisë

Memorandumi i Bashkëpunimit është nënshkruar me 07 mars 2024 ku palët zotohen që të organizojnë takime të rregullta, konferenca, punëtori, e gjithashtu të shkëmbejnë mes vete botimet e tyre si dhe praktikat më të mira në fushën e legjislacionit, teknologjisë dhe avancimeve tjera në ofrimin e shërbimeve sa më të mira kadastrale.



4.7.3. Memorandum bashkëpunimi me Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Institutin Arkeologjik të Kosovës

Ky Memorandum i bashkëpunimit është nënshkruar me 23 shtator 2024, me të cilin synohet që mes tjerash të lehtësohen procedurat sa i përket kontributit që mund të ofrojë AKK-ja në identifikimin e potencialit arkeologjik dhe monumenteve të trashëgimisë, përkatësisht ofrimin e mundësive teknike me anë që qasjes në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme për paraqitjen e tyre në dokumentet zyrtare, që do të jetë në interes të përbashkët për realizimin e objektivave të secilit institucion.



4.7.4. Memorandum bashkëpunimi me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit

Memorandumi është nënshkruar me datë 23 janar 2024, ku palët janë dakorduar që Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit do të marrë përsipër që të përmbushë kërkesat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës për rastet e nevojave specifike të hulumtimeve shkencore, analizave dhe studimeve të rasteve të veçuara gjeodezike duke deleguar staf akademik për përmbushjen e detyrave konkrete etj. Fushëveprimi i këtij Memorandumi gjithashtu parasheh që përveç bashkëpunimit të përgjithshëm edhe mundësinë e kryerjes së punës praktike (3 deri 6 muaj) të studentëve të Gjeodezisë të cilët ndjekin studimet në vitin e fundit akademik dhe atyre të sapo diplomuar.



4.7.5. Memorandum bashkëpunimi me ATRC-në në kuadër të projektit PIAKOS

Ky Memorandum është nënshkruar me 27 korrik 2024, dhe ka për qëllim bashkërendimin e aktiviteteve dhe koordinimin në fushën e informimit publik, sidomos gjatë implementimit të projekteve të rëndësishme të Agjencisë Kadastrale të Kosovës siç janë: Rindërtimi i Kadastrit, Finalizimi i Sistemit të Adresave, Përmirësimi i të dhënave në SIKTK, Implementimi i infrastrukturës kombëtare të informacioneve hapësinore, etj.



4.7.6. | Marrëveshje për Procedurat Standarde të Operimit mes AKK-së, ARC-së dhe ASHI-së

Ky Memorandum është nënshkruar me datë 18 shtator 2024, dhe ka për qëllim të ndërlidhjen e qytetarit me adresë zyrtare për unifikimin e përdorimit të adresave duke përjashtuar përdorimin e adresave jo zyrtare dhe jo unike. Sipas këtij dokumenti qytetarët deklarojnë adresën zyrtare duke u paraqitur në zyrat komunale të gjendjes civile ose duke deklaruar adresën përmes platformës E-Kosova.



PROJEKTET KAPITALE

5

5 | PROJEKTET KAPITALE

Në përzgjedhjen e projekteve për vitin 2024, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka ndjekur një qasje të organizuar dhe të mirëplanifikuar, duke u bazuar në analiza të thelluara të nevojave të territorit dhe zhvillimeve globale. Përzgjedhja e projekteve ka qenë pjesë e një procesi strategjik që ka synuar përmirësimin e menaxhimit të të dhënave kadastrale dhe gjeohapësinore, si dhe avancimin e infrastrukturës teknologjike dhe shërbimeve publike.

Përzgjedhja e projekteve është bërë në përputhje me disa faktorë kyç, që përfshijnë:

- Analizën e nevojave dhe kërkesave të sektorëve të ndryshëm
- Përputhshmëria me zhvillimet globale dhe standardet ndërkombëtare
- Prioriteti në avancimin e teknologjisë dhe infrastrukturës
- Kontributi në zhvillimin ekonomik dhe social

Projektet e realizuara për vitin 2024 si dhe ato në proces janë si në vijim:

- ✦ Rilevimi aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës;
- ✦ Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive;
- ✦ Avancimi i sistemeve kadastrale;
- ✦ Zgjerimi i Qendrës me HW+SW;
- ✦ Korrektimi/përmirësimi i të dhënave në SIKTK T;
- ✦ Zhvillimi i Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) dhe përditësimi i Gjeoportalit ekzistues të AKK-së;
- ✦ Konvertimi i të dhënave në SIKTK për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave;
- ✦ Analizimi, korigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaborateve të shpronësimit;
- ✦ Mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave;
- ✦ Ndërlidhja e qytetarit me adresën;
- ✦ Vendosja e numrave dhe emrave të rrugëve;
- ✦ Implementimi i Planit të Veprimit për Informim Publik dhe
- ✦ Skanimi dhe indeksimi i dokumenteve arkivore kadastrale.

5.1. | Rilevimi aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Autoriteti i Kadastrës dhe Gjeodezisë (AKK) është përgjegjës për realizimin e aero-fotografimit, krijimin e modeleve digjitale të terrenit dhe prodhimin e ortofotove. Aero-fotografimi i fundit në Kosovë u realizua në vitin 2018, ndërsa duke pasur parasysh ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur që nga viti 2018 deri në vitin 2024, është planifikuar realizimi i një projekti të ri për aero-fotografimin, me qëllim të pasqyrit të të gjitha ndryshimeve që kanë ndodhur gjatë periudhës 6 vjeçare.

Pas fillimit të projektit OE në bashkëpunim me AKK ka siguruar të gjitha lejet e nevojshme nga institucionet përgjegjëse, ku pas marrjes i është hapur rrugë fillimit të fluturimit. Gjatë kohës deri sa është siguruar leja e fluturimit është bërë edhe vendosja e pikave të kontrollit, ku gjithsej janë vendosur 300 GCP (Ground Control Points) të cilat pas shenjzimit, të gjitha matjet janë bërë me instrumente GNSS duke përdorur metodën statike. Matjet statike janë bërë në bazë të rrjetit KOPOS, që njëherit është rrjeti shtetëror.



Fluturimi është bërë me dy aeroplanë: **Cessna C208 Caravan** dhe **Cessna C208 Grand Caravan**, të cilët kanë qenë të pajisura me kamera: **Vexcel Ultracam Eagle M3** dhe **Vexcel Ultracam Osprey**.



Cessna C208 Caravan
D-FSPG
Serial nr.: 20800584
Year of manufacture: 2016



Cessna C208 Grand Caravan
D-FBSF
Serial nr.: 208B2056
Year of manufacture: 2009
2 Sensor hatches



Vexcel Ultracam Eagle M3
Serial nr.: UC-EPII-1-82416042-f100



Vexcel Ultracam Osprey 4.1
Serial nr.: 434S22717X710284-f120

Sipas specifikave teknike zona e cila ka qenë e planifikuar për fluturim, në total ka sipërfaqe:

11.050 m²



Zona e projektit përfshin:

- 25 blloqe Urbane me sipërfaqe totale prej 1,026 km²
- 5 blloqe Rurale me sipërfaqe totale 10,134 km² dhe
- 2 zona te objekteve 3D, **Prishtinë** (4.8 km²) dhe **Krushë e Madhe** (7.5 km²).



Si rezultat i projektit për këto zona kemi:

- **Aerofotografi** me mbivendoseje 70% dhe 50% për **zonat rurale** dhe 80% dhe 60% për **zonat urbane**.
- **Ortofoto** urbane me rezolucion 8cm për piksel dhe ortofoto rurale me rezolucion 15cm për piksel.
- **Modele dixhitale të sipërfaqes** (DSM) dhe të **terrenit** (DTM) me rezolucione për zona urbane 1m dhe rurale 3m.
- **Modele i ndërtesa 3D për Prishtinën** (4.8 km²) dhe **Krushë të Madhe** (7.5 km²), dhe raporte dhe dokumente përcjellës për të gjitha këto produkte.


Sipas planit të fluturimit mbi të cilin është marrë leja nga institucionet përgjegjëse janë realizuar gjithsej: 154 vija të fluturimeve për zonat urbane me lartësi të fluturimit:

1. Laposaviq 8000	9. Rahovec 8000	17. Gjilan 8500
2. Zubin Potok 8500	10. Malishevë 8000	18. Kamenicë 8000
3. Mitrovicë Vushtrri 8500	11. Skenderaj 8000	19. Suharekë 8000
4. Podujevë 8500	12. Glllogoc 8500	20. Prizren 8000
5. Istog 8000	13. Prishtinë 8500	21. Shterpcë 9500
6. Pejë 8500	14. Shtime 8500	22. Kaçanik 8500
7. Deçan 8500	15. Ferizaj 8500	23. Habi i Elezit 8000
8. Gjakovë 8000	16. Viti 8500	24. Dragash 9000

250 vija të fluturimeve për zonat rurale me lartësi të fluturimit:

RA1: 14500 ft — 15500 ft MSL
RA2: RA3: 14000 ft — 15000 ft MSL
RA4: 16000 ft — 16500 ft MSL
RA5: 15000 ft — 17000 ft MSL

Plani i fluturimit për zonat urbane dhe rurale:



Me datë 24 tetor 2024 është bërë fluturimi i fundit, ku më pas ka filluar puna në procesimin e të dhënave, e ku në thelb për orto-imazhin RA / UA, është përdorur softueri Trimble Photogrammetry, i cili përbëhet nga shumë module si:


- Matjet e GCP dhe Aero-Triangulation (moduli Match-AT)
- Krijimi i DTM përmes përputhjes së dendur (DT-Master-modul)
- Prodhimi i vetëm Ortofoto (moduli Orthomaster)
- Ortofoto-mozaik (moduli Orthovista) kurse,
- Për krijimin e ECW, është përdorur "Blue Marble - Global Mapper»

Nga këta softuer dhe module, duke e rrumbullaksuar përshkrimin e tyre janë krijuar të dhënat sipas kërkesave të ST.

Gjate kësaj faze AKK ka bërë kontrollimin e të dhënave në terren, ku janë matur 800 lokacione në të cilat ka pasur objekte apo shenjizime tek të cilat pas pranimit të produkteve janë krahasuar me të dhënat e dorëzuara dhe ka rezultuar se të dhënat e pranuar nga OE janë brenda saktësisë së kërkuar.




Krijimi i ortofotove është përfshirë edhe në Aneksin II të Direktivës Evropiane INSPIRE si e dhënë që luan një rol të rëndësishëm në paraqitjen e të dhënave të informacionit tematik dhe monitorimin e mjedisit.



Zona e Prishtinës LOD2.3 (niveli i detajeve) sipërfaqja e 4.8 km2 dhe
Zona Krushë e Madhe LOD2.3 (niveli i detajeve) sipërfaqja 7.5 km2



Shembull i produktit të ortofotos



Benefitet nga projekti i aerofotografimit Republikën e Kosovës janë të shumta:

- **Planifikimi dhe zhvillimi urban:** Këto të dhëna janë të domosdoshme për hartimin e planeve zhvillimore dhe për mbikëqyrjen e zhvillimit të infrastrukturës.
- **Menaxhimi i pasurisë natyrore:** Të dhënat mund të ndihmojnë në menaxhimin e burimeve natyrore, si dhe në vlerësimin e ndryshimeve në përdorimin e tokës, duke përfshirë mbrojtjen e mjedisit dhe pyjeve.
- **Përmirësimi i shërbimeve publike:** Me anë të analizave të ortofotove dhe modeleve digjitale, mund të rritet efikasiteti i ofrimit të shërbimeve si ujësjellës, kanalizime, dhe rrugë.
- **Përmirësimi i sigurisë dhe menaxhimit të emergjencave:** Këto të dhëna janë të dobishme për të ndihmuar në menaxhimin e situatave emergjente, si përmbytjet, zjarrin dhe fatkeqësitë natyrore, duke ofruar një pamje të saktë të territorit të prekur.
- **Mbështetje për investitorët dhe zhvilluesit e pasurive të patundshme:** Të dhënat e sakta dhe të përditësuara ndihmojnë investitorët të marrin vendime të informuara për zhvillimin e pasurive të patundshme.

Këto përfitime janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të menaxhuar mirë të Republikës së Kosovës, duke siguruar që të dhënat gjeohapësinore të jenë të disponueshme dhe të dobishme për të gjithë aktorët në nivel qeveritar dhe privat.

5.2. | Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive

Rrjeti i nivelimit dhe Sistemi referent i lartësive janë dy komponente të rëndësishme në gjeodezi dhe janë thelbësore për matjen dhe përcaktimin e lartësive në një territor.

Këto sisteme përdoren për të krijuar një strukturë të saktë dhe të standardizuar që mundëson matjen e lartësive të pikave në raport me një nivel të caktuar. AKK me përfundimin e këtij projekti ka arritur të kompletoj të gjithë rrjetin gjeodezik për territorin e Republikës e Kosovës.

Ky projekt ka përmirësuar Infrastrukturën Referente Gjeodezike në Kosovë dhe themelimin e Sistemit të Referencës Gjeodezike të Kosovës sipas shenjave të BE-së. Sistemi i Referencës Shtetërore, si një njësi e vetme, përbëhet nga sistemet e mëposhtme të referencës:

- Sistemi i referencës hapësinore (tre-dimensionale),
- Sistemi i referencës horizontale (dy-dimensionale),
- Sistemi i referencës vertikale (njëdimensionale),
- Sistemi i referencës gravimetrike.

Objektivi final në të ardhmen e afërt është krijimi i një sistemi referues vertikal modern dhe funksional në territorin e Kosovës. Projekti ka për qëllim të sigurojë një sistem të saktë dhe të besueshëm për përdorim gjeodezik në të gjithë vendin.

Projekti ka pas këto faza:

- **Rekognosimi,**
- **Monomentimi,**
- **Matja e Diferencave në Lartësi**

Rekognosimi

Rekognosimi, si faza fillestare, është ber vlerësimi dhe përzgjedhja e vendeve për shenjat e nivelimit te cilat kan kaluar sipas këtyre hapave:

- U vlerësuan kushtet gjeologjike, hidrologjike dhe gjeomorfologjike.
- U analizuan zonat për stabilitet të terrenit dhe përshtatshmëri për vendosjen e shenjave.
- Përfundimisht, u krijua një raport detajuar që përshkruan pozicionet e sugjeruara, rrugët e linjave niveluese dhe vlerësimet mbi ndërhyrjet e mundshme.

Monomentimi

Procesi i monumentimit përfshiu ndërtimin e tre llojeve kryesore të shenjave:

- **Shenjat themelore:** Të pozicionuara në mënyrë strategjike për të garantuar qëndrueshmëri dhe siguri afatgjatë.
- **Shenjat nyje:** Të vendosura në nyje të veçanta, duke lidhur seksionet e rrjetit.
- **Shenjat e zakonshme:** Të shpërndara për matje të vazhdueshme dhe për lidhje të gjitha pjesëve të rrjetit.

Këto shenja u ndërtuan duke marrë parasysh kushtet e terrenit, materialet e përdorura dhe kërkesat teknike, duke siguruar qëndrueshmëri dhe mbrojtje nga ndikimet e jashtme.



Matja e Diferencave në Lartësi

Matjet e diferencave të lartësive u realizuan në përputhje me standardet teknike sipa TER dhe metodologjitë më të avancuara. Gjatë kësaj faze:

- U përdorën pajisje dixhitale dhe optike të nivelimit për të siguruar saktësi maksimale (te përshkruhen specifikat e nivelave te cilat janë përdor).
- U ndoqën udhëzime strikte për kushtet e matjes, si distanca e shikimit, kushtet klimatike dhe mënyra e leximit.
- Matjet u kryen në të dy drejtimet për secilën vijë nivelimi, duke përfshirë kontrollin e vazhdueshëm të pajisjeve dhe ndjekjen e procedurave të standardizuara për të minimizuar devijimet.
- Rezultatet u verifikuan përmes analizave të sakta të saktësisë, duke përfshirë krahasimet e diferencave të matura dhe llogaritjet e mbylljes së poligoneve.



Rezultatet e Arritura

Një nga përfitimet kryesore është që rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive sigurojnë një nivel të lartë saktësie dhe standardizimi për matjet e lartësive. Ky standardizim mundëson krahasimin e të dhënave të ndryshme dhe krijimin e një baze të besueshme për projektet që kërkojnë precizitet të lartë.

Si përfundim kemi këto rezultate:

- **Rekognosimi:** Përzgjedhja e pozicioneve për 405 shenja nivelimi (5 themelore, 50 nodale dhe 350 të zakonshme).
- **Monomentimi:** Të gjitha shenjat u ndërtuan sipas standardeve, duke përfshirë sigurimin e stabilitetit të tyre.
- **Matjet e nivelimit:** Diferencat në lartësi u mblodhën dhe u analizuan me saktësi të lartë, duke përmbushur kërkesat teknike.

Te përshkruhet edhe pjesa e llogaritjeve, se si eshte ber me cfar metode dhe te paraqiten rezultatet dhe saktësia, po ashtu te paraqitet edhe ndonjë foto apo skic qe paraqet pjesën e llogaritjeve. Po ashtu si përfundim te ceken ne cilat rruge dhe regjioni janë vendosuar pikat, sa janë këto gjatësi, lokacioni i pikave themelore dhe te njetat te paraqiten me nje harte.

5.3. | Zhvillimi dhe avancimi i Sistemeve të Informacionit Kadastral

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka filluar me projektin Zhvillimi dhe avancimi i sistemeve të informacionit kadastral për të mbështetur biznes proceset e saj kryesore. Sistemet e përfshira në këtë projekt janë: SIKTK-T, SIKTK-HK, ARIS, Sistemi i Informacionit i Gjeodetëve, Regjistri i përçojave, SIKTK-Online dhe SIKTK-Online API.

Ky projekt synon të përmirësojë integritetin e të dhënave, performancën e sistemeve, qasjen e përdoruesve dhe ndërveprueshmërinë në këto sisteme.

Sistemet do të kenë mundësi të komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që të ndajnë të dhënat në kohë reale dhe të kenë një mënyrë më të shpejtë komunikimi, por do të ketë edhe mundësinë e komunikimit me institucione të jashtme ku cilësia e të dhënave në bazat e të dhënave do të rritet dhe transparenca. Të gjitha sistemet do të zhvillohen duke përdorur teknologjinë më të fundit dhe do të funksionojnë në versionin më të fundit të Sistemeve Operative të cilat AKK-ja ka licenca edhe për to. Sistemet do të zhvillohen dhe konfigurohen që të kenë një performancë të lartë si dhe ku performanca do të jetë e lartë kur në të njëjtën kohë një numër i caktuar përdoruesish fundorë përdorin.

Objektivi i projektit është:

- Të dhënat tematike dhe gjeohapësinore ARIS (do ta bëjmë atë të funksionojë në teknologjinë më të fundit të përdorur dhe të përmirësojmë performancën e tij)
- Zhvillimi i sistemeve të reja
- Harta Kadastrale të dhëna tematike dhe gjeohapësinore
- Sistemi informativ i gjeodetëve gjeohapësinor dhe pjesa tematike
- Regjistri i përçojave — të dhënat tematike dhe gjeohapësinore do të zhvillohen brenda SIKTK-T për të dhënat tematike dhe brenda SIKTK-HK për të dhënat gjeohapësinore
- SIKTK-Online

Ndryshimet do të përfshijnë:

- ✓ Përmirësime dhe avancime në sistemet ekzistuese
 - SIKTK-T
 - SIKTK-G (të funksionojë në teknologjinë më të fundit të përdorur dhe të përmirësojmë performancën e tij)
 - SIKTK-API në internet
- ✓ Integrimi i sistemeve për ndërveprim më të mirë
- ✓ Sigurimi i trajnimeve dhe dokumentacionit të nevojshëm
- ✓ Testimi i secilit modul dhe funksionaliteti i përgjithshëm i testimit
- ✓ Vendosja e sistemeve
- ✓ Migrimi i të dhënave për SIKTK-HK dhe ARIS
- ✓ Dorëzimi dhe transferimi i njohurive të stafi të AKK-së.

Përmirësimi i funksionalitetit të sistemeve ekzistuese: Fokusi është të bëhen ndryshime në sistemet e informacionit për administrimin e tokës, për të rritur performancën dhe menaxhimin e cilësisë së të dhënave për të gjitha sistemet. Disa nga sistemet e informacionit janë të teknologjisë së vjetër të përdorur dhe duhet të përmirësohen me teknologjinë më të fundit në mënyrë që të kenë funksionalitetet e reja dhe performancën më të mirë. Një tjetër përmirësim i sistemeve është ndryshimi i rrjedhës së punës për ta bërë më të lehtë dhe më fleksibël për t'u përdorur.

Përmirësimi i ndërveprimit të sistemit, veçanërisht me sistemet e jashtme: Nga ato komunikime aktuale me sistemet e jashtme kemi parë se cilësia e të dhënave është rritur dhe përpunimi i të dhënave është shumë i shpejtë. Ai i ndihmon përdoruesit fundorë që të dhënat nga sistemet e jashtme të jenë plotësisht të vërtetuara dhe të përditësuara. Ne jemi të fokusuar të rrisim numrin e institucioneve publike dhe private për të komunikuar me to në kohë reale, pasi shkëmbimi i të dhënave do të jetë me cilësi të lartë dhe të gjithë aktorët e tjerë do t'i marrin të dhënat në mënyrë të lehtë dhe të shpejtë.

Ridizajnimi i modelit të të dhënave, në përputhje me standardin ISO 19152 LADM: Disa nga bazat e të dhënave aktuale janë në përputhje me standardin LADM, por ende kanë nevojë për disa përmirësime dhe përmirësime për t'u përmbushur më së miri me standardin LADM.

5.3.1 | SIKTK-T (Tekstuale)

Ky sistem është krijuar për të mbajtur informacionin tekstual të kadastrit, ndërsa SIKTK-T SOA si i tërë sistemi është projektuar që të jetë një sistem i centralizuar për të gjitha sistemet. Karakteristikë tjetër në sistemin kryesor SIKTK-T SOA do të jetë mundësia për të menaxhuar përdoruesit për SIKTK-T, SIKTK-HK, ARIS dhe çdo nënsistem tjetër në mënyrë që të menaxhohen privilegjet e përdoruesit për nënsisteme të ndryshme. Gjatë komunikimit me SIKTK-HK do të ketë mundësi që numrat kadastralë të cilët janë krijuar në SIKTK-HK të kenë të njëjtat numra kadastral të krijuar në sistemin informativ tekstual SIKTK-T dhe të validohen sipërfaqet e njësive Kadastrale në mes të sistemeve.

Disa nga funksionet që do të ketë ky sistem pas avancimit:

- Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës — banimi dhe terasë
- Pëlqimet nga bankat për njësitë që kanë hipoteka në formë digjitale
- I njëjti zyrtarë nuk mund të jetë edhe përpunues edhe verifikues
- Ridizajnim i certifikatave të pronës (për person dhe për njësi kadastrale)
- Butoni “Ndrysho pronarët” për të gjitha llojet e bartjeve
- Butoni “Transfero të drejtat” përveç hipotekave do të barten edhe pronarët
- Ngarkimi i dosjeve edhe në refuzim të lëndës
- Aktvendimet:
 - ✓ Aktvendim Pezullues për plotësim të dokumentacionit
 - ✓ Aktvendim për përfundimin e procedurës administrative (refuzohet lënda)
 - ✓ Aktvendim për pezullim të përkohshëm të procedurës

- Validimi i sipërfaqes së njësisë kadastrale me SIKTK-HK
- Validimi nëse njësia kadastrale është në përpunim në SIKTK-HK dhe anasjelltas
- Ekzekutimi i procesit në SIKTK-HK, njësitë e njejta do të krijohen në SIKTK-T
- Njoftime në kohë reale për kërkesat e reja që vijnë nga bankat dhe institucionet tjera
- Lloje të reja të statistikave
- Bashkimi i njësive kadastrale me të drejta të ndryshme
- Bartja e servitudit tek lloji i lëndës “Ndarje”
- Mbyllja e lëndëve në mënyrë automatike kur kalojnë 2 muaj dhe nuk ka njësi kadastrale në lëndë ose nuk ka aktvendim
- Lloji i ri i së drejtës për mbajtjen e përjetshme
- Para-regjistrimi i ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës
- Mundësia e printimit të përmbledhjes së lëndës me qëllim të ruajtjes së arkivit fizik ose zëvendësimit të librave të kuqe
- Validimi nëse zyrtari është në pushim vjetor/mjekësorë/lindjes të mos mund të qaset në system
- Lëndët që kalojnë afatet ligjore, do të hapen për përpunim vetëm ato, e do të bllokohen lëndët tjera
- Ndërlidhja me sistemin e intranetit që lëndët dhe dosja e skanuar të vijë komplet në SIKTK
- Ruajtja e radhës për të gjitha kërkesat dhe procesimi i tyre sipas sistemit FIFO, e para për nga koha do të procesohet me radhë

Një tjetër komunikim është edhe me noterët që të gjitha lëndët të vijnë në formën digjitale nga të gjithë noterët në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në këtë mënyrë palët nuk kanë nevojë që kërkesat t'i dorëzojnë në formë fizike në zyret Kadastrale komunale. Ndër veçoritë tjera janë edhe funksionet:

- Marrja e informacioneve kadastrale në kohë reale
- Dërgimi në formë digjitale të kërkesës nga noteri direkt në ZKK, duke dërguar të dhënat e kërkesës dhe dokumentet e bashkëngjitura të skenuara (aktin noterial, dokumentet e identifikimit, etj)
- Mundësia e komunikimit me noterët (chatting)
- Mundësia e përpunimit të lëndëve nga ZKK vetëm nga kërkesat e noterëve
- Largimi i shënimit të noterit
- Palët nuk paraqiten në ZKK fizikisht
- Pagesa e tarifave administrative (akoma nuk është vendosur)

Zhvillimi i mëtejshëm dhe ndërveprimi i sistemeve digjitale me regjistrat dhe sistemet e tjera me institucionet e jashtme, si:

- ATK
- Noterët
- Përmbauesit
- Këshilli gjyqësorë i Kosovës
- Këshilli prokurorial i Kosovës
- Urbanizmi për parcelat që jep leje ndërtimore, që të pasqyrohen në pjesën tekstuale dhe grafike.

5.3.2. | SIKTK-HK (Harta Kadastrale)

Sistemi i zhvilluar është i bazuar në ueb me një bazë të dhënash të centralizuar. Sistemi përmban të gjitha mjetet e nevojshme për mirëmbajtjen e të dhënave gjeohapësinore (harta kadastrale) bazuar në legjislacionin në fuqi (ligje, udhëzime administrative, korniza pune dhe manuale). Përdoruesit do të jenë në gjendje të kryejnë të gjitha operacionet bazë të administrimit të sistemit, menaxhimit të përdoruesve dhe menaxhimit të rasteve. Gjithashtu, importimi i të dhënave nga disa formate të ndryshme si dhe përpunimi i të dhënave kadastrale në hartë.

Më poshtë janë të dëmtuara disa nga funksionalitetet bazë të sistemit:

- Shikoni në hartë
- Administrimi i përdoruesit
- Administrimi i aplikacionit
- Administrimi i veçorive
- Funksionet bazë për redaktimin e të dhënave gjeohapësinore (kopjimi, zhvendosja, shtimi, fshirja, etj.)
- Menaxhimi i rasteve dhe procesimi i tyre.


Meqenëse SIKTK-HK është një nënsistem për mirëmbajtjen e të dhënave kadastrale hapësinore, është gjithashtu e rëndësishme që të kemi performancën më të mirë në shumë përdorues që përdorin sistemin në të njëjtën kohë, siç do të jetë testi i ngarkesës në çdo proces të vetëm do të ketë këtë nënsistem për të siguruar që performanca e ngarkesës.

Disa nga funksionalitetet e avancuara të sistemit janë renditur më poshtë:

- Moduli i importit dhe eksportit të të gjitha veçorive të njësisë kadastrale, të formatit: ITF, Shapefile, DWG, GML dhe CSV
- Krijimi manual i të gjitha veçorive të njësisë kadastrale (metadata)
- Redaktimi manual i të gjitha veçorive të njësisë kadastrale (metadata)
- Redaktimi/Zëvendësimi automatik i të gjitha veçorive të njësisë kadastrale brenda një zone kadastrale
- Kontrolli i cilësisë dhe korrektësia e të dhënave të redaktuara (ndryshimi i të dhënave)
- Teknologjia e avancuar, duke përdorur teknologjinë më të fundit të ditëve të sotme për menaxhimin e të dhënave hapësinore
- Leximi i të dhënave 3D (ndërtimi i të dhënave si 3D, DTM, DSM)
- Ndërveprueshmëria me sistemin e gjetodetëve
- Mundësia e krijimit të një manuali sipas kornizës së punës për të gjitha llojet e rasteve të përshkruara në Kornizën e Punës 2020/01
- Ndërveprueshmëria me SIKTK-T me të gjitha të dhënat e tjera që nuk janë tani (që quhen vende, data e përditësimit, të drejtat, etj.)
- Ndërveprueshmëria me ARIS
- Ndërveprueshmëria me module të tjera si vizualizimi i linjave të ndërtimit, linjave rregulluese etj.

- Shfaqja e të gjitha versioneve të Orthofotos (2001, 2004, 2009, 2012, 2018, 2024)
- Përpunimi i lëndëve në bazë të radhës (FIFO)
- Modeli i zakonshëm i gjeometrisë (modeli i të dhënave topologjike)
- Performancë të madhe në procesimin e të dhënave
- Ngarkimi i dokumenteve të nevojshme për secilin proces
- Ngarkimi i matjeve origjinale
- Validimi me SIKTK-T
- Validimi i të dhënave kur futen në sistem
- Komunikimi digjital me sistemin e gjeodetëve
- Azhurimet për servitute
- Mundësia e ndryshimit automatik i kufirit të zonës kadastrale ose kufirit të komunës gjatë ndryshimit të kufirit të parcelave në kufi të ZK ose komunës
- Shfaqja e parcelave të cilat kanë leje ndërtime, si shtresë e veçantë.

Në figurën e mëposhtme mund të shihni si do të duket sistemi i ri SIKTK-HK:




5.3.3. | ARIS (tekstuale dhe grafike)

Regjistri i adresave ka këto karakteristika:

- Aplikacion i bazuar në ueb, që përmban funksione të redaktimit të GIS të bazuar në rregulla
- Aftësi të mjaftueshme në komunat që nuk kanë kapacitetet e nevojshme të komunikimit në rrjet
- Aftësi të njohura GIS për vizualizimin e të dhënave gjeohapësinore, kërkimin e të dhënave hapësinore, kërkimin etributeve, kontrollin e cilësisë dhe raportimin hartografik të produktit.

Sistemi i Informacionit të Regjistrimit të Adresave (ARIS) përbëhet nga komponentë të shumëfishtë të porositur dhe jashtë raftit, të cilët përfshijnë Regjistrin e Adresave, SIKTK-G, GeoServer dhe GeoWebCache. Ekziston gjithashtu një dyqan të dhënash për secilin komponent.

Në figurën e mëposhtme mund të shihni se si duket sistemi i ri ARIS:



5.3.4. | Sistemi Informativ i Gjeodetëve

Ky sistem do të jetë i vendosur në serverët e AKK-së, dhe AKK do të marrë përgjegjësinë për publikimin e tij për të qenë i aksesueshëm nga jashtë rrjetit qeveritar ose brenda rrjetit qeveritar përmes VPN. Ky sistem do të ndihmojë kompanitë gjeodete dhe gjeodetët e licencuar të bëjnë ndryshime në rastet e tyre, duke përdorur këtë sistem ata do të mund të shohin në kohë reale të dhënat gjeohapësinore dhe tematike për njësitë kadastrale, do të përzgjedhin njësitë për përpunim, do t'i ndryshojnë ato. dhe ruani në një bazë të dhënash të ndarë nga ajo reale, atëherë ZKK-ja do t'i aprovoj ato. Përpunimi i të dhënave nënkupton të dhënat gjeohapësinor dhe tematike.

Ky sistem konceptualisht duhet të jetë si një mini SIKTK-HK, ku përdoruesit mund të kenë qasje në veçoritë bazuar në atë që është dhënë gjatë menaxhimit të përdoruesve në menaxhimin e përdoruesve nga AKK.


Të krijohet mundësia që gjeodetët e licencuar të kenë qasje (moduli për gjeodetë të licencuar) në SIKTK. Gjeodetët e licencuar duhet të jenë në gjendje të shkarkojnë të dhënat (koordinatat e pikave, kufijtë e parcelave, ndërtesat, pjesët e ndërtesave, etj.) kjo duhet të bëhet me një parapagim, ku pas shkarkimit të të dhënave dhe përfundimit të matjeve në terren, ata do të mund të përgatisin lëndën dhe e regjistron të njëjtin në SIKTK, ku së bashku me lëndën e skanuar, gjeodeti ia dërgon ZKK-së për kontroll dhe aprovim. Kjo duhet të mundësohet duke lidhur protokollin e ZKK-së me SIKTK ku sistemi ka mundësi të gjenerojë numrin e protokollit në momentin e krijimit të procesit.

Moduli për gjeodet të licencuar duhet të ketë mundësinë e gjenerimit të manualeve për ndarje, bashkim, ndërtesë, pjesë të ndërtesave sipas standardeve të përcaktuara me kornizën e punës së AKK-së dhe kjo të mund të ndryshohet sipas ndryshimeve që mund të bëhen në Kornizën e Punës.

Sistemi informativ i gjeodetëve pas krijimit pasi ky sistem nuk ekziston, posaçërisht për gjeodetët dhe kompanitë gjeodete, ky sistem do të dizajnohet për të ofruar qasje në kohë reale në të dhënat gjeohapësinore dhe informacionin tekstual kadastral, për të përmirësuar proceset e rievimit dhe për të siguruar kanale efektive të komunikimit me Zyrën Kadastrale Komunale ose AKK-në. Në fokusohemi në përmirësimin e integritetit të të dhënave në terren dhe thjeshtimin e procesit të përditësimeve dhe verifikimeve kadastrale. Meqenëse ky nënsistem do të përdoret jashtë AKK-së, ne do t'i kushtojmë vëmendje në sigurinë e të dhënave se si do të miratohen, vërtetimit me dy faktorë dhe niveleve të tjera të sigurisë për të siguruar që gjithçka në këtë nënsistem të jetë mjaft e sigurt. Ky sistem është krijuar nga e para ku ne do të dizajnojmë një bazë të dhënash dhe do të bëjmë të gjitha komunikimet e nevojshme me SIKTK-HK dhe SIKTK-T në mënyrë që të marrim në kohë reale të dhënat, mundësinë për t'i ndryshuar ato dhe për t'i dërguar përsëri në SIKTK-HK për t'u aprovuar nga zyrtarët e ZKK-së. Ky sistem do të ketë disa nga veçoritë e SIKTK-HK, kështu që ne do t'i kufizojmë ato veçori dhe funksionalitete vetëm ato që duhet të përdoren nga gjeodetët.

Këto veçori do të rrisin funksionalitetin dhe efikasitetin e modulit të gjeodetëve, duke siguruar integrimin dhe funksionimin brenda sistemit kadastral.

Në figurën mëposhtme shfaqet arkitektura e komunikimit të sistemit për gjeodetë:



5.3.5. | Regjistri i përçojave (tekstuale dhe grafike)

Regjistri i përçojave është një regjistër bazë i infrastrukturës publike e cila përfshinë rrjetin mbitorësor dhe nëntokësor së bashku me të gjitha objektet dhe pajisjet e nevojshme për funksionin e tyre dhe të drejtave pronësore lidhur me to.

Bazuar në Udhëzimin administrativ MMPHI NR. 07/2024 për përcaktimin e përmbajtjes së të dhënave dhe mënyrën e krijimit të njësive kadastrale, përçoja përmban të dhëna mbi:

- llojin e përçojës;
- karakteristikat themelore teknike;
- pozitën, skicën e vendit dhe listën e parcelave të caktuara ku kalon përçoja;
- emri dhe adresën e pronarit

Baza e të dhënave të kadastrës së përçojave është një grup i të dhënave gjeohapësinore dhe të dhëna të tjera për përçoja, të drejtat pronësore që u takojnë atyre dhe bartësit e të drejtave pronësore.

Përçojat si njësi kadastrale ndahen si në vijim:

- linjat telefonike të sistemeve të telekomunikacionit dhe linjat publike për sinjalizim,
- kontrollim, komunikim të të dhënave apo qëllime të ngjashme;
- linjat e tensionit të lartë dhe të ulët të energjisë elektrike;
- gypat e ujësllësit, ujitjes, ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike;
- linjat nëpërmjet të cilave kalon ngrohja, nafta, gazi apo ndonjë material apo prodhim tjetër
- prej pikës prodhuese, depos apo pikës së grumbullimit.

Aktualisht, AKK-ja nuk posedon të dhëna për përçojat, andaj as pjesën e të dhënave gjeohapësinore as baza tematike e të dhënave nuk është krijuar për të ruajtur këto të dhëna. Këto të dhëna, duhet të ruhen në bazën e të dhënave të SIKTK-T dhe të gjitha ato të dhëna të përpunohen përmes sistemit SIKTK-T dhe menaxhimit të lëndëve. Të dhënat gjeohapësinore duhet të ruhen në bazën e të dhënave SIKTK-HK dhe ato të dhëna të përpunohen përmes sistemit SIKTK-HK.

Disa funksione të tjera që përfshin ky sistem:

- Mundësinë e ngarkimit të të dhënave për përçojat
- Editimin e përçojave
- Dhënie të të dhënave të përçojave për SIKTK-T dhe shfaqja e të dhënave në certifikata pronësie
- Dhënie të të dhënave të përçojave për SIKTK-HK, shfaqja e të dhënave në kopje plani dhe shfaqja e shtresave të veçanta në SIKTK-HK
- Shfaqjen e përçojave në gjeoportali

5.3.6. | SIKTK-Online

Aktualisht AKK ka një sistem SIKTK-Online ku është publik dhe i aksesueshëm përmes internetit. Qëllimi është avancimi i tij, në mënyrë që të përballojë kapacitetet dhe funksionet e nevojshme për aksesin e jashtëm për të gjithë përdoruesit, bazuar në kredencialet që ofrohen dhe menaxhohen përmes sistemit UCWSS.

SIKTK-Online pas avancimit: Ne synojmë të avancojmë SIKTK-Online me një ndërfaqe të përmirësuar të përdoruesit dhe shërbime të zgjeruara elektronike. Fokusi ynë është në përmirësimin e aksesit të të dhënave dhe përvojës së përdoruesit, duke siguruar shërbime me cilësi të lartë për noterët, topografët, ekzekutuesit privatë, gjykatat dhe palët e tjera të interesuara. Ne integrojmë masa të avancuara sigurie dhe sigurojmë që sistemi të jetë intuitiv dhe efikas për përdorim publik. SIKTK-Online do të ketë aftësinë për të menaxhuar shërbimet bazuar në rolin e përdoruesit dhe t'i bëjë ato të aksesueshme cilido shërbim që i është caktuar rolit të përdoruesit. Qasja jonë është se zgjidhja më e mirë për këtë nënsistem është e bazuar në role, dhe çfarëdo shërbimi që i caktohet përdoruesit nga sistemi UCWSS, ato shërbime automatikisht mund të aksesohen nga SIKTK-Online.

Kjo zgjidhje gjithashtu ndihmon institucionet e jashtme të aksesojnë shërbimet sa herë që nuk kanë mundësi të konsumojnë API-të. AKK do t'i ketë të dyja metodat për konsumimin e shërbimeve përmes SIKTK-Online nga ana e klientit ose me API përmes SIKTK-API.


Institucionet e jashtme që përdorin sistemin SIKTK-Online do të kenë mundësinë që:

- Qasja në informacione të përditësuara për njësitë kadastrale.
- Regjistroni rastet për kalimin e pronësisë.
- Ngarkoni dokumentet e nevojshme për rastet.
- Dorëzoni lëndët e përfunduara në Zyrën Kadastrale Komunale (ZKK) për miratim.
- Komunikoni me ZKK-në përmes një funksioni chat për të diskutuar rastet dhe për të zgjidhur pyetjet.

Në sistemin SIKTK-Online do të zhvillohen të gjitha komunikimet për regjistrim, modifikim dhe fshirje të hipotekave, dhe për të gjitha institucionet që nuk kanë një sistem të vetin, mund të përdorin këtë sistem.

Në këtë sistem do të përdorin edhe institucionet e jashtme si noterët, përmbartuesit, KGJK, KPK, etj që të mund të dërgojnë dhe komunikojnë në kohë reale me sistemet e informacioneve Kadastrale.

Në figurat mëposhtë mund të shihni si duket ky sistem:



5.3.7. | SIKTK-API

AKK zotëron aplikacionin UCWSS i cili menaxhon API-të që AKK u ofron institucioneve të tjera jashtë AKK-së. Disa nga API-të konsumohen edhe jashtë këtij aplikacioni. Qëllimi është të unifikohen API-të në mënyrë që të gjitha API-të jashtë AKK-së të mund të publikohen vetëm përmes UCWSS. API-të që publikohen në sisteme të ndryshme duhet të mbledhen si një pikë e vetme për mirëmbajtje më të lehtë.

Konceptet kryesore janë:


- Qasja e jashtme në UCWSS bëhet përmes GG (Government GateWay)
- Përdoruesit e jashtëm (konsumatorët) të lidhur me GG mund të marrin informacione kadastrale duke përdorur shërbimin e jashtëm të internetit të mbështetur nga UCWSS.
- Përdoruesit e jashtëm duhet të regjistrohen në bazën e të dhënave UCWSS
- Kur UCWSS merr një kërkesë për shërbim të jashtëm, UCWSS do të kërkojë dhe do të marrë informacionin aktual të kadastrës duke përdorur shërbimet ekzistuese të internetit të SIKTK.
- UCWSS do të kontrollojë kredencialet e përdoruesit dhe të drejtat e aksesit.
- Para se të përgjigjet për ueb shërbimin e jashtëm, UCWSS harton të dhënat e dhëna në ueb shërbimin e SIKTK-së sipas të drejtës së aksesit të konsumatorit.
- UCWSS mbështet funksionalitetin e përdoruesve për operatorët e AKK-së për të regjistruar dhe ruajtur informacionin e përdoruesit, të drejtat e aksesit dhe përkufizimet e hartës së të dhënave.

SIKTK-ONLINE API pas avancimit: Qasja jonë është që të unifikojmë të gjitha API-të që i jepen institucionit të jashtëm, ato API-të do të konsumohen nga sistemi UCWSS dhe çfarëdo ndryshimi në sistemin UCWSS që nevojitet, ne do ta avancojmë atë në mënyrë që të bëjmë të mundur konsumimin e të gjitha llojeve të API-ve. -s përmes UCWSS. Çfarëdo shërbimi tjetër që zhvillohet në kuadër të këtij projekti, ato shërbime duhet të standardizohen dhe të mundësojnë që

5.3.8. | SIKTK-G

SIKTK-G pas përmirësimit: Ky sistem është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve WMS dhe WFS Ortofotot e viteve të ndryshme siç janë kapur, kufijtë e komunave, kufijtë e zonave kadastrale, dhe meqenëse ky sistem funksionon në versionin më të vjetër të GeoServer dhe versionin Operativ Server, qasja është që të përmirësohet në versionin më të fundit të GeoServer dhe Serverët më të fundit të Microsoft Operating, gjithashtu për të rritur performancën e serverit pasi është shumë i kufizuar në performancën e serverit.

Mëposhtë mund të shihni arkitekturën e SIKTK-G dhe funksionet tjera:




Në të gjitha sistemet, ne theksojmë nevojën për siguri të fortë, integritet të të dhënave dhe akses të përdoruesit. Angazhimi ynë për cilësinë dhe respektimi i praktikave më të mira në zhvillimin e TI-së janë të dukshme në propozimet tona. Ne sigurojmë që secili sistem të jetë jo vetëm i shëndoshë teknologjikisht, por edhe në përputhje me objektivat strategjike dhe nevojat operacionale të AKK-së. Qasja jonë është të ofrojmë sisteme që janë të shkallëzueshme, të sigurta dhe efikase, duke plotësuar kërkesat specifike të secilit domen brenda AKK-së. Në disa nga modelet e të dhënave të sistemeve si SIKTK-T dhe SIKTK-HK, modeli i të dhënave bazohet në LADM, qasja jonë nuk është ta bëjmë atë nga e para, por fokusi do të jetë në përdorimin vetëm të atyre pjesëve të LADM. Model që janë relevante për SIKTK-T dhe SIKTK-HK. disa nga standardet mbi të cilat do të bazohemi janë:

- ISO 19152-2012 Informacioni gjeografik — Modeli i Domenit të Administrimit të Tokës (LADM)
- ISO/DIS 19152-1 Informacioni gjeografik — Modeli i Domenit të Administrimit të Tokës (LADM) — Pjesa 1: Modeli konceptual i përgjithshëm
- ISO/DIS 19152-2 Informacioni gjeografik — Modeli i domenit të administrimit të tokës (LADM) — Pjesa 2: Regjistrimi i tokës (nëse disponohet gjatë zhvillimit të modelit)

Të gjitha versionet e Geoserver do të përmirësohen në versionin më të fundit të GeoServer për të qenë të qëndrueshëm dhe për të pasur performancën më të mirë. Gjithashtu, të gjitha Sistemet Operacionale të Microsoft do të përmirësohen për të pasur sisteme operative të qëndrueshme dhe më pak të rrezikshme. Performanca e serverëve do të rritet pasi konsumi dhe numri i përdoruesve po rritet dita ditës, ne duhet të rrisim edhe performancën e harduerit në ata serverë.

Në figurën e mëposhtme kemi elaboruar mënyrën e komunikimit me konsumatorët e jashtëm dhe mënyrën se si ata do të komunikojnë të gjithë API-në përmes SIKTK Online API duke përdorur nënsistemin UCWSS.




5.4. | Zgjerimi i Qendrës me HW+SW

Që nga viti 2016 Agjencia Kadastrale e Kosovës nuk kishte investuar në avancimin total të qendrës primare së të dhënave. Nevoja për resurse teknologjike, infrastrukturë e cila mund të mbështet avancimet në sistemet digjitale dhe përballon rritjen e kërkesave nga zgjerimi i shërbimeve dhe shqetësimi nga rreziqet që teknologjia e vjetruar paraqiste, shty që të dizajnohej, specifikohet dhe tenderohet projekti “Zgjerimi i qendrës së të dhënave HW+SW”. Ky projekt përfshiu avancimin e qendrës primare së të dhënave në tërësi me të gjitha komponentët e saj. Në tema të veçanta janë paraqitur avancimet e realizuara dhe përfitimet nga ato.

Infrastruktura Hyper Converged (HCI) dhe vSAN

Si pjesë e këtij projekti, kemi implementuar infrastrukturë Hyper Converged të bazuar në teknologjinë vSAN, e cila është vendosur në gjashtë servera fizikë. Këta serverë ofrojnë një kapacitet të jashtëzakonshëm, duke ofruar një total prej 600 GHz fuqi procesimi, 6 TB RAM memorie dhe 200 TB hapësirë magazinuese.


Ky sistem ofron fleksibilitet dhe shkallëzim të jashtëzakonshëm për të mbështetur nevojat në rritje të menaxhimit të të dhënave dhe kërkesave të përditshme operacionale.



Resurset procesorike dhe magazinuese të HCI

Hapësira Magazinuese (SAN Storage)


Në përputhje me kërkesat për ruajtjen e të dhënave masive dhe të pa-strukturuara, si ortofotot dhe të dhëna të tjera të rëndësishme, kemi implementuar një hapësirë magazinuese SAN me kapacitet rreth 90 TB. Teknologjia e implementuar ofron deduplikimin dhe kompresimin e të dhënave të ruajtura, çka e bënë tejet efçente për strukturën e të dhënave të cilat ruhen aty.



Hapësira në SAN Storage dhe kapaciteti i efçencës

Rrjeti i Komunikimit

Për të siguruar një komunikim të shpejtë dhe efikas mes pajisjeve, janë vendosur dy Top-of-the-Rack sëitchet, të cilët mundësojnë lidhje me shpejtësi prej 100 Gbps mes tyre dhe 25 Gbps mes pajisjeve të tjera të infrastrukturës. Ky sistem siguron një lidhje të qëndrueshme dhe me performancë të lartë, duke mbështetur operacione me kapacitet të lartë dhe duke mundësuar shfrytëzimin maksimal të mundësive të avancuara të teknologjisë vSAN dhe HCI.




Kapaciteti i rrjetës së komunikimit në HCI

Siguria Kibernetike dhe Monitorimi i Trafikut

Për të siguruar që infrastruktura të jetë e mbrojtur nga kërcënimet e mundshme dhe sulmet kibernetike, kemi implementuar dy Next Generation Firewalls të modelit të fundit nga prodhuesi Cisco. Këto pajisje mundësojnë monitorimin e vazhdueshëm të trafikut dhe aplikimin e politikave të mbrojtjes, duke përfshirë teknologjitë e avancuara si IPS, IDS, Access Control, ZTA, VPN dhe më shumë. Ky sistem siguron mbrojtje të jashtëzakonshme dhe monitorim të pandërprerë të të dhënave dhe rrjetit.

Application	Times Accessed	Application Risk	Productivity Rating	Data Transferred (MB)
Googlebot	7,841	Very High	Very Low	4787.69031266
Bingbot	1,746	Very High	Very Low	41.0395000842
Yahoo! Slurp	6	Very High	Very Low	0.077792164
BitTorrent	0	Very High	Very Low	0.001300811808
Riskified	335	Very High	Low	4.799764583


SUMMARY OF ALL NETWORK CONNECTIONS BY APPLICATION RISK




Shembull i monitorimit në FW

Platforma VEEAM dhe mbrojtja nga RANSOMWARE

Për të garantuar mbrojtjen e të dhënave nga sulmet e RANSOMWARE, kemi implementuar platformën VEEAM me teknologjinë Immutable. Kjo teknologji mundëson krijimin e kopjeve rezervë të të dhënave të pandryshueshme, duke ofruar një nivel shtesë mbrojtjeje për të dhënat kritike të institucionit dhe duke i mbajtur ato të sigurta nga kërcënimet e jashtme. Kopjet rezervë ruhen në hapësirë të veçantë, serverë me rreth 70TB hapësirë magazinuese, i cili përmes VEEAM arrin deduplikimin dhe kompresimin e të dhënave për shfrytëzim sa më efçient të hapësirës.




Topologjia e VEEAM backup solution



Topologjia e konfigurimit të DRC

Me realizimin e këtij projekti Agjencia Kadastrale ka siguruar infrastrukturë të qëndrueshme, të sigurt dhe me kapacitete të mjaftueshme për realizimin e objektivave dhe projekteve të saj. Në diagramin e më poshtëm është paraqitur vizualisht, për të thjeshtuar kompleksitetin, pamja e përgjithshme teknike e infrastrukturës së re :



Infrastruktura e Qendrës së të Dhënave

Qendra e Dytë e të Dhënave dhe Rimëkëmbja nga Fatkeqësitë

Në përpjekje për të garantuar një rritje të vazhdueshme të disponueshmërisë dhe besueshmërisë, kemi përmirësuar dhe azhurnuar Qendrën e Dytë të të Dhënave, e cila shfrytëzohet për rimëkëmbje pas fatkeqësive. Pajisjet në gjendje të mirë, nga Qendra e Parë, janë transferuar dhe vendosur në këtë qendër me qëllim të rritjes së kapacitetit të procesimit dhe magazinimit. Të gjitha sistemet operative janë azhurnuar në versionet më të fundit. Gjithashtu, është realizuar një ri-konfigurim i replikimit të të dhënave mes dy qendrave dhe një simulim i rimëkëmbjes në rast fatkeqësie, për të testuar kapacitetet e rimëkëmbjes dhe për të siguruar që proceset të jenë të gatshme për çdo situatë.

5.5. | Korrektimi/përmirësimi i të dhënave në SIKTK

Agjencia Kadastrale e Kosovës është përgjegjëse për të gjitha aktivitetet kadastrale në Kosovë dhe ka autoritet të nxjerrë udhëzime lidhur me to, për administrimin e sistemit shtetëror të bazuar në sisteme kompjuterike që mbledhin, përpunojnë dhe shpërndajnë të dhënat kadastrale. Bazuar në përgjegjësitë e AKK-së sipas legjislacionit dhe duke marrë parasysh gjendjen e të dhënave kadastrale, është propozuar që të zhvillohet një projekt që do të identifikojë dhe korrigjojë të dhënat kadastrale dhe do të plotësojë të dhënat jo të plota për personat në pjesën tekstuale të Sistemit Informativ Kadastral të Tokës së Kosovës (SIKTK-T).

Të dhënat kadastrale tekstuale dhe gjeohapësinore të mbajtura nga AKK-ja në Kosovë kanë kaluar nëpër disa sisteme nga periudha e pasluftës e deri më sot. Meqenëse sistemet kanë avancuar gjithnjë e më shumë me kalimin e kohës, por edhe trajnimi profesional i zyrtarëve të zyrave kadastrale komunale ka shënuar një avancim gjithnjë në rritje, natyrshëm ka lindur nevoja për përmirësimin/plotësimin e të dhënave.

Pothuajse gjysma e “personave” (pronarët, shfrytëzuesit, qiramarrësit) të identifikuar në SIKTK-T janë të regjistruar me një kod identifikimi (KCID), i cili nuk është i njëjtë me numrin personal zyrtar ose numrin e biznesit të mbajtur nga Agjencia e Regjistrimit Civil ose Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve. Ky kod është gjeneruar automatikisht nga sistemet e mëparshme të AKK-së.

Korrigjimi dhe plotësimi i të dhënave të pronarëve në SIKTK T është prioritet i AKK-së për vitin 2024. Paraprakisht për të krijuar bazën ligjore për realizim të këtij projekti është miratuar ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ MMPH — NR. 11/19 për Ndarjen e Ndërtesës dhe të Pjesës së Ndërtesës si dhe ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës. Është hartuar edhe drafti i Specifikave Teknike të cilat janë aprovuar nga Banka Botërore dhe projekti është në procedurë të prokurimit.


5.6. | Zhvillimi i Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) dhe përditësimi i Gjeoportalit ekzistues të AKK-së

Qëllimi i këtij aktiviteti është zhvillimi i Gjeoportalit të Kosovës i cili përbehet nga Gjeoportali i IKIH-së dhe Geoportali i ri i AKK-së. AKK menaxhon këtë Gjeoportali, i cili është ueb portal që funksionon si pikë e qasjes në informacione gjeografike në internet. Një ueb portal do të paraqesë informacion nga burime të ndryshme në një mënyrë të unifikuar.

Gjeoportali i IKIH-së do t'i ofrojë AKK-së një pamje konsistente me kontrollin e qasjes dhe procedurat për aplikacione dhe baza të të dhënave të shumta. Përmes Gjeoportalit do të shpërndahen të gjitha informacionet hapësinore të IKIH-së të institucioneve përgjegjëse në Kosovë sipas dispozitave të Ligji nr. 08/I-010 për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës në përputhje me Direktivën INSPIRE.

KONCEPTI I SISTEMIT- Blloqet funksionale të sistemit

Blloqet kryesore funksionale (d.m.th. nënsistemet) të portalit janë paraqitur në Figurën 3 më poshtë:



Koncepti i Geoportalit të IKIH-së dhe Gjeoportalit të ri të AKK-së

Përdoruesit dhe Menaxhimi i të Drejtave: Menaxhimi i të Drejtave Dixhitale ka një rol kyç në sistem dhe vepron si server i besuar brenda një koncepti sigurie. Funkcionaliteti do të mbulojë të gjitha aspektet e vërtetimit të përdoruesve dhe menaxhimit të lejeve të përdoruesve (informacionet e autorizimit). Fillimisht funksionaliteti që kërkon autorizim dhe vërtetim është hyrja meta të dhënave, modifikimi i meta të dhënave, shkarkimi i meta të dhënave dhe përdorimi i të gjitha shërbimeve të tjera. Ju lutemi vini re se blloqet funksionale mund të mos përfaqësojnë përkufizimin e komponentit të arkitekturës së sistemit.

Gjeoportali i Kosovës: Gjeoportali i Kosovës duhet të veprojë si pikë e vetme e qasjes në informacionin hapësinor në Republikën e Kosovës. Konkretisht, portali do të jetë porta për kërkimin dhe shikimin e të dhënave hapësinore nga burime të ndryshme të Republikës së Kosovës, duke treguar se cilat të dhëna dhe shërbime hapësinore janë në dispozicion dhe ku, si dhe duke i vënë ato në dispozicion të personave që kanë të drejtë dhe të lejuar t'i qasen.

Gjeoportali IKIH: Do të prezantojë informacionin nga burime të ndryshme në mënyrë të unifikuar. Gjeoportali IKIH do t'i ofrojë AKK-së një mënyrë për të ofruar një pamje konsistente të kontrollit të qasjes dhe procedurat për aplikacione të shumta, bazat e të dhënave dhe të gjitha informacionet gjeohapësinore të institucioneve përgjegjëse në Kosovë do të shpërndahen sipas dispozitave të Ligjit nr. 08/I-010 për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës në përputhje me Direktivën INSPIRE.

Gjeoportali i AKK-së: AKK do të publikojë të dhënat e saj burimore ku do të publikohen të dhënat e më shumë se 7 (shtatë) grupeve të të dhënave në baza ditore, si dhe mundëson lidhjen me platformat tjera online të administruara nga AKK. Gjithashtu, ky Gjeoportali do të shërbejë edhe për publikimin e të gjitha të dhënave gjeohapësinore sipas kërkesave të institucioneve të nivelit qendror dhe vendor për të dhënat gjeohapësinore që ato prodhojnë dhe mirëmbajnë.

Katalogu i meta të dhënave: Duhet të ofrojë funksionalitet për kërkimin dhe shikimin e meta të dhënave. Ai do të ketë gjithashtu aftësi për të krijuar, përditësuar dhe shkarkuar meta të dhëna.

Shikuesi i hartave në ueb: Duhet të përfshijë një shikues të hartës dhe shfletues me funksionalitet për digjitalizim të thjeshtë.

Shërbimet e rrjetit: Blloku kryesor funksional janë shërbimet e rrjetit. Ai do të përbëhet nga një numër shërbimesh të përcaktuara në përputhje me udhëzimet dhe specifikimet INSPIRE, duke përfshirë:

- Shërbimi i zbulimit
- Shërbimet e Shikimit
- Shërbimi i Shkarkimit
- Shërbimi i Transformimit

Këto shërbime do të vihen në dispozicion për aplikime të brendshme dhe të jashtme, e gjithë qasja në të dhënat hapësinore dhe metadata do të bëhet përmes këtyre shërbimeve.

E-Commerce: Ky komponent do të mbështesë pagesat për përdorimin e shërbimeve për shikimin dhe shkarkimin e të dhënave të publikuara në Gjeoportalin e AKK-së në rastet kur ato nuk janë falas. Ai gjithashtu do të mbështesë kryerjen e pagesave për produktet e publikuara. **Depoja e hartave dhe e të dhënave hapësinore:** do të ofrojë funksionalitet për krijimin, modifikimin dhe menaxhimin e depove të të dhënave për rastet, vektorët dhe të dhënat tematike hapësinore dhe ofron shërbime të pamjes, shkarkimit dhe transformimit në përputhje me specifikimet INSPIRE.

Bazuar në Ligjin nr. 08/I-010 për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës me qëllim të ofrimit të shërbimeve për shfrytëzim të informacioneve hapësinore, AKK e themelon, zhvillon dhe mirëmban Gjeoportalin për IKIH. Gjeoportali për IKIH ndërlidh shërbimet në ueb për secilën nga temat e përcaktuara në Shtojcën I, II dhe III. Përmes Gjeoportalit për IKIH, autoritetet publike u mundësohet: menaxhimi i meta të dhënave, e drejta për kërkim dhe shikim, e drejta për shkarkime dhe futja e informacioneve hapësinore si dhe informacioneve tjera të cilat kanë të bëjnë me Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor.

Kontrata për Zhvillimin e Gjeoportalit të IKIH-së dhe Gjeoportalit të ri të AKK është nënshkruar me 17 Dhjetor 2024 dhe gjeoportali do të jetë funksional në vitin 2025, këtë aktivitet e mbështet projekti REGIP i Bankës Botërore.

5.7 | Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave hapësinore në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit të Ndërtesave

Objektivit kryesor i këtij aktiviteti është ngritja e kualitetit të të dhënave kadastrale për njësitë pjesë të ndërtesave, ofrimi i informacioneve me besueshmëri më të lartë për qytetarët përmes gjeoportalit shtetëror.




Foto Pjesë e ndërtesës së azhurnuar në SIKTK-HK

Aktivitetet kryesore të parapara në projekt

- Krijimi, konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave hapësinore në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit të Ndërtesave;
- Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave të për pjesët e ndërtesave të regjistruara në SIKTK-T, por jo në SIKTK-HK;
- Harmonizimi i ID-ve të njësive "Pjesë të Ndërtesave" të regjistruara në të dy sistemet (SIKTK-T dhe SIKTK-HK);
- Regjistrimi i transaksioneve të mbetura (ndryshimeve) të ZKK-së Shtërpçë në SIKTK-T.

Deri në dhjetor 2024, janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- 2000 njësi të përfunduara për aktivitetin e parë,
- 9400 njësi të përfunduara për aktivitetin e dytë,
- 1900 njësi të përfunduara për aktivitetin e tretë,
- 950 lëndë të përfunduara për aktivitetin e katërt.

Me realizimin e këtij projekti, gjithashtu sigurohet që pronarët e njësive kadastrale pjesë të ndërtesave të kenë të kompletuara edhe të dhënat grafike për pronat e tyre dhe ato të mund t'i përdorin për transaksione dhe në ekonominë e tregut të pronave të paluajtshme.

Rezultatet e arritura deri më tani tregojnë një progres të qëndrueshëm drejt arritjes së objektivave të projektit brenda afateve të planifikuara.

5.8. | Analizimi, korrigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaborateve të shpronësimit

Në Republikën e Kosovës janë zhvilluar shumë procese të shpronësimit si nga niveli qendror ashtu edhe ai lokal, por shumica e tyre janë ende të paregjistruara në SIKTK. Me anë të këtij projekti, nga AKK synohet regjistrimi i të gjitha pronave të shpronësuara në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokave të Kosovës (SIKTK), sipas vendimeve përfundimtare të bazuar në studimin e plotë teknik të pronës së paluajtshme të shpronësuar.

Implementimi i projektit ka filluar në tetor të vitit 2024 dhe pritet të përfundojë në dhjetor të vitit 2025.



Fushëveprimi i projektit

Departamenti i shpronësimeve nga MMPHI ka deklaruar se posedon të dhëna për përafërsisht rreth **18,500** parcela të përfshira në vendime përfundimtare të shpronësimeve.

Derisa ka një numër të konsiderueshëm të vendimeve të shpronësimeve të ndërmarrjeve publike si KOST, KEK, KRU Prishtina, NP Termokos si dhe shpronësime tjera të realizuara nga komunat për prona shoqërore si dhe disa shpronësime të institucione tjera shoqërore, për te cilat shpronësime nuk mund të thuhet për numrin e pronave të përfshira në shpronësimet e lartcekura.

Si aktivitet fillestar i projektit "Analizimi, korrigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaborateve të shpronësimit", është studimi i hollësishëm për të gjitha të dhënat e shpronësuara duke i krahasuar të dhënat e shpronësuara me të dhënat në SIKTK si dhe me vendimet përfundimtare të shpronësimit.


Të dhënat (elaboratet) të cilat i plotësojnë kriteret për tu regjistruar në SIKTK, përgatiten nga OE dhe në koordinim me AKK fillon regjistrimi i tyre në SIKTK. Derisa, të dhënat (elaboratet) të cilat kanë mangësi dhe nuk i plotësojnë kriteret për regjistrim në SIKTK (bazën grafike dhe tekstuale), nga OE do të bëhet plotësimi dhe korrigjimin e tyre bazuar në legjislacionin në fuqi dhe përgatitjen e tyre për regjistrim në SIKTK.



Aktivitetet kryesore të parapara në projekt

Më poshtë janë listuar aktivitetet bazike të cilat do të realizohen gjatë implementimit të këtij projekti.

- Korrigjimi dhe plotësimi i të dhënave të mangëta në elaboratet të shpronësimit
- Krijimi i elaboratit komplet të shpronësimit bazuar në vendimin përfundimtar
- Matje në terren për rastet kur konstatohet se është e domosdoshme
- Regjistrimi i njësive/pronave të shpronësuara në SIKTK-HK (baza grafike)
- Regjistrimi i njësive/pronave të shpronësuara në SIKTK-T (baza tekstuale).



5.9. | Mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave

Njëri prej aktiviteteve më të rëndësishme në kuadër të projektit të Adresave ka qenë edhe mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave. Rëndësi e këtij procesi ka qenë në posedimin e gjendjes më reale sa i përket adresave e më pastaj ka ndikuar edhe në procesin e prodhimit dhe instalimit të tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të adresave si dhe në procesin e ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare, në mënyrë që qytetarët të mos mbeten pa adresë zyrtare.

Edhe pse ligjërish janë përgjegjëse për përditësimin e të dhënave të adresave dhe duke pas parasysh që komunat nuk kanë bërë përditësimin e të dhënave të adresave për kohë të gjatë për arsye të ndryshme, si p.sh. mungesa e stafit, pastaj mos përdorimi i adresave zyrtare, AKK ka mbështetur komunat me staf mbështetës për mbledhjen e të dhënave të adresave të reja në teren dhe mbështetjen e komunave për digjitalizimin e tyre në ARIS, përmes projektit të Bankës Botërore. Procesi i mbledhjes dhe përditësimit të të dhënave të adresave ka përfunduar në vitin 2023 në 30 komuna dhe ka vazhduar edhe në vitin 2024 në 2 komuna (Prizren dhe Shtërpçë) me 3 konsulent.

Statistikat e përditësimit të të dhënave në vitin 2024:

Nr.	Komuna	Para përditësimit		2024			
		Rrugë	Hyrje	Rrugë (11.2023)	Hyrje 2024	Hyrje të reja	% e hyrjeve të reja
3	Prizren	1634	43262	1637	53549	10287	24
4	Shtërpçë	196	3976	196	5140	1164	29
TOTALI		2720	71037	2723	83170	12133	

Pas përfundimit të procesit të mbledhjes dhe përditësimit të të dhënave të adresave, janë mbledhur dhe përditësuar mesatarisht 15% më shumë hyrje të reja.

5.10. | Ndërlidhja e qytetarit me adresë zyrtare

Duke pasur parasysh nevojën e institucioneve për të përmirësuar kualitetin e shënimeve që ndërlidhën me adresën dhe lidhjen e qytetarit me adrese të sakta, ka lindur nevoja e vendosjes së bashkëpunimit në mes të ARC, AKK dhe ASHI.

Ofrimi i të dhënave të caktuara nga sistemet burimore elektronike për ndërlidhjen e qytetarit me adrese të sakta është me rëndësi pasi që i mundësohet kërkimi dhe identifikimi i saktë i të dhënave përkatëse përmes parametrave të caktuar.

Me qëllim të koordinimit sa më të mirë dhe shpërndarjes së përgjegjëse, për të realizuar projektin e kompletimit të Sistemit të Adresave, janë nënshkruar Memorandume të Bashkëpunimit me institucione të ndryshme si: Komunitat, Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Agjencinë për Shoqëri të Informacionit.

Metodologjia e përzgjedhur përfshin angazhimin dhe kontraktimin i një numri të caktuar të stafit për 12 muajve nga AKK dhe vendosja e tyre nëpër komuna (në zyrat lokale të gjendjes civile), ku qytetarët obligohen që të përcaktojnë adresën tek stafi i angazhuar nga AKK, më pastaj stafi të regjistroj adresën në modulën e zhvilluar nga AKK për gjenerimin e Formularit për identifikimin e adresës. Më pastaj të dhënat e adresës të bazuara në këtë formular si dëshmi e pranuar, përditësohen në Sistemin e Gjendjes Civile për qytetarin përkatës. Ky proces duhet të zgjasë së paku 12 muaj, duke u mbështetur edhe nga një fushatë e madhe e informimit publik.

Procesi i deklarimit të adresës mund të realizohet edhe përmes platformës e-Kosova, ku qytetarët pa pasur nevojë të paraqiten fizikisht në zyrat e gjendjes civile mund të deklarojnë adresën zyrtare online. Së pari bëhet integrimi i pjesës tekstuale të ARIS-it në platformën e-Kosova, e më pastaj edhe integrimi i pjesës grafike të ARIS-it përmes uebshërbimeve.

Pas përcaktimit të adresës në platformën eKosova nga ana e qytetarit, në ZGJC-në përkatëse automatikisht si dëshmi e ndryshimit të adresës në formë elektronike shfaqet Formulari i AKK-së për identifikimin e adresës si dhe në fund nga ZGJC përkatëse konfirmohet ndryshimi i adresës. Procedurat e ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare janë:

1. Procedura përmes paraqitjes së qytetarit në zyrat Komunale të Gjendjes Civile;

- Paraqitja e qytetarit në zyrën e Gjendjes Civile Komunale, tek stafi mbështetës për ndërlidhje;
- Deklarimi i qytetarit për adresën para stafit mbështetës për ndërlidhje;
- Regjistrimi i numrit personal dhe adresës nga stafi mbështetës për ndërlidhje, në modulin për identifikim të adresës në Sistemin e Adresave;
- Printimi i Formularit për Identifikim të Adresës;
- Paraqitja e Formularit për Identifikim të Adresës tek zyrtari I gjendjes Civile;
- Përditësimi i Adresës së qytetarit në Sistemin e Gjendjes Civile nga zyrtari I zyrës së gjendjes civile;

2. Procedura online përmes platformës E-Kosova.

- Deklarimi i adresës zyrtare nga qytetari në platformën E-Kosova;
- Shkarkimi i online i Formularit për Identifikim të Adresës nga zyrtari i gjendjes civile;
- Aprovimi i Formularit për Identifikim të Adresës nga zyrtari i gjendjes Civile;
- Përditësimi i adresës së qytetarit në Sistemin e Gjendjes Civile;


Aktivitetet e realizuara rreth ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare:

- Janë kontraktuar 55 persona si staf mbështetës për procesin e ndërlidhjes;
- Stafi mbështetës është vendosur nëpër zyra të gjendjes civile komunale;
- Stafi mbështetës është trajnuar rreth procedurave të ndërlidhjes, përmes modulit për Formularin për Identifikim të Adresës në Sistemin e Adresave;
 - Është realizuar takimi me kryetarë të komunave nga AKK, ARC, ASHI, qëllimi informimi rreth procesit dhe përgjegjësisë;
- Procesit ka filluar me 1 Tetor dhe zgjat 12 muaj;
- Është realizuar ndërlidhja teknike në mes Sistemit të Gjendjes Civile me Sistemin e Adresave;
- Është Integruar moduli i formularit për identifikim të adresës në E-Kosova;

Forma e Formularit për identifikim të adresës

Deklarata e personit për vërtetim të adresës

Harta e Adresës



Informimi publik për procesin e ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare

Duke parë rëndësinë e procesit të ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare, Agjencia Kadastrale e Kosovës në bashkëpunim me Agjencinë e Regjistrimit Civil ka realizuar edhe informim publik rreth procesit publik. Informimi publik është realizuar në teren duke shpërndar fletushka rreth procesit të ndërlidhjes dhe duke bashkëbiseduar me qytetar rreth procedurave të deklarimit të adresës zyrtare dhe përfitimet nga procesi i ndërlidhjes.

Foto gjatë informimit publik



Deklarimi i adresës zyrtare në komuna



Baza ligjore e procesit të ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare

Agjencia Kadastrale e Kosovës së bashku me Agjencinë për Regjistrim Civil i kanë kushtuar rëndësi edhe bazës ligjore mbi të cilën bazohet procesi i ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare.

Baza ligjore ku bazohet procesi i ndërlidhjes së qytetarit me adresë është:

- Ligji për Sistemin e Adresave Nr. 04/L-071;
 - Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. 16/2019, Për Procedurat e Krijimit dhe Administrimit të Regjistrimit Komunal të Adresave dhe Regjistrimit Shtetëror të Adresave, Neni 6, Paragrafi 5.
- Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 03/2015 Për Procedurat e lajmërimit dhe ç'lajmërimit të vendbanimit apo vendqëndrimit, Neni 3, Paragrafi 5.4, nën paragrafi 5.4.1;

Përfitimet nga procesi i ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare

Përfitimet nga përdorimi i adresës zyrtare dhe unike janë te mëdha duke filluar nga shërbimet komunale, identifikimi i lokacionit nga organet e emergjencave dhe sigurisë, planifikime rreth migrimit, në shëndetësi arsim etj..


Më poshtë janë paraqitur vetëm disa nga përfitimet më të rëndësishme nga procesi i ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare dhe unike:

- Mundëson pajisjen e qytetarëve me adresë zyrtare dhe unike;
- Është rekomandim i BE-së në kuadër të reformës zgjedhore në kuadër të ERA2;
- Mundëson përdorimin e adresës zyrtare dhe unike nga të gjithë regjistrat shtetëror;
- Mundëson pastrimin e listave të votuesve dhe zvogëlimin e distancës për të votuar;
- Mundëson të dhënat e sakta rreth migrimit të brendshëm;
- Lehtëson Regjistrimin e popullsisë;
- Mundëson zoonimin e QKMF/QMF/AMF;
- Mundëson përdorimin e adresave zyrtare nga tatimit në pronë;
- Mundëson zoonimin e institucioneve shkollore publike të nivelit të ulët;
- Mundëson përdorimin e adresës zyrtare dhe unike në të gjitha faturat e shërbimeve publike (KEDS, Ujësjiellës, shërbimeve të pastrimit etj.);
- Mundëson gjetjen e lokacionet më të shpejt nga Policia;
- Mundëson gjetjen e lokacionit për emergjenca nga AME;
- Lehtëson navigimin në teren
- Mundëson shpërndarjen më të lehtë dhe më të shpejtë të dërgesave nga Posta;

Statistikat të deklarimit dhe regjistrimit të adresave zyrtare për periudhën kohore 24.10-31.12.2024:

Deklarimi i adresës zyrtare			
Komuna	Nr Aris	Nr eKosova	Totali
PRISHTINË	791	3481	4272
DEÇAN	2591	721	3312
GJAKOVË	2587	317	2904
PRIZREN	933	803	1736
VUSHTRRI	1021	492	1513
FERIZAJ	545	721	1266


FUSHË KOSOVË	268	803	1071
PEJË	480	580	1060
GRAÇANICË	165	703	868
MITROVICË	484	381	865
GJILAN	216	547	763
GLLOGOC	230	451	681
SUHAREKË	463	184	647
LIPJAN	244	361	605
DRAGASH	319	223	542
RAHOVEC	181	279	460
PODUJEVË	169	261	430
KAMENICË	280	148	428
VITI	28	356	384
ISTOG	130	244	374
KAÇANIK	117	255	372
OBILIQ	101	250	351
KLINË	179	169	348
SKËNDERAJ	103	204	307
SHTIME	87	194	281
JUNIK	186	91	277
MALISHEVË	2	161	163
HANI I ELEZIT	61	63	124
KLLOKOT	86	14	100
SHTËRPCE	48	22	70
MAMUSHË	25	40	65
RANILLUG	35	5	40
TOTALI	13155	13524	26679




Regjistrimi i adresës zyrtare për anëtar të familjes

Komuna	eKosova	ZGJC	Totali
DEÇAN	835	8176	9011
GJAKOVË	344	8481	8825
PRISHTINË	4223	1899	6122
PRIZREN	932	2613	3545
PEJË	694	1626	2320
VUSHTRRI	614	1077	1691
MITROVICË	67	1510	1577
DRAGASH	238	1182	1420
FUSHË KOSOVË	829	500	1329
FERIZAJ	42	1285	1327
GJILAN	652	548	1200
GRAÇANICË	768	424	1192
GLLOGOC	570	586	1156
SUHAREKË	197	959	1156
LIPJAN	416	675	1091
PODUJEVË	309	612	921

KAMENICË	188	705	893
RAHOVEC	281	563	844
JUNIK	115	689	804
OBILIQ	306	376	682
KAÇANIK	296	364	660
SKËNDERAJ	259	298	557
VITI	408	97	505
SHTIME	196	248	444
KLINË	207	186	393
ISTOG	23	287	310
KLLOKOT	13	244	257
MALISHEVË	198	21	219
SHTËRPECË	25	131	156
HANI I ELEZIT	77	72	149
MAMUSHË	46	48	94
RANILLUG	1	9	10
PARTESH	0	3	3
TOTALI	14369	36494	50863






Trajnimet e stafit për ndërlidhjen e qytetarit me adresë zyrtare

Për procesin e ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare janë trajnuar 55 konsulentë të cilët janë kontraktuar për mbështetje të komunave dhe 34 zyrtarë të urbanizimit të 34 komunave, gjithsej 89 staf. Trajnimi është realizuar për procedurat e ndërlidhjes dhe lëshimin e formularit për identifikim të adresës përmes Sistemit të Informimit të Regjistrimit të Adresave (ARIS).

5.11. | Vendosija e numrave dhe emrave të rrugëve

Prodhimi, instalimi dhe mirëmbajtja e tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të adresave është përgjegjësi ligjore e komunave, me qëllim përmirësimin e sistemit të unifikuar të adresave. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), përmes donatorëve të ndryshëm, ka mundësuar përmbushjen e kërkesave të komunave për sinjalizimin e adresave.

Në kuadër të aktivitetit për sinjalizimin e adresave, janë paraparë të prodhohen dhe instalohen rreth:





Përfshijtur 4 komunat veriore

Vendosija e tabelave të emrave është planifikuar të bëhet në komunat: Junik, Shtërpce, Ranillug dhe Novobërdë.

Në komunat Junik dhe Shtërpce, vendosja e tabelave të emrave të rrugëve ka përfunduar plotësisht. Komuna e Ranillugut është në proces të instalimit të tabelave, ndërsa në komunën e Novobërdës, pasi që ende nuk janë aprovuar emrat e rrugëve, rrjedhimisht nuk ka mundësi për sinjalizim të adresave.

Sa i përket tabelave të numrave të adresave, procesi ka përfunduar në 4 komuna (Viti, Pejë, Gjakovë, dhe Graçanicë), ndërsa komunat e tjera të përfshira në projekt janë në proces.

Në hartat e mëposhtme paraqitet statusi i vendosjes së tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të hyrjeve në Kosovë.



5.12. | Implementimi i Planit të Veprimit për Informim Publik

Përmbledhje

Plani i Veprimit për Informim Publik, synon që të sigurojë një komunikim efektiv dhe transparent për të informuar qytetarët, institucionet dhe palët e interesuara mbi procesin e Rindërtimit të Kadastrit dhe projekteve të tjera të rëndësishme të AKK-së. Komunikimi i qartë dhe i vazhdueshëm është thelbësor për rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të qytetarëve në këto procese.

Format e Komunikimit për PR & Marketing:

- Konferenca për media — për të njoftuar fillimin dhe progresin e projekteve
- Publikime në portale dhe rrjete sociale — për të informuar dhe angazhuar publikun që të ndërveprojnë me projektet dhe zhvillimet në këtë fushë.
- Intervista dhe reportazhe — me ekspertë dhe qytetarë për të theksuar përfitimet e projekteve
- Video testimonial — me qytetarë dhe biznese që përfitojnë nga projektet.
- Spote televizive dhe radiofonike — për të rritur ndërgjegjësimin mbi projektet kyçe dhe për të siguruar prezencë të mjaftueshme.
- Fushata informuese me vizualizime dhe infografika — për një qasje të qartë dhe të lehtë për publikun
- Evente dhe prezantime publike — për të treguar progresin dhe për të përfshirë komunitetin.

Plani i Komunikimit sipas Ngjarjeve Kryesore

1. Fillimi i Projektit të Rindërtimit të Kadastrit në 115 Zona Kadastrale

Meqë ky është edhe një nga projektet më të mëdha që pritet ta zhvillojë AKK-ja këtë vit, atëherë, një vëmendje e madhe do t'i jepet duke i siguruar mbulueshmëri në të gjitha format, përmes kampanjave të veçanta dhe kreative, e gjithashtu, edhe përmes gjuhës që do të targetojë audiencën target të AKK-së por edhe të gjithë qytetarët e Kosovës. Do të përdoren disa kanale komunikimi si dhe do të ketë një fushatë të vazhdueshme në rrjete sociale, ku edhe do të përdoren ADS për të rritur audiencën dhe për të shpërndarë sa më shumë informacionin.

- **Qëllimi:** Informimi i qytetarëve dhe institucioneve mbi fillimin e projektit.
- **Kanale komunikimi:** Konferenca për media, komunikata për shtyp, postime në rrjetet sociale, intervista me ekspertë, lajme nëpër portale, video mesazhe.
- **Çka do të publikohet:**
 - Njoftime mbi rëndësinë e projektit. (Të vazhdueshme)
 - Video shpjeguese mbi procesin dhe përfitimet.
 - Grafika me zonat e përfshira.
 - Testimoniale të ekspertëve të AKK-së dhe atyre që përfitojnë nga projekti.

2. Projekti për prodhimin dhe instalimin e tabelave të rrugëve dhe numrave të hyrjeve të objekteve

- **Qëllimi:** Edukimi dhe sensibilizimi për rëndësinë e adresimit të saktë të rrugëve, vendbanimeve, ndërtesa e objekte të ndryshme.
- **Kanale komunikimi:** Postime të rregullta në rrjetet sociale, infografika, prezencë në media media lokale në kryeqendrat më të mëdha të Kosovës.
- **Çka do të publikohet:**
 - Para dhe pas implementimit të projektit (foto dhe video).
 - Harta interaktive që tregojnë progresin e punimeve.
 - Informacione mbi mënyrën si do të ndihmojë qytetarët ky projekt.

3. Finalizimi i Projektit të ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare

- **Qëllimi:** Informimi i qytetarëve mbi përfitimet e adresës zyrtare dhe përdorimin e saj.
- **Kanale komunikimi:** Media kombëtare, rrjetet sociale, fushatë sensibilizuese.
- **Çka do të publikohet:**
 - Udhëzues praktik për përdorimin e adresave zyrtare.
 - Përfitimet e këtij sistemi në administratë dhe ekonomi.
 - Historitë e suksesit nga pilot-projektet.

4. Zhvillimi i Mobil Aplikacionit/Navigacionit për Kosovë (ARIS MOBILE)

- **Qëllimi:** Promovimi i përdorimit të aplikacionit për navigim dhe qasje më të lehtë në të dhënat kadastrale.
- **Kanale komunikimi:** Video tutoriale, konferencë për media, bashkëpunime me IT influencerë.
- **Çka do të publikohet:**
 - Video udhëzuese mbi përdorimin e aplikacionit.
 - Demonstrime praktike të funksioneve kryesore.
 - Feedback nga përdoruesit e parë.

5. Ngritja 3D e objekteve

- **Qëllimi:** Informimi i publikut mbi teknologjinë 3D dhe përfitimet e saj.
- **Kanale komunikimi:** Prezantime vizuale, video të animuara, media sociale.
- **Çka të publikohet:**
 - Demonstrime të objekteve 3D.
 - Rëndësia e modelimit 3D për planifikimin urban.
 - Infografika mbi implementimin e kësaj teknologjie.

6. Zhvillimi i mëtejshëm i Gjeoportalit Shtetëror (Përditësimi / publikimi i të dhënave)

- **Qëllimi:** Rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e Gjeoportalit dhe përdorimin e tij.
- **Kanale komunikimi:** Uebinarë, postime edukative, bashkëpunim me institucione akademike.
- **Çka do të publikohet:**
 - Video udhëzuese mbi përditësimet më të fundit.
 - Demonstrime të rasteve të përdorimit të suksesshëm.
 - Studime rasti mbi përfitimet e platformës.

7. Projekti për mirëmbajtjen e sistemit të informacioneve kadastrale të tokave të Kosovës

- **Qëllimi:** Rritja e transparencës dhe lehtësimi i qasjes në informacionet kadastrale.
- **Kanale komunikimi:** Udhëzime online, video shpjeguese, fushatë informuese në media sociale.
- **Çka do të publikohet:**
 - Si të aksesohen informacionet mbi hipotekat, ndarjet, bartjet etj.
 - Përfitimet për qytetarët dhe institucionet.
 - Përditësime mbi zhvillimet më të fundit.

8. Projekti për Mirëmbajtjen e Sistemit të Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës

Qëllimi:

Qëllimi kryesor i këtij projekti është të sigurojë një sistem të përditësuar dhe të besueshëm për administrimin e të dhënave kadastrale në Kosovë. Kjo do të mundësojë një qasje më të lehtë, më transparente dhe më të shpejtë për qytetarët, institucionet dhe bizneset që kanë nevojë për informacione mbi pronësinë, hipoteka, ndarjet, bartjet dhe çështje të tjera të tokës. Për më tepër, projekti synon të përmirësojë barazinë gjinore në pronësi duke promovuar ndërgjegjësimin dhe lehtësuar proceset e regjistrimit të pronave në emër të grave.

9. Kanalet e komunikimit në tërësi:

- **Webfaqja zyrtare e AKK-së** — Për informata zyrtare, dokumente dhe raportime të rregullta mbi ecurinë e projektit.
- **Platformat e rrjeteve sociale (Facebook, Twitter, LinkedIn, Instagram, YouTube)** — Për të ndarë informacione në kohë reale, për të komunikuar me qytetarët dhe për të promovuar të drejtat pronësore.
- **Media tradicionale (TV, radio, gazeta)** — Për të informuar publikun e gjerë për ndryshimet dhe risitë që sjell projekti.
- **E-mail dhe buletine elektronike** — Për njoftimet zyrtare drejtuar institucioneve dhe palëve të interesuara.
- **Konferenca dhe takime informuese** — Për të diskutuar sfidat dhe përparimet me ekspertët e fushës, përfaqësues të qeverisë dhe organizatat joqeveritare.

Çka do të publikohet:

- **Njoftime dhe përditësime** — Lajme mbi ndryshimet në sistemin kadastral, përmirësimet teknike dhe përditësimet e të dhënave.
- **Udhëzues dhe informacione praktike** — Manuale dhe video edukative mbi procedurat e regjistrimit të pronës, bartjes, ndarjes dhe hipotekave.
- **Statistika dhe analiza** — Të dhëna mbi numrin e pronave të regjistruara, ndarjen sipas gjinisë dhe ndikimin e projektit në transparencën e pronësisë.
- **Fushata ndërgjegjësuere** — Informacione për të drejtat e pronësisë, me fokus të veçantë në barazinë gjinore në pronësi.

Roadmap për Implementimin e Projekteve dhe Aktivitetet e PR & Marketingut (2024 - 2026)

Nr.	Aktiviteti Kryesor	Periudha Kohore	Muaji i Fillimit / Finalizimit	Aktivitetet e PR & Marketingut
1	Fillimi i Projektit të Rindërtimit të Kadastrit në 115 Zona Kadastrale	2025 - 2026	Shkurt 2025 - Fillimi	Konferencë për media për fillimin e projektit, publikime në portale dhe rrjete sociale, intervista me ekspertë për rëndësinë e modernizimit kadastral, video shpjeguese për transparencën e procesit.
2	Projekti për Prodhimin dhe Instalimin e Tabelave të Rrugëve dhe Numrave të Hyrjeve të Objekteve	2025 - 2026	Gjatë gjithë vitit 2025	Publikime periodike me shembuj konkretë nga qytetet ku po implementohet projekti, video testimonial nga qytetarët për përfitimet e sistemit të adresave, reportazhe me autoritetet lokale për impaktin e projektit
3	Finalizimi i Projektit të Ndërlidhjes së Qytetarit me Adresë Zyrtare	2025	Gusht 2025 - Finalizimi	Kampanjë gjithëpërfshirëse informuese: artikuj edukativë në media, spote televizive për rëndësinë e adresave të sakta, udhëzues praktik për qytetarët mbi procedurat, bashkëpunim me institucione për shpërndarjen e informacionit
4	Zhvillimi i Aplikacionit Mobil/Navigacionit për Kosovë (ARIS MOBILE)	2025 - 2026	Tetor 2025 - Fillimi	Fushatë promovuese për përdorimin e aplikacionit, video tutoriale për funksionalitetet, bashkëpunime me media dhe influencerë teknologjikë për të rritur ndërgjegjësimin, event lançimi me demonstrim praktik

5	Ngritja 3D e Objekteve	2025	Tetor 2025	Prezantime vizuale dhe animacione 3D për qytetet e përfshira, publikime për përfitimet e modelimit 3D në planifikimin urban, intervista me arkitektë dhe urbanistë mbi ndikimin e këtij projekti
6	Zhvillimi i mëtejshëm i Gjeoportalit Shtetëror (Përditësimi / Publikimi i të Dhënave)	2025 - 2026	/	Fushatë promovimi për qasjen dhe përdorimin e Gjeoportalit, demonstrime live në media sociale dhe platforma digjitale, seminare për profesionistët e fushës, artikuj teknikë mbi përmirësimet e reja
7	Projekti për Mirëmbajtjen e Sistemit të Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës	2025 - 2026	/	Strategji komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin mbi të dhënat e kadastrës, fushatë për edukimin e qytetarëve mbi nxjerrjen e informacioneve si hipoteka, barazia gjinore, ndarjet, bartjet, etj., video testimionale nga qytetarët dhe bizneset për përfitimet e sistemit, intervista me zyrtarë të AKK mbi transparencën e procesit

Përfundim

Kjo strategji komunikimi synon të sigurojë një informim të gjerë dhe të qartë për qytetarët dhe institucionet mbi reformat dhe projektet e AKK-së. Përmes një qasje të integruar mediatike dhe përdorimit të kanaleve të ndryshme të komunikimit, synohet të arrihet transparencë dhe të rritet ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e sistemit kadastral dhe inovacioneve të reja në këtë fushë.

5.13. | Skanimi dhe indeksimi i dokumenteve arkivore kadastrale

Edhe projekti Skanimi i Dokumenteve të Arkivuara Kadastrale është pjesë e Projektit të Bankës Botërore (BB) për të mbështetur Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) për të forcuar infrastrukturën kombëtare të të dhënave në fushën e informacionit kadastral — Projekti për Kadastrën e Paluajtshmerive të Kosovës dhe Infrastrukturën Gjeohapësinore (REGIP).

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është skanimi dhe indeksimi i dokumenteve të arkivuara kadastrale dhe integrimi i tyre në Sistemin e Skanimit masiv në SIKTK.

Skanimi i dokumenteve arkivore dhe një formë e ngjashme e realizimit të tij ka ndodhur edhe më herët në faza të ndryshme në vite të ndryshme ku janë përfshirë të gjitha ZKK-të, mirëpo me projektin e këtij viti synohet që të përmbyllet i gjithë procesi i dixhitalizimit të dokumenteve kadastrale arkivore.

Qëllimi i projektit është të lehtësojë punën e Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK) dhe AKK-së për rritjen e cilësisë së të dhënave dhe ofrimin e qasjes më të shpejtë dhe më të saktë në të dhëna për pronarë të caktuar, duke përsheptuar procesin, duke kursyer kohë dhe efikasitet në gjetjen e historikut të rasteve në arkivin digjital të komunës përkatëse. Ky projekt do të përmirësojë transparencën dhe efikasitetin e punës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Pronarët ose aplikantët për shërbimet kadastrale do të përfitojnë nga saktësia më e madhe e informacionit të ofruar nga ZKK-ja si dhe marrja e të dhënave në një kohë shumë të shpejtë. Projekti do të rrisë gjithashtu sigurinë e ruajtjes së dokumenteve arkivore të dixhitalizuara (të skanuara me cilësi të lartë dhe të indeksuar në mënyrë që të gjenden lehtësisht në sistem me emrin dhe ID të pronarëve)


Përfitimet pas realizimit të projektit përfshijnë:

- Lehtësim në procesin e punës së përditshme të zyrtarëve të ZKK-ve dhe AKK-së; me qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në dokumentet e arkivuara;
- Rritja e sigurisë dhe cilësisë së të dhënave kadastrale;
- Rritja e transparencës duke mundësuar qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në dokumentacionin e arkivuar.

Projekti do të zhvillohet në 4 ZKK (Prishtinë, Podujevë, Gjilan dhe Istog), në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, në ish Entin për Gjeodezi dhe në AKK.

Tashmë kontrata është nënshkruar dhe puna ka filluar në skanim të cilat më pas do të l nënshtrohen një procesi të kontrollës së kualitetit të skanimit për tu aprovuar mandej nga AKK-ja.

AVANCIMET NË SISTEMET
KADASTRALE DHE
NGRITJA E KUALITETIT
TË TË DHËNAVE



6.1. | Deklarimi i Adresës Zyrtare të Vendbanimit

Agjencia Kadastrale e Kosovës, në bashkëpunim me Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Agjencinë për Shoqëri të Informacionit, gjatë vitit 2024 ka funksionalizuar mundësinë për deklarimin e adresës zyrtare të vendbanimit të qytetarëve përmes platformës E-Kosova. Kjo është një hap i rëndësishëm drejt digjitalizimit dhe përmirësimit të efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së shërbimeve. Tashmë, qytetarët mund të përditësojnë adresën pa pasur nevojë të paraqiten fizikisht në zyrat e gjendjes civile, duke e bërë procesin më të shpejtë dhe më të lehtë.



6.2. | Sistemi për licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete

Agjencia Kadastrale e Kosovës, përmes projektit të implementuar nga GIZ, ka arritur që të lansojë me sukses sistemin për licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete.

Kjo arritje e rëndësishme nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, financuar nga BE dhe Republika Federale e Gjermanisë, përmes projektit të implementuar nga GIZ, përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në modernizimin, digjitalizimin dhe lehtësimin të barrës administrative për gjeodetë, ku tani janë reduktuar ndjeshëm pengesat burokratike dhe është ofruar një zgjidhje që e mbështet zhvillimin dhe njëherit lehtëson punën e përditshme të gjeodetëve.

6.3. | Korigjimi i numrave kadastral (9000, 90000 dhe 0) në Hartën Kadastrale

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) në vazhdimësi angazhohet në përmirësimin e kualitetit të të dhënave kadastrale në funksion që të sigurojë saktësi maksimale të tyre. Duke u fokusuar në ngritjen e kualitetit të të dhënave, AKK ka bërë hulumtimin dhe analizën e të dhënave, gjegjësisht numrin e parcelave në SIKTK-HK.

Kjo qështje është ngritur si nevojë e harmonizimit të të dhënave, me ç'rast numrat e paraqitur në SIKTK-HK nuk kanë qenë numra të identifikueshëm me pjesën tekstuale SIKTK-T, përkatësisht numrat kanë qenë me shifra që nuk janë lidhur me plane kadastrale, të numëruar me O, P-O, 9000, 90000 dhe mungesë e numrit të zonës kadastrale.

Ky proces është zhvilluar si nevojë e identifikimit të numrave të vërtetë të parcelave nga qytetarët përmes gjeoportalit, për të nxjerrë kopje të planit përmes eKosovës, që të lehtësohen ZKK-të nga palët, me ç'rast bëhet edhe ngritja e kualitetit të të dhënave. Për këtë çështje fillimisht janë nxjerrë të dhënat e përgjithshme në nivel vendi për të gjitha llojet e “gabimeve të numrave” të cilët duhet të korigjohen. Më pas stafi i AKK-së ka kryer analizën dhe identifikimin e njësive në Hartën Kadastrale, por edhe duke vizituar ZKK-të.

Fillimisht kanë qenë në total 8901 numra me 9000+, 1581 numra me 90000+ dhe 2164 me shifra O, P-O. Korigjimi fillimisht është filluar nga AKK, e pastaj raportet mbi korigjimet e kryera dhe lista e njësive të mbetura, iu ka përcjellë ZKK-ve.

Numri i njësive të korigjuara nga ky proces është paraqitur më poshtë:

Deklarimi i adresës zyrtare		
Komuna	Numri total i parcelave të pa identifikuara	Numri i parcelave të korigjuara
Deçan	413	332
Dragash	88	57
Ferizaj	637	54
Fushë Kosovë	13	5
Gjakovë	1561	927
Gjilan	1035	970
Glllogoc	210	101
Graçanicë	240	142
Hani i Elezit	10	10

Istog	1173	95
Junik	241	239
Kaçanik	3	3
Kamenicë	31	30
Klinë	511	3
Klllokot	35	30
Lipjan	441	51
Novobërdë	40	25
Pejë	1239	144
Parteshë	39	32
Podujevë	822	20
Rahovec	247	52
Shtime	4	4
Skenderaj	194	89
Viti	176	94

Korigjime të përgjithshme janë 3509, por në këtë proces pas identifikimit të njësive janë vërejtur njësi të dyfishuara, dhe janë korigjuar edhe ato, ku të tilla janë paraqitur 859 raste, dmth në total ndryshime kanë pasur 4368 njësi kadastrale.

4368

Korigjime të njësive kadastrale.

PËRFAQËSIMI
NË KONFERENCA, PUNËTORI,
GRUPE PUNUESE DHE
VIZITA STUDIMORE



7

7.1. Konferenca “Avancimet në Digjitalizimin e Shërbimeve Kadastrale”

Agjencia Kadastrale e Kosovës organizoi më 20-21 Nëntor 2024, në Prizren, konferencën e saj të parë ndërkombëtare me tematikën më të diskutuar të kadastrit modern atë për digjitalizimin e shërbimeve. Organizimi i kësaj konference mes tjerash paraqet një ngjarje të rëndësishme për Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) për këtë vit, por që ky organizim shënoi vetëm hapin e parë në këtë drejtim me synimin që punimet e saj të vazhdojnë vit pas viti me zhvillime te reja, me arritje të tjera dhe në hap me trendet e shteteve të tjera.

Konferenca “Avancimet në Digjitalizimin e Shërbimeve Kadastrale” synonte të bashkonte përfaqësues nga organizata rajonale, ndërkombëtare dhe vendore për të diskutuar sfidat dhe praktikat më të mira në digjitalizimin e shërbimeve kadastrale, me qëllim të krijimit të një kadastrit të qëndrueshëm, efikas e konkurrues.

Duke kombinuar inovacionin, bashkëpunimin rajonal dhe mbështetjen e donatorëve, ky event i jashtëzakonshëm solli në pah arritjet e shumta të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, shkëmbime të vlefshme të përvojave e eksperiencave të ndryshme me të gjithë pjesëmarrësit dhe frymëzim për suksese të mëtejshme në digjitalizimin e shërbimeve dhe të ardhmen e Kadastrit.

Një nga objektivat kryesore të konferencës ishte promovimi i transparencës në shërbimet kadastrale, rrjedhimisht përmirësimi i ndërveprimit dhe bashkëpunimit ndërmjet regjistrave të ndryshëm kadastral. Pjesëmarrësit kishin mundësinë të ofronin ide dhe strategji për ndërtimin e një sistemi kadastral që do të mbështesë zhvillimin ekonomik, menaxhimin efikas të tokës dhe sigurinë mjedisore për të ardhmen.

Pjesëmarrësit, rreth 150 ekspertë dhe profesionistë nga fusha e kadastrit, institucione vendore dhe ndërkombëtare, kishin mundësinë të ndanin përvojat dhe idetë e tyre mbi implementimin e teknologjive inovative në fushën e kadastrit. Kjo konferencë shërbeu si një mundësi e shkëlqyer për të forcuar bashkëpunimin dhe për të nxitur përdorimin e zgjidhjeve digjitale që do të transformojnë kadastrin në një sistem më të shpejtë, më të saktë dhe më të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët.



Në hapje të konferencës, të pranishmit u përshëndetën nga:

- Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu, i cili theksoi rëndësinë e digjitalizimit për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës,
- Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, i cili ndau arritjet dhe projektet transformuese të agjencisë,
- Drejtori i Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje të USAID, z. Noel Bauer, që vlerësoi bashkëpunimin e ndërsjellë për avancimin e kadastrës dhe
- Presidenti i EuroGeographics, z. Tomaž Petek, që solli perspektivën evropiane dhe nënvizoi rëndësinë e harmonizimit të standardeve ndërkombëtare.

Secili nga ta në fjalën e tyre hyrëse vlerësuan lart organizimin e konferencës duke nënvizuar rëndësinë e digjitalizimit të shërbimeve, si hap jashtëzakonisht i nevojshëm për ofrimin e shërbimeve sa më të mira për qytetarët e vendit. Ministri i MMPHI-së Liburn Aliu mes tjerash përmendi edhe projektin e adresave dhe rëndësinë e suksesin e tij dhe projektet e tjera që Agjencia Kadastrale e Kosovës me sukses ka realizuar dhe po realizon çdo ditë e më shumë në fushën e kadastrit.

Edhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së Avni Ahmeti përmendi sukseset e AKK-së e gjithashtu edhe rëndësinë e nevojën e organizimit të konferencës si mundësi e jashtëzakonshme për shkëmbimin e eksperiencave, prezentimin e arritjeve dhe bashkëpunimin sa më të mirë ndërshtetërorë.


Rëndësinë e konferencës e potencoi edhe Presidenti i EuroGeographics, z. Tomaž Petek, i cili solli perspektivën evropiane dhe nënvizoi rëndësinë e harmonizimit të standardeve ndërkombëtare.



Konferenca ishte e ndarë në tre sesione dhe pas çdo sesioni u zhvilluan diskutime interesante në bazë të të cilave u nxorën edhe konkluzione dhe rekomandime konkrete.

Në panelin e parë me temën “Avancimet në Digjitalizimin e Shërbimeve Kadastrale” prezentuan:

- Ümit Yıldız, Regjistri i Tokës dhe Kadastra, Republika e Turqisë, “Trendet e fundit në Republikën e Turqisë”,
- Redi Curri, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Shqipëri, “Digjitalizimi i të dhënave nga Qendra Digjitale e Kadastrës”,
- Bojan Anastasov, Agjencia për Kadastër të Pasurive të Paluajtshme, Maqedoni e Veriut, “Dixhitalizimi në Agjencinë për Kadastër të Pasurive të Paluajtshme dhe gjeoportale në pronësi të saj”,
- Drenushë Januzi Kukaj, Agjencia Kadastrale e Kosovës, “Zhvillimet në sistemet kadastrale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës drejt digjitalizimit të shërbimeve kadastrale” dhe
- Branka Vorel Jurčević, Administrata Shtetërore Gjeodezike, Kroaci, “Zhvillimi dhe statusi i kadastrës së patundshmërive dhe kadastrës së infrastrukturës në Republikën e Kroacisë”.



Në këtë panel diskutimet u fokusuan kryesisht në tematikat e prezentuesve por duke mos u kufizuar vetëm në to. Vendi ynë me ligjin e ri për kadastër ka paraparë organizimin vertikal të AKK-së me ZKK, andaj u kërku të dihet më tepër për praktikatat e vendeve tjera në organizimin institucional të tyre. Gjithashtu në fokus të diskutimit ishin edhe praktikatat e mira që Republika e Shqipërisë ndau me të pranishmit sa i përket projektit “Digjitalizimi i të dhënave nga Qendra Digjitale e Kadastrës”. Në anën tjetër Maqedonia e Veriut ndau me të pranishmit mësimet e nxjerra në faza të ndryshme të procesit të dixhitalizimit në Agjencinë për Kadastër të Pasurive të Paluajtshme dhe zgjidhjet e mira që kanë gjetur ata. Agjencia Kadastrale e Kosovës ndau informacione sa i përket zhvillimeve të saja nëpërmjet projektit për avancimin e SIKTK-së projekt i cili do të digjitalizojë të gjitha shërbimet kadastrale. Edhe Administrata Shtetërore Gjeodezike në një prezentim online nga Kroacia sqaroi për pjesëmarrësit sfidat me të cilat u përball ky institucion në procesin e digjitalizimit.

Në panelin e dytë me temën: “Gjeoportali dhe hapja e të dhënave” prezentuan:

- Slobodanka Ključanin, Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, “Menaxhimi dhe vizualizimi i të dhënave dixhitale”
- Klaudio Çollaku, Autoriteti Gjeohapësinor, Shqipëri, “Zhvillimi i NSDI në Shqipëri”,
- Dongkyu Këak, Banka Botërore, “Zhvillimet e fundit në lidhje me përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe saktësisë së të dhënave bazuar në rastet e Indonezisë dhe Koresë”
- Milaim Sylka, Kosovë, “Kadastra e vreshtave përmes Web-GIS Innovation”,
- Charl-Thom Bayer, Land Portal, “Avancimi i të dhënave të hapura përmes inovacionit digjital” dhe
- Kujtim Mustafa, Agjencia Kadastrale e Kosovës, “Hapja e të dhënave dhe ndërveprimi në regjistra”.



Edhe në panelin e dytë të diskutimeve shtete e institucione të ndryshme ndanë me të pranishmit praktikat më të mira nga përvoja e tyre. Hapja e të dhënave, transparencja dhe ndërveprueshmëria e regjistrave të ndryshëm ishin disa nga temat në të cilat u fokusua kryesisht ky panel. Në këtë pjesë përveç prezantimeve nga vendet pjesëmarrëse të regjionit në një prezantim online u kyç edhe Dongkyu Këak ekspert i Bankës Botërore i cili dha detaje për zhvillimet e fundit në lidhje me përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe saktësisë së të dhënave bazuar në rastet e Indonezisë dhe Koresë. Gjithashtu për avancimin e të dhënave të hapura përmes inovacionit digjital foli edhe përfaqësuesi i Land Portal, i cili mes tjerash dha detaje edhe sa i përket platformës Land Portal dhe rëndësinë e digjitalizimit të shërbimeve.

Në panelin e tretë me temën: “Ndërveprimi i të dhënave ndërmjet regjistrave të ndryshëm” prezentuan:

- Dorus Kruse, Kadastra Holandeze, “Digjitalizimi i administrimit të tokës dhe regjistrave kyç në Holandë”
- Almedina Rapuca, Fakulteti i Gjeodezisë, Universiteti i Prishtinës, “Epoka e digjitalizimit: Transformimi i shërbimeve akademike në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit”,
- Helge Onsrud, Autoriteti Norvegjez i Hartave, “5 Regjistrat kyç për qeverisje të mirë”,
- Arben Damoni, Zyra e Kryeministrit, “Strategjia e ndërveprimit në Kosovë”,
- Edmond Leka, Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë, “Teknologjitë e digjitalizimit dhe kadastrin në Shqipëri” dhe
- Amir Sogojeva, Agjencia Kadastrale e Kosovës, “Lidhja e qytetarëve me adresë zyrtare”.

Në këtë panel pati ndarje të eksperiencave nga kadastrin holandez dhe ai norvegjez sa i përket temës së tretë të administrimit të regjistrave dhe ndërveprimit mes tyre. Si storie e suksesshme para pjesëmarrësve të konferencës Agjencia Kadastrale e Kosovës prezantoi projektin “Lidhja e qytetarëve me adresë zyrtare”, i cili u vlerësua lart si zgjidhje e mirë e ndërveprueshmërisë së Regjistrat të adresave dhe Regjistrat të gjendjes civile.

Një prezantim interesant ishte edhe ai në lidhje me Strategjinë e ndërveprimit në Kosovë në të cilin u sqaruan idetë dhe planet e Zyres së Kryeministrit sa i përket temës së digjitalizimit të shërbimeve në përgjithësi në të gjitha institucionet shtetërore.



Konferenca ndërkombëtare e organizuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës më 21 nëntor 2024 adresoi sfidat dhe arritjet në digjitalizimin e shërbimeve kadastrale. Diskutimet mes ekspertëve dhe përfaqësuesve nga shtete dhe organizata të ndryshme rezultuan në këto konkluzione kryesore:

1. Përshpejtimi i digjitalizimit të shërbimeve kadastrale

- Digjitalizimi është faktor kyç për përmirësimin e efikasitetit dhe qasjes së qytetarëve në shërbimet kadastrale. Kalimi nga proceset manuale në sisteme të automatizuara redukton kohën e përpunimit dhe kostot operative.
- Integrimi i platformave online është thelbësor për ofrimin e shërbimeve në kohë reale dhe të qasshme për publikun.

2. Hapja e të dhënave për transparencë dhe qeverisje të mirë

- Hapja e të dhënave kadastrale përmes platformave digjitale, si Gjeoportali i Kosovës, forcon transparencën dhe rrit besimin e qytetarëve në institucionet publike.
- Qasja e hapur ndaj të dhënave ndihmon në krijimin e një tregu të drejtë dhe të sigurt për transaksionet e pronave.

3. Ndërveprueshmëria ndërmjet regjistrave

- Harmonizimi dhe ndërveprueshmëria midis regjistrave të ndryshëm, si kadastra, noteria dhe regjistri i adresave, është jetik për një qeverisje efikase.
- Implementimi i standardeve ndërkombëtare për ndërveprueshmërinë e të dhënave është prioritet për shmangien e duplikimeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

4. Siguria dhe privatësia e të dhënave thekson nevojën për vendosjen e masave për mbrojtjen e këtyre të dhënave.

5. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

- Përvoja dhe praktikat e mira nga shtetet pjesëmarrëse (Holanda, Norvegjia, Turqia, Shqipëria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, dhe të tjera) treguan se bashkëpunimi rajonal është thelbësor për avancimin teknologjik dhe përfitimin nga zhvillimet globale.
- Përfshirja e Kosovës në organizata ndërkombëtare, si Land Portal dhe EuroGeographics, është një mundësi për të mësuar nga praktikat më të mira globale dhe për të kontribuar në harmonizimin e standardeve.

Në përmbyllje të konferencës u nënvizuan edhe disa rekomandime për të ardhmen, mes tjerash edhe që:

- Të forcohet investimi në teknologji dhe trajnimin e stafit për ta bërë kadastrën më të qasshme dhe innovative;
- Të promovohet më tej ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe sektorit privat mbi përfitimet e digjitalizimit të shërbimeve kadastrale;
- Të krijohen partneritete strategjike me ndërmjet institucioneve të ndryshme donatorët dhe institucionet ndërkombëtare për të përmirësuar teknologjitë dhe infrastrukturën digjitale.

Agjencia Kadastrale e Kosovës planifikon që me këto organizime tu oforjë profesionistëve të fushës një udhërrëfyes të qartë për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kadastral të Kosovës, duke synuar përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe qasjes në të dhëna për të gjithë.



7.2. | Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Land Portal

Land Portal është një platformë globale që ofron informacione dhe burime në lidhje me çështjet e tokës dhe menaxhimin e saj. Ajo shërben si një burim i hapur për të promovuar transparencën, qasjen dhe të drejtat mbi tokën në nivel global.

Land Portal mbledh të dhëna, politike dhe hulumtime nga organizata ndërkombëtare, qeveri, shoqëri civile dhe ekspertë, për të ndihmuar vendimmarrësit dhe studiuesit që të kenë një bazë më të mirë për vendimet e tyre.

Sipas përshkrimit në faqen zyrtare të Land Portal thuhet se qasja në informacion është vendimtare për arritjen e qeverisjes së mirë të tokës dhe sigurimin e të drejtave pronësore për njerëzit pa tokë dhe të pambrojtur. Përmirësimi i qasjes në të dhënat dhe informacionet lidhur me tokën është misioni ynë.

Kjo është ajo që Land Portal bën:

- Ofron një platformë për të dhënat tokësore, botimet, lajmet, blogjet, përmbajtjet multimediale dhe shumë më tepër nga një rrjet ndërkombëtar organizatash dhe institucionesh. Grumbullimi i përmbajtjeve të ndryshme dhe shumë të shpërndara ndihmon në vënien në dispozicion të të gjithëve të të dhënave të fshehura.
- Ushqen ekosistemin e informacionit duke lidhur bazat e të dhënave tokësore, duke bashkuar koleksionet e fragmentuara të të dhënave dhe duke pasuruar përmbajtjen me metadata që përputhen me standardet dhe parimet e Open Data.
- Nxiti debatin midis atyre që punojnë mbi çështjet lidhur me tokën anembanë botës nëpërmjet ngjarjeve, diskutimeve dhe webinarëve.
- Të mbështesin ofruesit e informacionit nga sektori i tokës për të përdorur standardet Open Data dhe për të inkurajuar krijimin dhe marrjen e një infrastrukture të dhënash bazuar në standardet e bazuara në parimet FAIR (Findable, Accessible, Interoperable and Reusable - E gjetur, E qasshme, E ndërperueshme dhe E ripërdorshme).

Andaj duke i pasur parasysh të gjitha këto mundësi që ofron ky portal anëtarësimi i Kosovës është një hap strategjik dhe i rëndësishëm që reflekton përkushtimin e vendit tonë për të përmirësuar transparencën, qasjen në të dhëna dhe menaxhimin efikas të burimeve të tokës. Ky nuk është thjesht një status simbolik, por një hap konkret drejt përmirësimit të administrimit të tokës, rritjes së transparencës dhe përfshirjes në bashkëpunime ndërkombëtare që do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Pjesëmarrja e Z. Charl-Thom Bayer njërit nga themeluesit e Land Portal në Konferencën “Avancimet në Digjitalizimin e Shërbimeve Kadastrale” organizuar nga AKK-ja në nëntor krijoi mundësi konkrete për fillimin e procedurave për krijimin e profilit të Kosovës në këtë platformë.

Profili dhe të dhëna të tjera nga Kosova do të plotësohen në vazhdimësi dhe Land Portal do të jetë mundësi e jashtëzakonshme e Kosovës që të promovojë avancimet, arritjet dhe sukseset e saj në fushën e kadastrit dhe të dhënave gjeohapësinore.



7.3. | Pjesëmarrja në Konferencën Vjetore të Bankës Botërore për Menaxhimin e Tokës

Një delegacion nga Kosova, i udhëhequr nga Ministri i MMPHI-së, Liburn Aliu, së bashku me ekspertet e AKK-së, Drenushë Januzi Kukaj dhe Ardita Megjuani, mori pjesë në Konferencën vjetore të Bankës Botërore për Tokën, që u mbajt nga 13 deri më 17 maj në selinë e Bankës Botërore në Washington DC. Kjo konferencë kishte si fokus politikat për menaxhimin e tokës, faktorët e suksesshëm në administrimin e tokës, vlerësimin e pronës, etj. Ajo zgjati 5 ditë dhe rekomandimet dhe përvojat që shtetet morën nga ky organizim ishin shumë të rëndësishme për planifikimin e politikave të administrimit të tokës. Në këtë ngjarje, morën pjesë 21 ministra dhe përfaqësues nga 81 shtete të botës.



7.4. | Pjesëmarrja në Asamblenë e Përgjithshme të EuroGeographics

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të EuroGeographics, që u mbajt në Sevilla të Spanjës, ku morën pjesë 115 delegatë nga 37 shtete dhe 10 organizata të ftuara. Aktiviteti dy ditor u organizua nga Instituti Kombëtar Gjeografik i Spanjës, me mbështetje nga Drejtoria e Përgjithshme e Kadastrës.

Në kuadër të kësaj Asambleje, delegacioni i AKK-së ka takuar Kryetarin e EuroGeographics, Colin Bray, Sekretaren e Përgjithshme dhe Drejtoreshën Ekzekutive, Sallie Payne Snell, dhe Menaxheren e Komunikimit, Patricia Sokacova.

Në këtë konferencë, u adresuan sfidat globale për menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave gjeohapësinore, me fokus në të ardhmen e këtyre të dhënave dhe rëndësinë e tyre për reagimin ndaj katastrofave natyrore dhe implementimin e politikave klimatike.

Në këtë takim me udhëheqësit e këtij institucioni është diskutuar mundësia e bashkëpunimit për paraqitjen e të dhënave kadastrale në hartën regjionale evropiane, si dhe për organizimin e një Konferencë Ndërkombëtare në Kosovë për rolin e të dhënave gjeohapësinore.

Pjesëmarrja e AKK-së në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare thekson angazhimin e Agjencisë për të qëndruar në hap me zhvillimet e fundit në fushën e kadastrit dhe gjeohapsirës, duke ofruar informacione të sakta dhe të besueshme për zgjidhjen e sfidave globale. Agjencia Kadastrale e Kosovës është anëtare e EuroGeographics që nga viti 2003, e cila është organizata ndërkombëtare që përfaqëson autoritetet shtetërore për kadastrë dhe regjistrimin e pronës në Evropë.



7.5. | Pjesëmarrja në Forumin e 10-të të EUPOS,

Përfaqësuesit nga AKK-ja, Specialisti i Hartografisë dhe GIS-it Avni Rrustemi dhe Bashkim Shaqiri Zëvendësues i Drejtorit në Drejtoratin Ligjor kanë marrë pjesë në Takimin Ndërkombëtar të prodhuesve të të dhënave të Euro Geographics i cili është mbajtur me 6 dhe 7 nëntor 2024 në Bruksel Belgjikë, në Zyrën Qendrore të Euro Geographics në Bruksel, të organizuar nga Instituti Kombëtar Gjeografik Belgjikë.

Tema e këtij takimi ka qenë: Të informohemi mbi prodhimin e të dhënave për vitin 2025 për EuroBoundaryMap (EBM), EuroRegional Map (ERM) dhe EuroGlobalMap (EGM) që do të përfshijë një përditësim në Open Maps for Europe 2.

Agjencia Kadastrale e Kosovës në këtë takim në mënyrë aktive ka paraqitur të arriturat dhe progresin në fushën e Gjeoinformacionit, Kadastrës, Sistemit të adresave si dhe sfidat dhe planet për të ardhmen.

Gjithashtu palët u zotuan rreth bashkëpunimit, kontrollit të kualitetit të të dhënave hapësinore, eliminimi i barrierave të ndërveprimit të të dhënave dhe për paraqitjen e këtyre të dhënave në hartën regjionale Evropiane.



7.6. | Pjesëmarrja në Konferencën Rajonale SPATIAL II

Delegacioni nga Agjencia Kadastrale e Kosovës mori pjesë në konferencën rajonale të projektit SPATIAL II, e organizuar nga Administrata Federale për Çështjet Gjeodezike dhe të Pronës së Paluajtshme të Bosnjës dhe Hercegovinës. Punëtorja u mbajt me 7 dhe 8 Mars 2024, në Mostar, Bosnje-Hercegovinë.

Në këtë konferencë, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka paraqitur në mënyrë aktive arritjet dhe progresin e bërë në fushat e Gjeo-informacionit, Kadastrës, Sistemit të Adresave, si dhe ka diskutuar për sfidat dhe planet e saj për të ardhmen.

Temat kryesore të kësaj konference rajonale përfshijnë:

- **Potencialin e përfitimeve nga distanca e imazheve** për aplikacione të ndryshme, duke përfshirë hartimin dhe zbulimin e objekteve, si dhe mbledhjen e të dhënave për ndërtesat dhe strukturat e tjera.
- **Potencialin e përdorimit të teknikave të avancuara** si Inteligjenca Artificiale, pika cloud dhe vizualizimet 3D, për aplikacione që lidhen me të dhënat gjeohapsirë, që ndihmojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve gjeoinformative.
- **Strategjitë për ndarjen e gjeodatave**, përfshirë standardet ndërkombëtare, zgjidhjet e bazuara në cloud, sigurinë kibernetike, shërbimet e menaxhimit të të dhënave dhe menaxhimin e përdoruesve.



Kjo konferencë ofroi mundësi për shkëmbim përvojash dhe ide të reja, si dhe mundësoi avancimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e gjeoinformacionit dhe kadastrës.

7.7. | Konferenca Rajonale për Teknologjitë Gjeohapësinore në Neum, Bosnjë dhe Hercegovinë

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), mori pjesë në konferencën rajonale “Ditët e Infrastrukturës të së Dhënave,” organizuar nga Administrata për Çështjet Gjeodezike dhe Pronës së Paluajtshme e Bosnjës dhe Hercegovinës, më 17-18 tetor 2024, në Neum, Bosnjë-Hercegovinë.

Konferenca mbledhi përfaqësues nga sektorët publik dhe privat, akademia, si dhe administrata gjeodezike nga rajoni për të diskutuar zhvillimet në teknologjitë gjeohapësinore dhe ndikimin e tyre në shoqëri. Pjesëmarrësit ndanë përvoja dhe ide për të ardhmen e infrastrukturës të së dhënave hapësinore dhe bashkëpunimin e mëtutjeshëm rajonal.



7.8. | Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar dhe Konferencën INTERGEO

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorë nga AKK, morën pjesë në Konferencën vjetore të INTERGEO, e cila u mbajt nga 24 deri më 26 shtator në Stuttgart të Gjermanisë. INTERGEO ofroi një platformë për prezantimin e zgjidhjeve inovative në fushën e gjeoinformacionit dhe një mundësi për të mësuar rreth tendencave dhe zhvillimeve më të fundit të industrisë.

Më shumë se 100 folës dhe 600 kompani morën pjesë, duke shfaqur pajisjet dhe teknologjitë e fundit. Kryetari i DVW e.V., Prof. Dr. Ing. Rudolf Staiger, theksoi rëndësinë e INTERGEO si një mundësi për shkëmbimin e ideve dhe krijimin e kontakteve të vlefshme në industrinë e gjeoinformacionit.



7.9. | Vizita studimore në Kadastrin Holandez

Me ftesë të Kadastrit Holandez, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, së bashku me tre ekspertë të AKK-së, qëndruan për një vizitë studimore në Holandë. Gjatë vizitës, ekspertët holandez njoftuan delegacionin e AKK-së për praktikatat më të mira të punës në fushën e kadastrit, avancimet e shërbimeve kadastrale, projektet realizuara me sukses dhe sfidat me të cilat janë përballur ata.

Vizita, e cila u realizua në disa qytete të Holandës, filloi me prezentime mbi avancimet në kadastrin 3D, topografinë, sigurinë e të dhënave, E-shërbimet dhe tema të tjera të ngjashme. Nga kjo vizitë, ekspertët e AKK-së morën njohuri të vlefshme për implementimin e projekteve të planifikuara për këtë vit, si dhe për planifikimin dhe avancimin e projekteve të reja bazuar në praktikatat më të mira të shteteve evropiane. Gjithashtu, ekspertët e AKK-së ndanë me nikoqirët informacion për avancimet e fundit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, sidomos në lidhje me digjitalizimin e shërbimeve, projektet në realizim dhe planet për të ardhmen.



7.10. | Vizitë studimore në Kroaci dhe Slloveni për praktikat më të mira në migrim dhe vendbanim

Një delegacion i institucioneve të ndryshme të Kosovës ka realizuar një vizitë studimore në Kroaci dhe Slloveni. Përveç përfaqësuesve nga Ministria e Brendshme, Agjencia për Regjistrim Civil dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, pjesë e delegacionit ishte edhe Specialist i GIS-it në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Amir Sogojeva.

Vizita është realizuar në kuadër të Grupit Teknik për Migrim të Brendshëm dhe Autoritetit Qendror për Migrim, me qëllim të marrjes së informacionit dhe praktikave më të mira rreth vendbanimit, vendqëndrimit dhe migrimit të brendshëm. Kjo vizitë ka kontribuar në përditësimin dhe plotësimin e Ligjit për Vendbanim dhe Vendqëndrim, ndërsa informacionet e mbledhura do të shfrytëzohen nga AKK-ja për projektin e lidhjes së qytetarit me adresë.



7.11. | Konferenca rajonale “Dita e Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore-2024”, në Maqedoninë e Veriut

AKK përmes një delegacioni ka marrë pjesë në konferencën rajonale “Dita e Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH) -2024” në Shkup, Maqedonia e Veriut.

Në këtë konferencë të organizuar nga Agjencia për Paluajtshmëri dhe Kadastër (AREC) e Maqedonisë së Veriut, u diskutuan trendet dhe risitë në fushën IKIH-së në regjionin e Ballkanit perëndimor. Delegacioni nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në këtë konferencë në mënyrë aktive ka paraqitur të arriturat dhe progresin në fushën e IKIH-së në Republikën e Kosovës, sfidat dhe planet për të ardhmen.



7.12. | Konferenca Regjionale për Zvogëlimin e Barrës Administrative

Ekspertë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës ishin pjesë e Konferencës Regjionale për Zvogëlimin e Barrës Administrative me titull "Formësimi i agjendës për zvogëlimin e barrës administrative në Ballkanin Perëndimor — Mundësitë, Sfidat, Reformat".

Në këtë konferencë ku pati pjesëmarrës nga institucione të niveleve qendrore e lokale vendore dhe të vendeve të regjionit, përfshirë zyrën e Kryeministrit, udhëheqës të Zyres së BE-së në Kosovë, ekspertë nga GIZ, Banka Botërore, Ministrinë, e Agjencitë, u trajtuan elementet kryesore të agjendave ambicioze të reformës për përmirësimin e mjedisit rregullator dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe biznese, me synim të nxitjes së diskutimeve produktive rreth parimeve të përditësuara të OECD/SIGMA për administratën publike, me fokus të veçantë që ky përmirësim të ndikojë në hartimin dhe mbikëqyrjen e agjendave të reformave në rajon.



7.13. | Pjesëmarrës në Punëtorinë për Implementimin e Programit të Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, bashkë me kolegë nga AKK-ja, morën pjesë në një punëtori dy ditore të organizuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me USAID dhe Programin për Qeverisje Ekonomike.

Përveç pjesëmarrësve nga AKK dhe MMPHI, ishin të pranishëm edhe zyrtarë nga niveli lokal, përfshirë Drejtoritë e Kadastrit dhe Urbanizmit.

Tema kryesore e takimit ishte ofrimi i një pasqyre të përgjithshme për implementimin e procesit të legalizimit deri në atë fazë dhe shkëmbimi i praktikave më të mira gjatë trajtimit të aplikimeve për objektet e Kategorisë II. Pjesëmarrësit shkëmbyen raste konkrete dhe diskutuan format më të mira të zgjidhjeve dhe elementët që mund të ndryshohen për të përmirësuar procesin e legalizimit.



KOORDINIMI I PROJEKTEVE

8

8.1. | Bashkëpunimi me Bankën Botërore - Projekti për kadastrin e pronës së paluajtshme dhe infrastrukturë gjeo-hapësinore (REGIP)

Qeveria e Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave me datë 15.11.2018, ka negociuar marrëveshjen Financiare me Bankën Botërore për projektin për Regjistrimin e Pronës dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore (REGIP), ID P164555 në shumën prej 14.6 milion Euro. Projekti është ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës me datë 23.07.2020 dhe është bërë efektiv me datë 02.09.2020.

Ky projekt do të zbatohet në periudhën pesë (5) vjeçare nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) në bashkëpunim të ngushtë me Zyrat Komunale Kadastrale (ZKK). Palët e tjera të interesit janë Ministria e Financave (MF), dhe institucionet tjera që janë pjesë e Komitetit ndërmëtor për administrimin e tokave dhe infrastrukturës kombëtare për informacion hapësinor (IKIH). Institucionet e tjera publike dhe private që prodhojnë dhe menaxhojnë të dhëna gjeohapësinore do të përfshihen sipas nevojës.

Implementimi i projektit REGIP do të ndihmojë Republikën e Kosovës në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të tokës, i cili kryesisht do të kontribuojë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Gjithashtu do të kontribuojë në përmirësimin e mëtutjeshëm të shërbimeve kadastrale dhe përmirësimin e legjislacionit, duke lehtësuar mbrojtjen dhe sigurinë e të drejtave pronësore dhe krijimin e një mekanizmi të lehtë, dhe të sigurt për transaksionet e pronës së paluajtshme në vend.

Objektivi zhvillimor i projektit është të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe cilësisë të administrimit të tokës, të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore.

Qëllimi i projektit është të sigurojë mbështetje ligjore dhe institucionale për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, vazhdimi i punëve të rindërtimit të informacioneve kadastrale, krijimin e kadastrit të përçojave, zhvillimin e mëtutjeshëm të kadastrit të ndërtesave, shërbimet për përmirësimin e cilësisë së të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë — SIKTK, Kompletimin e Sistemit të Adresave dhe renovimin e zyrave kadastrale në Komunitet e mbetura. Gjithashtu qëllimi i mëtutjeshëm i projektit është të zbatojë strategjinë për Teknologjinë Informative të AKK-së dhe Strategjinë e Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH) në Kosovë.

AKK gjatë vitit 2024 ka pritur dy herë delegacionin nga ekipi i Bankës Botërore, të cilët kanë qëndruar në vizitë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) në periudhën 03 — 07 qershor 2024, dhe në periudhën 14 — 18 tetor 2024. Përveç diskutimeve nga afër për progresin e aktiviteteve të projektit REGIP, delegacioni ka marrë pjesë edhe në takimet e koordinimit të donatorëve dhe komitetit ndërmëtor për Administrim të Tokës dhe Infrastrukturë Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) të organizuara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë këtyre vizitave.



Progresi i aktiviteteve sipas komponentëve është siç vijon:

Komponenti B. Modernizimi i Kadastrit

Objektivi i këtij komponenti është vazhdimi i modernizimit të kadastrit në Kosovë, e cila filloi në kuadër të projektit paraprak për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër (RECAP). Ky komponent do të financojë sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) rindërtimin e informacioneve kadastrale deri në 140 Zona Kadastrale; (b) përmirësimi i cilësisë së të dhënave kadastrale; (c) zhvillimin e kadastrit të përçojave; (d) zhvillimin e regjistrimit të ndërtesave në Komunitet e mbetura; dhe (e) renovimin dhe ri-inzhinjerimin e Zyrave Kadastrale Komunale në Komunitet Veriore

Implementimi i Planit të Veprimit për Informim publik

Qëllimi i projektit është të implementohet plani i veprimit të ndërgjegjësimit dhe komunikimit, për të rritur kapacitetin e AKK-së dhe ZKK-ve për të komunikuar me publikun, klientët e tyre dhe me palët e tjera të interesuara. Për të koordinuar aktivitetet e informimit publik është nënshkruar Memorandum i Bashkëpunimit me ATRC-në në kuadër të projektit PIAKOS. Përmes këtij bashkëpunimi, ATRC do të mbështesë AKK-në me informim publik për shumicën e projekteve. Kjo mbështetje do të jetë me prodhimin dhe shpërndarjen e videove të ndryshme që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve që do të realizohen nga AKK-ja.

Për implementim të planit të veprimit të ndërgjegjësimit dhe komunikimit është kontraktuar një Kompani profesionale dhe kontrata është nënshkruar më 17 dhjetor 2024.

Rindërtimi i informacioneve kadastrale në 115 Zona kadastrale

Ky është projekti kryesor kapital në kuadër të REGIP, dhe për të pasur benefite maksimale për qytetarët në Zonat Kadastrale të parapara në këtë projekt, si dhe për të pasur gjithë përfshirje të akterëve të involvuar në fushën e kadastrit dhe administrimit të tokës në Republikën e Kosovës. Me aprovimin e Ligjit të ri për Kadastër të pronës së paluajtshme Nr.08 L-237, në pjesën e parë të vitit 2024 janë hartuar dhe miratuar 11 Udhëzime Administrative për implementim të këtij ligji, si dhe më pas janë hartuar edhe udhëzuesit teknik të punës për matjet, krijimin, ndryshimet dhe regjistrimin e njësive kadastrale — parcelave, ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave, si dhe Udhëzuesi për Rindërtimin e Kadastrit. Kompletimi i kësaj kornize ligjore ka hapur rrugën për të filluar me procedurat e prokurimit për Rindërtimin e Informacioneve Kadastrale në 115 Zona Kadastrale. Për të mbështetur këtë proces, janë punësuar pesë (5) staf profesional vendor (juristë dhe gjeodetë), si dhe janë përgatitur të gjitha dokumentet e nevojshme për të mbështetur implementimin e këtij projekti.

Nënshkrimi i kontratave për implementim të këtij projekti së bashku me kontrollin e kualitetit pritet të bëhet në fillim të vitit 2025. Ky proces do të varet nga vazhdimi i afatit kohor për implementim të projektit REGIP.




Foto - Harta me zonat e rindërtuara deri më 2017 si dhe zonat që do të rindërtohen (115 Zona Kadastrale)

Korrektimi i të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë — SIKTK

Qëllimi i projektit është të arrihet kualitet më i lartë i të dhënave kadastrale si dhe rritje e besueshmërisë në të dhëna. Kjo do të krijojë mundësi shumë më të mëdha për hapjen e të dhënave për palë të ndryshme të interesit edhe jashtë institucioneve të kadastrit, gjeodezisë dhe hartografisë, etj.

Projekti është në fazën finale të prokurimit. Nënshkrimi i kontratës për implementim të këtij projekti pritet të bëhet në fillim të vitit 2025. Ky proces do të varet nga vazhdimi i afatit kohor për implementim të projektit REGIP.

Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave grafike në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit të Ndërtesave

Ky projekt ka për qëllim azhurnimin e të dhënave grafike për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave të cilat kanë qenë të krijuara në formate dhe standarde teknike të cilat nuk janë në përputhshmëri të plotë me avancimet e teknologjisë së SIKTK-HK. Gjithashtu të dhënat për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave do të konvertohen në përputhshmëri të plotë me udhëzimet si dhe kornizat e punës aktuale për regjistrim dhe mirëmbajtje të dhënave grafike për njësi kadastrale. Kontrata për implementim të këtij projekti është nënshkruar me 19.09.2024 dhe projekti pritet të përfundojë në qershor 2025.

Komponenti C. Teknologjia e Informacionit dhe Infrastruktura Gjeohapësinore

Objekti i këtij komponenti është të bëjë investime në sistemet e IT-së dhe investime për të dhënat gjeohapësinore për tregun e tokës dhe pronës në Republikën e Kosovës dhe do të mbështesë zbatimin e strategjive të AKK- së për IT dhe Infrastruktura Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH). Ky komponent do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) përmirësimin e Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë në drejtim të Arkitekturës së Orientuar në Shërbime (SIKTK-AOSH); (b) Arkivin digjital të AKK-së; (c) investimet në IKIH (ang. NSDI); dhe (d) Zhvillimi i mëtutjeshëm i rrjetit shtetëror gjeodezik të GPS-it, KOPOS.

Rilevimi aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës është autoriteti përgjegjës për prodhimin dhe menaxhimin e rilevimit aerofotogrametrik për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Për shkak të zhvillimeve të shpejta në vend, ortofotot e reja prodhohen çdo 3-5 vjet. Ky aktivitet do të mbështesë shfrytëzuesit e të dhënave gjeohapësinore me ortofoto të reja me kualitet të lartë për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Kontrata për këtë aktivitet është nënshkruar me 06.07.2023 dhe ka përfunduar me 31.12.2024

Zgjerimi i qendrës së të dhënave të AKK-së (Hardware+Software)

Shërbimet dhe sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë të hostuara në Qendrën e të dhënave Primare (në AKK), gjithashtu sistemet kryesore të TI-së replikohen në qendrën e rimëkëmbjes (DRC) e cila gjendet në ndërtesën e Rilindjes. Meqë e gjithë infrastruktura e lartpërmendur është implementuar në vitin 2016 dhe duke pasur parasysh që pajisjet janë liferuar me garancion 3 vjeçar është e domosdoshme zëvendësimi i tyre sa më parë për të mos shkaktuar ndërprerje apo humbje të shënimeve. Gjithashtu me këtë projekt pritet që të përmbushen kërkesat për infrastrukturë TI (harduer- HË dhe softuer-SË) për projektet e shumta të cilat janë në proces dhe ato që pritet të zhvillohen në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Shumica e këtyre projekteve kërkojnë nga tri ambiente pune, atë për zhvillim, për testim dhe atë real (të prodhimit). Kontrata për këtë projekt është nënshkruar me 06.02.2024 dhe është përfunduar me 07.06.2024.

Avancimi i Sistemeve Kadastrale

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka krijuar një sistem të avancuar për regjistrimin e pronës së paluajtshme në vend "Sistemi Informativ Kadastral i Tokës së Kosovës" (SIKTK). Ky sistem pritet të avancohet me module të reja për shërbime sa më cilësore, të sakta, transparente dhe të shpejta për qytetarët e Republikës së Kosovës. Sistemi është krijuar për të ndërvepruar me sistemet e institucioneve dhe grupeve të tjera të interesit për akses në të dhënat kadastrale. Ky projekt ka filluar të implementohet me 21.05.2024 dhe pritet të përfundojë në Maj 2025.

Zhvillimi i Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH)

Qëllimi i këtij aktiviteti është përmirësimi ose zhvillimi i një Gjeoportali të ri të IKIH-së për Kosovën si dhe avancimi i gjeoportalit ekzistues shtetëror. AKK do të menaxhon këtë Gjeoportali, i cili është ëeb portal që funksionon si një adresë e qasjes në informacione gjeografike në internet. Gjeoportali i IKIH-së do t'i ofrojë AKK-së një mënyrë për të ofruar një pamje konsistente me kontrollin e qasjes dhe procedurat për aplikacione dhe baza të të dhënave të shumta. Përmes Gjeoportalit do të shpërndahen të gjitha informacionet gjeohapësinore të IKIH-së të institucioneve përgjegjëse në Kosovë sipas dispozitave të Projektligjit për IKIH-në në përputhje me Direktivën INSPIRE. Për implementim të këtij projekti është kontraktuar një Kompani profesionale dhe kontrata është nënshkruar më 18 dhjetor 2024 dhe pritet të përfundojë në gusht 2025.

Prodhimi dhe instalimi i tabelave me emra të adresave të rrugëve dhe numrave të hyrjeve të objekteve

Projekti i Sistemit të Adresave ka filluar në vitin 2010. Fillimisht i mbështetur nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe më vonë nga Autoriteti Norvegjez për Hartografi (Statens Kartverk) pritet të kompletohet me mbështetje të projektit REGIP.

Me përfundimin e Sistemit të Adresave, një nga standardet Evropiane për integrimin në BE do të përmbushet, i cili është transpozimi i direktivës INSPIRE 2007/2 e cila parashikon sigurimin / publikimin e të dhënave gjeo-hapësinore, sigurimin e shërbimeve më të shpejta dhe funksionale për qytetarë në shumë zona; mundëson lidhjen e bazës së të dhënave me adresat ndërmjet institucioneve të ndryshme përfituese, etj. Projekti është ndarë në dy lote, respektivisht prodhimin dhe instalimin e 1,530 tabelave me adresa të rrugëve në Komunat e mbetura Junik, Shtërpçë, Ranillug dhe Novobërdë, si dhe prodhimin dhe instalimin e 336,000 numrave të hyrjeve të objekteve në 22 Komuna të mbetura. Kontrata ka filluar me implementim me 08.03.2024 dhe pritet të përfundojë në prill 2025.

Lidhja e sistemit të adresave me regjistrin civil

Qëllimi kryesor i projektit është të mbështesë AKK-në në plotësimin, azhurnimin e të dhënave në regjistrin kadastral dhe mbështetjen e komunave përmes ndërlidhjes ndërmjet Sistemit të Informacionit të Regjistrit të Adresave (ARIS), Sistemit të Regjistrimit të Gjendjes Civile (CSRS) dhe Informacionit të Kadastrit të Tokës në Kosovë (SIKTK). Ky projekt është duke implementuar në bashkëpunim midis AKK-së, ARC-së dhe ASHI-së. Udhëhequr nga MMPHI dhe organizuar nga AKK është mbajtur takimi me kryetarët e komunave për t'i informuar ata për procesin dhe përgjegjësitë gjatë këtij projekti. Duke filluar nga 01.10.2024, janë kontraktuar 55 punonjës për mbështetjen e zyrave komunale të gjendjes civile. Projekti pritet të përfundojë me 31.08.2025.

Skanimi i dokumenteve arkivore kadastrale

Objektivi i përgjithshëm i projektit është skanimi dhe indeksimi i dokumenteve të arkivuara kadastrale dhe integrimi i këtyre dokumenteve në SIKTK. Rezultati i projektit është digjitalizimi i përgjithshëm i dokumenteve arkivore kadastrale. Projekti zhvillohet në 4 ZKK (Prishtinë, Podujevë, Gjiilan dhe Istog) si dhe dokumentet arkivore kadastrale në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës dhe AKK-në. Për implementim të këtij projekti është angazhuar një kontraktor dhe kontrata është nënshkruar me 13 dhjetor 2024 dhe pritet të përfundojë në Maj 2025.

Angazhimi i stafit profesional në kuadër të NJIP-REGIP

Gjatë periudhës raportuese është angazhuar specialisti për Informim Publik, ekspertë shtesë të GIS-it për të përkrahur projektet e Sistemit të Adresave (5) dhe ekspertët për përkrahje të Rindërtimit të Kadastrit (5).

8.2. | Bashkëpunimi me USAID-in

Aktiviteti i USAID-it Qeverisja e Pronës është një aktivitet pesëvjeçar që synon të përmirësojë sistemin e të drejtave pronësore në Kosovë për të reduktuar korrupsionin, rritur fuqizimin e grave në sistemin e të drejtave formale të pronës dhe investimet në pronën e paluajtshme. Aktiviteti zhvillohet në partneritet me shoqërinë civile, sektorin privat dhe akterë tjerë që ndikojnë në avancimin e zhvillimit ekonomik dhe demokratik në Kosovë.

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka pasur një bashkëpunim të mirë me këtë projekt edhe gjatë vitit 2024, i cili ka mbështetur AKK-në në organizimin e dy takimeve të radhës të Komitetit Ndërmëtor për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor, mbajtjen e takimit me Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës, Konferencën ndërkombëtare “Avancimet në Digjitalizimin e Shërbimeve Kadastrale”, si dhe mbajtjen e punëtorive të ndryshme dhe Komitetin e Praktikave të mira.

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur gjithsej 8 punëtori dhe 4 takime të Komitetit për praktika të mira në kuadër të Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës.

8.3. | Bashkëpunimi me GIZ-in

Në kuadër të përkrahjes për digjitalizimin e shërbimeve, GIZ në bashkëpunim me AKK-në ka përkrahur zhvillimin e Sistemit për licensimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete, i cili është lancuar me datë 14 nëntor 2024. Kjo përkrahje është një hap i rëndësishëm përpara në modernizimin, digjitalizimin dhe lehtësimin e barrës administrative për gjeodetë duke ofruar zgjidhje në lehtësimin e punës së përditshme të tyre. Për më tepër ky sistem përveç që do të lehtësojë procedurën do të rris transparencën dhe do të krijojë dosje për secilin gjeodet që licencohet e ofron shërbime.

8.4. | Bashkëpunimi me Qeverinë Holandeze — Projekti Spatial II për Ballkanin Perëndimor

Aktivitetet e projektit gjatë vitit 2024:

- Punëtorja për metodologjitë më të reja në grumbullimin e të dhënave gjeohapësinore e mbajtur me 7 - 8 Mars 2024, në Mostar, Bosnje Hercegovinë;
- Vizita studimore e ekspertëve të AKK-së në Kadastrin Holandez në periudhën 27-30 Maj 2024, për tu njoftuar me praktikat më të mira të punës në fushën e kadastrit, avancimet e shërbimeve kadastrale me theks të veçantë tek krijimi i kadastrit të përçojave;
- Përkrahje për AKK-në me këshilla profesionale për specifikat teknike për projektet e korrektimit të të dhënave në SIKTK dhe Gjeoportalin për IKIH.
- Takimi përmblylës i projektit i mbajtur në Beograd me 4-6 dhjetor 2024 me konkluzionin e rëndësishëm të implementimit të një sistemi kadastral të qëndrueshëm në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare, si dhe mundësia që të ketë përkrahje të mëtutjeshme nga Qeveria Holandeze me një projekt të ri.


8.5. | Bashkëpunimi me OSBE-në - Kontrollimi i lëndëve të AKKVP-së

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me OSBE-në përmes mbështetjes së punëtorive të ndryshme për zyrtarët e Zyrave Kadastrale Komuna, po ashtu edhe përmes angazhimit të praktikantëve të cilët i kanë të përfundura studimet nga fusha juridike.


AKK gjatë vitit 2024, nga OSBE është mbështetur me 4 praktikant të cilët për veç përfitimit të përvojës praktike nga fusha e kadastrit, ata kanë ndihmuar AKK-ën edhe në çështje tjera. Gjatë periudhës së angazhimit të tyre janë kontrolluar 12100 lëndë të vendosura nga Agjencia e Pronave, se a janë të zbatuar në kadastër. Nga kontrollimi i këtyre lëndëve është ardh në përfundim se të gjitha janë të regjistruara në regjistrin e të dhënave kadastrale.

Statistika për lëndët e kontrolluara

Numri i lëndëve	Në emër të komunitetit serb	Në emër të komunitetit shqiptar	Në emër të gruas	Në emër të burrit
12100	11996	100	2517	9583



TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT



9.1. | Mirëmbajtja e dhomës së serverëve

Mirëmbajtja e dhomës së serverëve ka vijuar pa ndërprerje gjatë vitit 2024. Kontrata e mëparshme dyvjeçare, me titull “Mirëmbajtja e sistemit TI (Klimë dhe UPS në dhomën e serverëve) të AKK-së,” përfundoi në gusht 2024, pas realizimit të suksesshëm të të gjitha serviseve periodike, të planifikuara çdo tre muaj. Më 2 gusht 2024, është lidhur një kontratë e re me afat dyvjeçar, e cila do të mbulojë mirëmbajtjen deri në gusht 2026.

9.2. | Aktivitete rreth sigurisë

9.2.1. | Skanimi i sigurisë

Skanimi i sigurisë nga Departamenti i TI në Agjencinë Kadastrale të Kosovës është një proces thelbësor për të mbrojtur integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e të dhënave kadastrale dhe sistemeve të saj. Duke identifikuar dobësitë në infrastrukturën ekzistuese, ky proces ndihmon në parandalimin e sulmeve kibernetike, si dhe në minimizimin e rreziqeve që mund të rezultojnë nga qasjet e paautorizuara, malware ose kërcënimet e tjera.

Për më tepër, skanimi i rregullt i sigurisë siguron që të gjitha sistemet dhe aplikacionet të jenë në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Si pjesë e këtij procesi, së fundmi është realizuar një skanim i praktikave më të mira në File Server, Active Directory, duke përdorur modulën e integruar të Sistemit Operativ.

Rezultatet e skanimit në File Server: Pas kryerjes së skanimit, u konstatua se konfigurimi i File Serverit është në nivel optimal dhe nuk ka tregues për ndonjë sulm kibernetik. Në këtë server është instaluar roli DeDuplication, i cili mundëson eliminimin e të dhënave të dyfishta, duke optimizuar në këtë mënyrë përdorimin e hapësirës së diskut.

Rezultatet e skanimit në Domain Controller: Është realizuar një skanim i praktikave më të mira në Domain Controller, duke përdorur modulën e integruar të Sistemit Operativ. Rezultatet treguan se konfigurimi i Domain Controller është në nivel optimal dhe nuk ekzistojnë fusha të hapura për sulme kibernetike. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të raportit të menaxhimit të Active Directory, u evidentua se veçoria Recycle Bin nuk është aktivizuar. Recycle Bin në Active Directory është një funksionalitet i rëndësishëm sigurie, i cili ruan të gjitha objektet e fshira për një periudhë prej 180 ditësh, duke lejuar rikthimin e tyre në rast të fshirjes aksidentale, pa humbur të dhëna apo qasje. Aktivizimi i kësaj veçorie është rekomanduar për të përmirësuar sigurinë dhe menaxhimin e të dhënave.

Skanimi i nivelit të qasjeve: Përmes veglës ADAudit, u realizua një skanim i nivelit të qasjeve të përdoruesve të Active Directory. Gjatë këtij procesi u identifikua se disa përdorues kanë qasje të tepruar në sistemet e informacionit dhe në infrastrukturën e TI-së. Gjithashtu, u konstatua prania e përdoruesve kolektiv, të cilët përdoren nga shumë individë njëkohësisht, duke e bërë të vështirë identifikimin e saktë të aktiviteteve për secilin individ.

DTI ka ndërmarrë masa të menjëhershme për krijimin e përdoruesve individualë, duke reduktuar kështu përdorimin e përdoruesve kolektiv. Megjithatë, procesi i kalimit të plotë të të drejtave nga përdoruesit kolektiv tek ata individualë është ende në proces.

Një hap tjetër i rëndësishëm për rritjen e sigurisë ka qenë rregullimin e qasjeve në sistemet reale të informacionit për kadastrë dhe gjeoinformacion, sipas standardeve të TI për siguri, ashtu që në sistemet reale të kenë qasje vetëm administratorët përgjegjës të DTI. Në këtë mënyrë OE-të zhvilluese/mirëmbajtëse, të cilët kanë kontrata të përkohshme me AKK-në, të kenë qasje të kufizuar vetëm në ambiente testuese. Kjo masë është ndërprerë pas interpretimit të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nga Departamenti Ligjor në AKK, se “çdo person fizik apo juridik që nënshkruan kontratë me kohë të caktuar me institucion publik ka të drejta dhe obligime sikurse një zyrtar i atij institucioni që ka kontratë me kohë të pacaktuar”.

9.2.2. | Përditësimi dhe Siguria e Pajisjeve të Rrjetit dhe Infrastrukturës

Përditësimi i pajisjeve të rrjetit, si Access switch-at, Core Switch-at dhe Firewall-at, është thelbësor për të siguruar performancë optimale, siguri dhe stabilitet të rrjetit. Përditësimet shpesh përfshijnë korrigjime për dobësi të sigurisë që mund të shfrytëzohen nga sulmet kibernetike, duke mbrojtur kështu të dhënat dhe sistemet e AKK-së. Gjithashtu, ato sjellin përmirësime në funksionalitete, rritin efikasitetin dhe mbështesin standardet më të reja të rrjetit, duke mundësuar integrimin e teknologjive moderne. Në mungesë të përditësimeve, rrjeti mund të jetë i prekshëm ndaj sulmeve dhe të mos përmbushë nevojat në rritje të përdoruesve. Prandaj, përditësimi i rregullt ndihmon në ruajtjen e një infrastrukture të fortë dhe të besueshme.

Azhurnimi i Access Switch-ve: Nga platforma Cisco është shkarkuar versioni më i fundit i firmware-it për switch-at. Pas realizimit të kopjeve rezervë, janë azhurnuar 10 access switch-e në qendrën primare dhe 2 në qendrën sekondare (DRC). Për të shmangur ndërprerjet e shërbimeve, të gjitha këto azhurnime janë realizuar jashtë orarit të rregullt të punës.

Azhurnimi i Core Switch-ve: Për të ruajtur nivelin e sigurisë dhe në përputhje me rekomandimet e prodhuesit Cisco, është shkarkuar dhe instaluar versioni më i fundit i sistemit operativ për core switch-et. Instalimi është kryer jashtë orarit zyrtar të punës për të minimizuar ndikimin në shërbime. Gjatë procesit, pajisjet dështuan të ndizen dhe të startojnë normalisht, duke përfshirë edhe ROMON Mode, çka shkaktoi ndërprerje totale të komunikimit në të gjitha nivelet. Pas tentativave për rikthim të pajisjeve, në bashkëpunim me OE janë siguruar dy switch-e të ngjashëm nga KEDS që ishin hequr nga përdorimi. Këto pajisje u zëvendësuan dhe u konfiguruan me parametrat e fundit nga pajisjet e dëmtuara. Pas disa orësh pune, përfshirë zgjidhjen e problemeve me PortChannel mode dhe firewall-et, shërbimet u rikthyen rreth orës 1:30 të mëngjesit. Pas liferimit të dy Core Switch-ve të rinjë nga Cisco pa kosto shtesë, këta switch-e u azhurnuan dhe konfiguruan sipas praktikave më të mira, ndërsa switch-et e vjetër u kthyen te KEDS. Pavarësisht se këto pajisje janë pjesë kyçe e infrastrukturës, procesi u përfundua pa ndërprerje të mëdha në shërbime.

Firewall-at janë pjesë thelbësore e sigurisë së një organizate. DTI ka zbatuar masa të rrepta mirëmbajtjeje sipas standardeve dhe praktikave më të mira. Gjatë këtij viti janë zëvendësuar firewall-et e vjetër me modele më moderne dhe me kapacitet të shtuar. Gjithashtu, janë rishikuar të gjitha rregullat e sigurisë dhe është implementuar politika “zero trust,” e cila ndalon çdo qasje përveç atyre specifikisht të lejuara. Firewall-at janë azhurnuar disa herë gjatë vitit me firmware-in më të fundit për të mbyllur çdo vrimë të mundshme sigurie. Këto masa kanë përmirësuar ndjeshëm sigurinë dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës



9.2.3. | Përditësimi i infrastrukturës Virtuale

Në Agjencinë Kadastrale të Kosovës është përfunduar me sukses përditësimi i infrastrukturës virtuale, një hap i nevojshëm për të përmirësuar performancën, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve kritike. Ky përditësim përfshinte kalimin e VMware vCenter nga versioni 8.0.2 në versionin më të fundit, azhurnimin e 6 hosteve ESXi në qendrën primare dhe 4 ESXi hostave në DRC, si dhe përditësimin e vSphere Replication dhe Site Recovery Manager (SRM) në versionet e tyre më të reja. Procesi u realizua jashtë orarit të punës për të siguruar ndikim zero në funksionimin e përditshëm të shërbimeve të Agjencisë dhe për të shmangur çdo ndërprerje në proceset operative.

Ky përditësim adresoi disa dobësi kritike në aspektin e sigurisë të versioneve të mëparshme, të cilat mund të shfrytëzoheshin nga sulmet kibernetike. Azhurnimet përfshinin korrigjime të dobësive të njohura, përmirësime në mekanizmat e autentifikimit dhe enkriptimit, si dhe mbështetje për standarde më të larta të sigurisë. Kjo e bën infrastrukturën më rezistente ndaj kërcënimeve të jashtme dhe ndihmon në mbrojtjen e të dhënave sensitive që menaxhon agjencia.

Përveç përmirësimeve të sigurisë, përditësimi ka sjellë edhe risi në performancë dhe menaxhim. Versionet e reja ofrojnë optimizim, rritje të efikasitetit në replikimin dhe rikuperimin e të dhënave, si dhe funksionalitete të avancuara për monitorimin dhe menaxhimin e hosteve dhe makinave virtuale. Përgatitja dhe ekzekutimi i këtij procesi u krye me një planifikim të detajuar për të minimizuar rreziqet gjatë përditësimit. U përdorën praktikat më të mira të industrisë, duke përfshirë teste paraprake, backup të plotë të të dhënave dhe konfigurimeve, dhe monitorim të vazhdueshëm gjatë dhe pas përditësimit.

9.2.4. | Përditësimi i Sistemeve Operative të Serverëve

Është realizuar përditësimi i sistemeve operative të 12 serverëve, duke kaluar nga versionet ekzistuese në Windows Server 2022. Sistemet e mëparshme operative ishin jashtë mbështetjes zyrtare nga Microsoft, duke krijuar rreziqe të mëdha në aspektin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve. Ky përditësim ka sjellë përmirësime të rëndësishme në performancë, siguri dhe funksionalitet, duke përfshirë mbështetje për teknologji më të avancuara dhe optimizim të burimeve të serverëve.

Përditësimi është kryer me një planifikim të kujdesshëm, duke përfshirë backup të plotë të sistemeve dhe koordinim jashtë orarit të punës për të shmangur ndërprerjet në shërbimet kritike. Rezultati është një infrastrukturë më e sigurt dhe më e aftë për të përballuar kërkesat në rritje të përdoruesve, duke garantuar qëndrueshmëri dhe qëndrueshmëri të shërbimeve që ofrohen nga AKK.

9.3. | Monitorimi

Stafi i TI-së bënë monitorim të vazhdueshëm të infrastrukturës së TI-së në qendrën primare dhe sekondare (DRC). E gjithë infrastruktura e TI-së përmes sistemeve siç janë Aria Operations, ADAudit Plus, UptimeRobot, OPManager Plus dhe pajisje me sistem të vetin monitorues. Monitorohen 24/7 dhe notifikojnë me email stafin e TI-së për ndonjë problem që mund të paraqitet në pajisje\sisitem, tentim për ndonjë veprim të dyshuar që mund të cenojë sigurinë e të dhënave dhe sistemeve kompjuterike dhe kalkulohen trendet e shfrytëzimit të resurseve kompjuterike në qendrat e të dhënave.

Për çdo anomali, në funksionim të sistemeve apo dështim të pajisjeve harduerike, që janë identifikuar përmes monitorimit, DTI ka ndërmarrë hapat e duhur në kohën e duhur për sanimin e tyre.

Në tabelë i gjeni të paraqitura ndryshimet në vlerat e shfrytëzuara, për periudhën 12 mujore të këtij viti, për resurset kompjuterike CPU, RAM dhe Storage në Qendrën e të dhënave të AKK-së:

Resursi kompjuterik	Janar	Dhjetor
CPU	146 Ghz	210 Ghz
RAM	1.45 TB	1.88 TB
Storage	104 TB	133 TB

Infrastruktura fizike e teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve digjitale, që ofrohen nga AKK, janë tejet komplekse dhe po zgjerohen vazhdimisht. Monitorimi i tyre është i pa mundur pa ndihmën e platformave specifike të avancuara të monitorimit.

Pas nxjerrjes së raporteve nga sistemet monitoruese del që për vitin 2024 e gjithë infrastruktura e TI-së ka qenë “UPTIME” 99.6%, ndërsa të gjitha aplikacionet e AKK-së kanë qenë të qasshme nga rrjeti i brendshëm 99.92% ndërsa nga rrjeti i jashtëm (interneti) 99.8%.

9.4. | Testimi i ngritjes së shërbimeve në DRC

Drejtorati i TI-së në vitin 2019 ka krijuar dokumentin “Procedurat për Rimëkëmbjen e TI-së në Rast Fatkeqësie”, ky dokument përshkruan procedurat që duhet të ndjekin Administratorët e TI-së së AKK-së për rimëkëmbjen e sistemeve teknologjike në rast fatkeqësive. Përshkruan hapat që duhet ndjekur për testimin e një Plani të rimëkëmbjes, migrimin e planifikuar të serverëve virtual në qendrën sekondare (DRC) si dhe rimëkëmbjen e të gjitha sistemeve kritike nga qendra sekondare në rast të dështimit të qendrës primare. Ky dokument parasheh që këto procedura të ndjeken dhe testohen çdo 6 muaj, respektivisht në Qershor dhe Dhjetor të çdo viti.


Testimi i rregullt 6 mujor është bërë në Qershor dhe Dhjetor të këtij viti, ku janë ngritur shërbimet në qendrën sekondare të të dhënave duke simuluar gjendjen e reale e një “Disaster Recovery”. Përmes SRM është inicuar Disaster Recovery ku virtual makinat e replikuara ngritën në qendrën e dytë në një rrjet virtual të izoluar me qëllim të testimit të funksionimit të kalimit nga qendra e parë në të dytën dhe pa shkaktuar pengesa në ambientin real. Testimi ka dalë të jetë i suksesshëm dhe virtual makinat janë kthyer përsëri në gjendjen normale në qendrën e parë të të dhënave.

9.5. | Administrimi i Sistemeve të Infromacionit (SI), databazave dhe qasjeve

Një prej aktiviteteve të rëndësishme të AKK-së është edhe administrimi i Sistemeve të Informacioneve (SIKTK-SOA, SUUSK, SIKTK-HK, SIRA, SI-RIK, KOPOS, Intranet, Sistemi i faturimit, Gjeoportali, etj.) në kuptimin e përgatitjeve të ambienteve për testime, trajnime dhe ambienteve reale, sipas kërkesave dhe nevojave. Pjesë e rëndësishme e administrimit të SI është edhe administrimi i databazave, qasjeve, zhvillimi i skripteve TSQL për nxjerrjen e raporteve, statistikave për qëllime të hulumtimit ose të kontrollës së kualitetit të të dhënave kadastrale dhe të tjera në nivel të databazave.

Për aspekte të zhvillimeve të reja dhe mirëmbajtjes së SI (SIKTK-SOA, SUUSK, SIKTK-HK, SIRA, SI-RIK, Gjeoportali), AKK ka angazhuar OE.

BUXHET DHE FINANCA



10

10.1. | BUXHETI

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2024 ka hyr në fuqi me datën 29.12.2023 përmes LIGJIT Nr.08/L-260 MBI NDARJET BUXHETOTRE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVË PER VITIN 2024.

Buxheti final i ndarë për AKK-në për vitin 2024 ka qenë në vlerë prej: **7,874,405.00 €**, nga dy fonde të financimit, Granti i Qeveris dhe Huamarrja.

Buxheti i shpenzuar në total nga dy fondet e financimit ka qenë: **4,725,816.47 €**, apo 60%

10.2. | Ndarja dhe realizimi i buxhetit

Buxheti i ndarë dhe realizuar sipas kategorive

Destinimi	Buxheti	Shpenzim (€)	Buxhet/Shpenzim %
Totali:	1,633,860.00 €	973,565.27 €	58
Pagat	479,945.86	479,945.86	100
Mallra dhe Shërbime	600,000.00	278,498.23	46
Komunali	5,500.00	2,011.19	37
Pasuri jo financiare	585,000.00	213,109.99	36





Tabela 2. Pasqyra e buxhetit dhe shpenzimeve sipas kategorive, Fondi burimor 04-06, Huamarrja

Destinimi	Buxheti	Shpenzim (€)	Buxhet/Shpenzim %
Totali:	6,240,545.00 €	3,752,251.38 €	60
Mallra dhe Shërbime	470,000.00	400,146.18	85
Pasuri jo Financiare	5,770,545.00	3,352,105.20	58



Numri i lëndëve të realizuara - pagesa në total është: 724 lëndë

TE HYRAT

Vlera e të hyrave për vitin 2024 është: 159,284.02€ nga dy kategoritë e të hyrave, licencave dhe produkteve tjera.

1. Pasqyra e të hyrave sipas kostos

Kodet	Janar-Mars	Prill-Qershor	Korrik-Shtator	Tetor-Dhjetor	Totali
50401	26,044.00 €	33,588.50 €	28,879.05 €	51,852.45 €	140,364.00 €
50201	5,400.00 €	2,800.00 €	6,400.00 €	4,320.02 €	18,920.02 €
BK	31,444.00 €	36,388.50 €	35,279.05 €	56,172.47 €	159,284.02 €



Numri i faturave të lëshuara gjatë vitit 2024 ka qenë 1618.

2. Sasia e produkteve sipas llojit

	Emërtim i Produktit-Shërbimit	Sasia
1	DK, 04/2024 Regjistrimi i të drejtave në bazë të Aktvendimit mbi shqyrtimin e trashëgimisë apo Testamentit	9
2	DK, 04/2024 Regjistrimi i të drejtave bazë të Kontratës së dhurimit	5
3	DK, 04/024 Tarifa për regjistrimin e të drejtave të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat këtij Udhëzimi Administrativ	1
4	DK, 04/24 Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor)	15
5	DK, 04/2024 Korrigjimi i të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasojë e dokumentacionit të dorëzuar nga palët	19
6	AKK, 04/24 Pikat e kufijve të njësive kadastrale Y, X	779
7	AKK, 04/24 Leje për kompani gjeodezike	9
8	AKK, 04/24 Licencë - Gjeodet	49
9	AKK, Tarifa për krijimin e çasjes për shërbime online, për një përdorues UEB aplikacione	3
10	DK, 04/24 Tarifa për regjistrimin e njësisë së re kadastrale	26
11	DK, Kopja e planit	143

12	DK, 04/24 Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura)	7562
13	DK, 04/24 Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona	23
14	DK, 04/24 Historiati për njësi kadastrale - deri në pesë (5) njësi	15
15	DK, 04/24 Regjistrimi i të drejtave në bazë të vendimit të organit administrativ, gjuqësor dhe çdo dokumenti juridik që parashihet fitimi i pronësisë	35
16	AKK, 04/24 Tarifa 1 mujore për një shfrytëzues - RTK	15
17	AKK, 04/24 Tarifa 6 mujore për një shfrytëzues - RTK	11
18	AKK, 04/24 Tarifa 1 vjetore për një shfrytëzues - RTK	149
19	AKK, 04/24 Regjistrimi fillestar i një shfrytëzuesi	59
20	AKK, 04/24 CD-kompakt disku	7
21	AKK, 04/24 Parcela në format digjital (shpfile,dëg, gml, ili) mbi 5 ha	47
22	AKK, 04/24 Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 2 .01 ha deri 5 ha	27
23	AKK, 04/24 Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 1.01ha deri 2 ha	27
24	AKK, 04/24 Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) deri në 1 ha,	116
25	AKK, 04/24 Pikat e kufijve të njësive kadastyrle Y, X	54
26	AKK, 04/24 Tarifa për verifikimin e informacioneve për njësi kadastrale.	22882
27	AKK, 04/24 Tarifa për verifikimin e informacioneve për person	2648
28	AKK, 04/24 Regjistrimi i hipotekës	4097
29	AKK, 04/24 Tarifa për krijimin e çasjes për shërbime online, për një përdorues UEB SHËRBIME si institucion	4
30	AKK, 04/24 Gjeoreferencimi i hartave kadastrale	6
31	AKK, 04/24 Skanimi i hartave	6

32	AKK, 04/24 Transformimi i koordinatave	664
33	AKK, 04/24 Harta topografike 2016 1:25000 - PDF - për fletë te hartës	11
34	AKK, 04/24 Printimi - A4 bardh - zi	93
35	DK, Tarifa e mbajtjes se përrjetshme për person	1
36	DK, 09/2020-Tarifa për regjistrimin e pronësisë ne baze te ndërrimit këmbimit te pronës se paluajtshme për secilin pronar	2
37	DK, Regjistrimi fillestar per instutacione(SUUSHK)	1
38	SIKTK, (2019)Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura)	4
39	AKK, 2019-08 Tarifa 1 vjetore për një shfrytëzues - Rinex dhe Postprocesim	3
40	AKK, 2019-08 Informata për njësi kadastrale	142
41	AKK, 2019-08 Modeli digjital i terrenit MDT 2018 për km2	4
42	AKK, 2019-08 Harta kadastrale digjitale - e vjetër	5
43	AKK, 2019-08 Ortofoto digjitale - urbane 2018	1
44	AKK, 2019-08 Harta kadastrale, vektor - letër e thjeshtë-horizontal (1:500, 1:1000, 1:2500, 1:5000)	1
TOTALI		39780

Kategoria	Vlera €
Pajisje të teknologjisë informative	586,335.00
Kompjuter	1,255.00
Avancimi i Sistemeve Kadastrale	844,960.00
Pajisje të tjera	68,955.09
Mjete të transportit	19,879.99
Pasuri të pa prekshme	51,568.41
Investime në vijim	1,366,014.57
TOTALI	2,938,968.06 €

Plani për integritetit 2024 - 2026

Është hartuar Plani i Integritetit nga Agjencia Kadastrale e Kosovës i aprovuar dhe protokolluar me Nr. 01/132/24 i datës 25.01.2024.

Qëllimi i hartimit të këtij plani është bërë duke marrë parasysh se AKK është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave. Si institucion i nivelit qendror, jemi të ndërgjegjshëm për shkallën dhe kompleksitetin e korrupsionit dhe të çështjeve të integritetit me të cilat përballlemi ne si AKK.

Përballja efektive me korrupsionin nga ana e institucioneve të qeverisjes qendrore është me rëndësi jetike për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjes, si dhe mundësimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e Republikës së Kosovës. Duhet theksuar që integriteti është një komponent kyç i çdo organizate të suksesshme. Ai është thelbësor për ruajtjen e besimit të publikut, parandalimin e mashtrimit dhe korrupsionit si dhe sigurimin e pajtueshmërisë me aktet ligjore. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht.

Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Prandaj, unë deklaroj përkrahjen time të plotë dhe përkushtimin tim maksimal për të gjitha përpjekjet që fuqizojnë dhe zhvillojnë e përmirësojnë vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

PASURI 2024

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka të regjistruar pasuri në vlerë prej : **4,906,487.79 €**

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar në total: **2,938,968.00 €** si pasuri jo financiare.

1.Pasuria sipas kategorive ekonomike të regjistruara gjatë vitit 2024

10.3. | PROKURIMI PUBLIK

AKK dorëzon raportin vjetor mbi kontratat e nënshkruara publike për aktivitetet e prokurimit publik të AKK-së për vitin fiskal 2024 në Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik, duke paraqitur një analizë të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në AKK, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë vitit 2024.

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) brenda 15 ditëve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal 2024 ka përgatitur dhe dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP), Planifikimin Final të Prokurimit, duke u bazuar në kërkesat e njëjësive kërkuese të aprovuara nga personat përgjegjës për buxhet dhe Drejtorit Ekzekutiv, me ç'rast planifikimi i prokurimit ka qenë konform buxhetit të AKK-së për vitin fiskal në fjalë.

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) bazuar në planifikimin final të prokurimit për vitin fiskal 2024, ka zhvilluar 5 aktivitete të prokurimit. Secili proces i prokurimit në AKK është administruar përmes këtyre hapave në vijim:

- planifikimi i prokurimit;
- parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës;
- përcaktimi i procedurës së prokurimit;
- përgatitja e dosjes së tenderit;
- publikimi, hapja dhe vlerësimi i tenderëve;
- dhënia dhe nënshkrimi i kontratës; si dhe
- menaxhimi i kontratës.

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, AKK ka paraqitur të gjitha kontratat e nënshkruara. Tabela në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2024 në AKK.

Nr	Përshkrimi i kontratës	Vlera e kontratës	Data e lidhjes së kontratës
1	Mirëmbajtja e Sistemeve të Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës (SIKTK)	332,880.00€	31.05.2024
2	Avancimi i infrastrukturës së TI-së (HW+SW) - Furnizim me Llaptop	6,487.00€	24.05.2024
3	Mirëmbajtje e sistemit TI (Klimë dhe UPS, në dhomën e serverëve)	21.948,00€	02.08.2024
4	Transmetim Live Mbulim Medial	916.00€	06.06.2024
5	Analizimi, korrigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaboreteve të shpronësimit	471,750.00€	29.10.2024

TRAJNIMET E OFRUARA



11.1. | Trajnimet e Gjeodetëve

Kandidatet për gjeodet, si dhe gjeodetët e licencuar për vazhdim licence, të cilët janë paraqitur me kërkesa për licencimin, përkatësisht ri licencimin e tyre si person fizik, apo si kandidat për Kompani Gjeodezike.

Duke u bazuar në aktin nenligjor në fuqi Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 06/2024 për Dhënien e Lejes Kompanive Gjeodezike dhe Licencimin e Gjeodetëve, me të cilin përcaktohen procedurat, kushtet dhe kriteret e dhënies së lejes kompanisë gjeodezike, dhe licencimit të gjeodetit, parashihen edhe trajnimet për kandidatet për licencim.

Gjatë vitit 2024, trajnimet për kandidatet për leje dhe licenca janë ofruar nga fusha juridike, regjistrimi i pronave të paluajtshme, pjesa tekstuale dhe grafike, si dhe trajnim specifik mbi sistemet kadastrale me të cilat mirembahet regjistri pronesor dhe kadastral në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2024 në Republikën e Kosovës janë trajnuar për veprimtari profesionale gjithsejtë 91 gjeodetë:

Periudha e aplikimit 2024	Numri i aplikuesve
Janar	22
Mars	14
Korrik	28
Tetor	27
Gjithsejtë	91

11.2. | Trajnimet e stafit për ndërlidhjen e qytetarit me adresë zyrtare

Për procesin e ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare janë trajnuar 55 konsulentë të cilët janë kontraktuar për mbështetje të komunave dhe 34 zyrtar të urbanizmit të 34 komunave, gjithsej 89 staf. Trajnimi është realizuar për procedurat e ndërlidhjes dhe lëshimin e formularit për identifikim të adresës përmes Sistemit të Informimit të Regjistrimit të Adresave (ARIS).

11.3. | Trajnimet e shfrytëzuesve të SIKTK nga institucionet tjera

11.3.1 | Agjencia Kadastrale e Kosovës Mban Trajnim për Zyrtarët e Agjencisë Pyjore të Kosovës

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, u mbajt një trajnim për disa zyrtarë të Agjencisë Pyjore të Kosovës, me fokus në përdorimin dhe qasjen në të dhënat kadastrale. Ky trajnim është organizuar pas nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, që ka për qëllim thjeshtësimin dhe përmirësimin e procedurave për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre përkatëse.

Trajnimi ofroi mundësinë për të ndarë njohuri dhe teknika të reja që do të ndihmojnë Agjencinë Pyjore të Kosovës në përdorimin e saktë dhe efikas të të dhënave kadastrale në punën e përditshme.

Agjencia Kadastrale e Kosovës vazhdon të jetë e angazhuar në digjitalizimin e shërbimeve kadastrale dhe ofrimin e shërbimeve sa më efikase dhe cilësore për qytetarët e Kosovës.



LICENCIMI I GJEODETËVE
DHE
KOMPANIVE GJEODETE



12

12 | LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODETE

12.1. | Reformimi i procesit të licencimit

Agjencia Kadastrale e Kosovës është përgjegjëse për licencimin e Gjeodetëve dhe Kompanive gjeodezike bazuar në Ligjin Nr. 08/-L-237 për Kadastër të pronës së paluajtshme. Me Udhëzimin Administrativ MMPHI nr.06/2024 për dhënien e lejes kompanive gjeodezike dhe licencimin e gjeodetëve, përcaktohen procedurat, kushtet dhe kriteret e dhënies së lejes kompanisë gjeodezike, dhe licencimit të gjeodetit, emërimi, përbërja dhe puna e Komisionit për leje dhe licencim si dhe tarifat për dhënien e lejes dhe licencës. Ndër ndryshimet kryesore është pragu i kalueshmërisë, mosha e pensionimit dhe kushtet për licencim. Ndryshime me këtë udhëzim janë bërë edhe në përbërjen e komisionit duke përfshirë një antër të propozuar nga Ministria dhe një nga Oda e Gjeodetëve, ku mandati i tyre është një vjeçarë.

Testi për licencim nga viti 2024 ka ndryshuar strukturën, përmbajtjen dhe mënyrën e zhvillimit. Tashmë gjeodetët në përmbajtjen e testimit kanë të përfshirë edhe fushën e gjeodezisë përpos asaj të kadastrit. Në test gjeodetët testohen edhe me një detyrë në zgjidhjen e një rastit nga “terreni i paramenduar”.

Gjatë vitit 2024 në Republikën e Kosovës janë licencuar për veprimtari profesionale gjithsejtë 52 gjeodetë, dhe 10 kompani Gjeodezike.

12.2. | Zhvillimi dhe funksionalizimi i aplikacionit për aplikim përmes platformës e-Kosova

Fillimisht janë bërë ndryshimet në bazën ligjore ku janë nxjerrë UA-të e reja në mënyrë që të përshkruhet aplikimi i ri përmes platformës eKosova. Me këtë rast janë reduktuar procedurat e tepërta që kanë qenë për aplikim fizik dhe është krijuar infrastruktura e re për aplikim online, me anë të së cilës nuk ka nevojë për dorëzimin e dokumenteve në formë fizike meqenëse validohen në mënyrë digjitale përmes këtij aplikacioni dhe ndërlidhjes me sistemet tjera siç është eKosova. Në kuadër të komponentës për reduktimin e barrës administrative, ky projekt është bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe është implementuar nga GIZ-i gjerman. Pronësinë e këtij sistemi e ka Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe njëkohësisht është përgjegjëse për mirëmbajtjen e këtij sistemi.







Me metodat për aplikim siç kanë qenë deri më tani, kanë ekzistuar edhe shumë sfida, ndër to: proces i gjatë dhe i ndërlikuar, qasje e kufizuar, kosto më e lartë, dokumente të shumta, procedura dhe vonesa burokratike, afat i shkurtër kohorë dhe mundësi aplikimi vetëm në ditë pune dhe brenda orarit zyrtarë të punës. Për të aplikuar kanë qenë disa hapa që duhet ndërmarrë siç janë grumbullimi i dokumenteve të nevojshme, sjellja e dokumenteve fizikisht në zyrat e AKK-së, mbajtja e trajnimit në një ditë tjetër të përcaktuar në AKK, mbajtja e testit në lëmin e gjeodezisë dhe kadastrës në një datë tjetër të përcaktuar, e në fund pas kalimit të testit komisioni i licencimit ka verifikuar në mënyrë fizike për listën kontrolluese për kushtet e kërkuara, pastaj për të marr fizikisht një ditë tjetër vendimin dhe për të bërë pagesën dhe marr licencën fizikisht në AKK.

Nga janari 2025, kemi hequr pengesat burokratike, kemi thjeshtuar procedurën e licencimit, kemi hequr dokumentacionin e tepërt dhe kemi rritur efikasitetin, e në veçanti po kontribuojmë në mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave. Në afatin e janar 2025 kanë aplikuar suksesshëm mbi 40 aplikant dhe pritet të procedohet tutje me hapat e më tutjeshëm.


Cili është qëllimi i projektit:

- Transformimi digjital i shërbimeve publike
- Reduktimi i barrës për qytetarë dhe shërbyes
- Zhvillim i sistemit të avancuar fundor (back-office)
- Ekspozimi i shërbimeve në platformë (front-office)
- Ndërlidhja e sistemeve dhe regjistrave
- Ndërlidhja e veglave dhe shërbimeve tjera
- Parimi “vetëm një herë” (Once-only principle)
- Parimi “fillimisht digjitale” (Digital first)
- Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve

QËLLIME TË TJERA

-  Eliminimi i pengesave burokratike
-  Thjeshtimi në procesin e licencimit
-  Reduktimi për dokumentet e tepërta
-  Qasje të lehtë për të gjithë
-  Të rrisim efikasitetin
-  Mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave

Për të dizajnuar fillimisht këtë sistem kanë marrë pjesë shumë akterë ndër ta:





Përfitimet:

- Përmirësim i shërbimeve — Më pak burokraci, më pak vonesa dhe më shumë transparencë në çdo hap të procesit.
- Krijimi i një administrimi të drejtë dhe të besueshëm — Duke garantuar mbrojtjen e të dhënave dhe profesionalizëm të lartë në trajtimin e çdo procesi.
- Rritje e efikasitetit dhe forcimi i institucioneve — Reduktim i dokumentacioneve të tepërta dhe përmirësim i proceseve që sigurojnë funksionim më efikas.


Ndër përfitimet tjera është edhe koha e aplikimit, pavarësisht që nuk ka ndryshuar as me UA e reja që janë nxjerr që është e paraparë 15 ditë, tani me metodat e aplikimit online përmes eKosovës mund të aplikojnë 24 orë në ditë nga 1 deri 15 në afatet e hapura, dhe jo siç ka qenë më parë vetëm në ditët e punës zyrtarë dhe brenda orarit zyrtarë të punës.

Si të aplikojmë tani me këtë sistem të ri:



Siç mund të shihet edhe nga hapat që duhet ndjekur tani janë reduktuar metodat fizike dhe vetëm trajnimi dhe testimi do të mbahen në mënyrë fizike, ndërsa të gjithë hapat e tjerë janë në formën online përmes platformës eKosova.

Në platformën eKosova është vendosur një dritare e re ku janë listuar shërbimet për licencim, si në figurën e paraqitur:



Më pastaj mund të shihen linqet tjera ku mund të përdoren për shërbimet e licencimit dhe shërbimet KOPOS, shih figurën e mëposhtme:

- Apliko për licensë të gjeodetit
- Apliko për leje të kompanisë gjeodezike
- Gjeodetët e licensuar
- Monitoro statusin e aplikimeve dhe ankesave për licensim/leje
- Kërkesë për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit KOPOS
- Lista e lejeve dhe licensave gjeodezike

Apliko për licensë të gjeodetit

Në këtë modul mund të aplikohet për licencim të gjeodetëve, në afatet kur hapen nga komisioni i licencimit, dhe me hapa shumë të lehtë mund të ngarkohen dokumentet e kërkuara dhe të njoftohen në kohë reale për të gjitha hapat dhe datat kur do të mbahet trajnimi dhe testi. Në rastin kur aplikanti me sukses kalon të gjitha hapat, në këtë platformë të eKosovës mund të bëjë pagesën online për licencim dhe të shkarkojë licencën.

Apliko për leje të kompanisë gjeodezike

Në këtë modul mund të aplikohet përmes platformës eKosova për kompani gjeodete. Janë thjeshtuar shumë hapa dhe si rezultat nuk ka nevojë të ngarkohet ndonjë dokument. Për këtë licencim mund të aplikojnë përfaqësuesit ose pronarët e kompanisë, të dhënat të cilat validohen nga ARBK. Lista e gjeodetëve vetëm përzgjidhet në bazë të numrit personal të tyre. Ashtu sikur në modulën e licencimit për gjeodetë edhe këtu mund të njoftohen për të gjitha njoftimet e rëndësishme që duhet të kenë, të përfundojnë pagesat në formën online dhe të marrin licencën.

Gjeodetët e licensuar

Ky është një modul i hapur që nënkupton nuk ka nevojë për qasje në platformën eKosova, ku do të shfaqet lista e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të cilët janë të licensuar. Përveç listës me të dhënat bazike, do të shfaqen edhe adresa dhe numrat kontaktuar në mënyrë që qytetarët mund të marrin kontaktet e tyre ose të verifikojnë nëse kompania ose gjeodeti ka licencë valide.

Monitoro statusin e aplikimeve dhe ankesave për licensim/leje

Në këtë modul mund të bëhet monitorimi i aplikimeve si për gjeodetë ashtu edhe për kompani gjeodete. Ku mund të përditësojnë të dhënat e tyre ose plotësimin e ndonjë dokumenti të kërkuar nga komisioni për licencim.

Kërkesë për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit KOPOS


Përveç licencave për gjeodetë dhe kompani gjeodete, kemi digjitalizuar edhe shërbimet e sistemit KOPOS, ku përmes këtij moduli mund të bëjnë kërkesë për regjistrim fillestarë për tu qasur në shërbimet e KOPOS ose të vazhdojnë abonimin për shfrytëzuesit aktual. Të gjitha pagesat kryhen në platformën eKosova dhe shërbimet në kohë rekord mund t'i marrin të gjithë ata që kanë bërë pagesën në mënyrë të suksesshme.

Lista e lejeve dhe licensave gjeodezike

Në këtë modul mund të shohin licencat dhe vendimet e tyre gjeodetët dhe kompanitë gjeodete. Poashtu përmes këtij moduli mund të bëjnë ankesat e tyre nëse kanë. Në rastin kur ka kërkesë edhe për ndryshime ose kontakt me komisionin, mund të përdorin këtë modul që të parashtrojnë të gjitha kërkesat për komisionin e licencimit.

Periudha e aplikimit 2024	Numri i aplikuesve	Numri i zyrave të kontrolluara	Numri i licencave për kompani gjeodezike	Numri i licencave për gjeodetë
Janar	22	16	03	13
Mars	14	12	03	09
Korrik	28	20	02	18
Tetor	27	14	02	12
Totali	91	62	10	52

MONITORIMI I ZYRAVE
KADASTRALE KOMUNALE,
KOMPANIVE TË LICENCUARA
GJEODETE DHE
GJEODETËVE TË LICENUAR



13 | MONITORIMI I ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE, KOMPANIVE TË LICENCUARA GJEODETE DHE GJEODETËVE TË LICENUAR

13.1. | Monitorimi i punës dhe aktiviteteve të Zyreve Kadastrale Komunale

Konform Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është përgjegjëse për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve kadastrale të kryera sipas dispozitave të këtij ligji si dhe dhënien e rekomandimeve dhe urdhrave për eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë mbikëqyrje.

Me qëllim të realizimit të fazës së nëntë (9) të mbikëqyrjes së aktiviteteve kadastrale për periudhën kohore tetor-dhjetor të vitit 2024.[1], sipas Vendimit Nr. 01/1645/24 të datës 22.10.224, AKK ka themeluar Grupin Punues për: “Monitorimin e punëve dhe aktiviteteve kadastrale”, përgjegjës për realizimin e kontrollit të kualitetit të lëndëve të cilat janë të regjistruara në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK).

Monitorimi faza e parë dhe faza e dytë (15 tetor-15 dhjetor), është realizuar për të gjitha Komunitatet e Republikës së Kosovës. Për këtë interval kohor janë kontrolluar gjithsejtë rreth 500 lëndë për pjesën pronësore — juridike, kurse për mbi 500 lëndë për pjesën grafike/teknike.

Procesi i kontrollit të kualitetit nënkupton kontrollin e ecurisë së regjistrimit të lëndës në SIKTK, në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi. Duke filluar nga faza e aplikimit të qytetarit, regjistrimi i lëndës nga ana e zyrtarit të ZKK-së, deri tek produkti final, printimi i Certifikatës së pronës dhe dorëzimi tek qytetari. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar cilësi dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve kadastrale duke forcuar kështu besueshmërinë e qytetarëve tek institucionet publike.

Me qëllim të adresimit të të gjitha mangësive që mund të kenë ndodhur gjatë regjistrimit dhe duke synuar që të gjitha veprimet e ardhshme të kryhen në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi, aspekti i përgatitjes së rekomandimeve për eliminimin e këtyre parregullsive është i një rëndësie të veçantë.

Përveç përgatitjes së rekomandimeve të detajuara për eliminimin e parregullsive, AKK do të ofroj edhe trajnime profesionale për stafin e ZKK-ve.

Për të siguruar që në të ardhmen të dhënat për regjistrimet e pronës dhe njësive kadastrale të jenë të sakta, të besueshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, AKK do të sigurohet që rekomandimet e adresuara të zbatohen sistematikisht nga ana e zyrtarëve komunal.

13.2. | Monitorimi i Kompanive të licencuara gjeodete dhe Gjeodetëve të licencuar

Monitorimi i gjeodetëve dhe kompanive gjeodezike është duke u kryer krahas monitorimit të ZKK-ve, me ç'rast gjatë kontrollit të lëndëve po merren parasysh të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet.

Numri dhe llojet e lëndëve të kontrolluara për çdo komunë është paraqitur në tabelën si më poshtë:

Statistikat nga lëndët e kontrolluara				
Komuna	nr. Lëndëve juridike faza I	nr. Lëndëve uridike faza II	nr. Lëndëve teknike faza I	nr. Lëndëve teknike faza II
Prishtinë	10	8	10	12
Mitrovicë	10	10	10	11
Skënderaj	05	05	8	8
Obiliq	05	05	6	4
Novoberde	05	05	9	5
Prizren	10	10	10	8
Suharekë	05	07	10	9
Dragash	04	04	9	8
Shtërpcë	05	04	2	2
Shtime	05	05	9	5
Mamushë	07	08	4	1
Fushë Kosovë	10	05	10	10
Glllogoc	10	05	5	10
Podujevë	10	05	10	10
Gjilan	10	10	10	11
Kamenicë	05	05	7	7
Viti	05	05	10	10
Klllokot	05	05	2	2
Partesh	05	05	3	-
Ranillug	05	05	4	4
Rahovec	05	05	10	9

[1] Të gjitha raportet e monitorimeve të bëra deri më tani janë të hapura për publikun në ueb faqen e AKK-së: <http://www.kca-ks.org/raports>.

Vushtrri	05	05	10	10
Pejë	10	10	10	10
Istog	10	10	5	4
Klinë	05	05	10	8
Gjakovë	10	10	10	10
Junik	05	05	6	6
Malishevë	05	05	10	10
Deçan	08	10	10	9
Ferizaj	15	10	10	8
Graçanicë	07	10	8	8
Kaçanik	05	05	10	9
Han i Elezit	05	05	8	4
Lipjan	06	05	5	10
TOTALI	232	206	270	242

Gjatë këtij monitorimi në të njëjtën fazë janë monitoruar edhe gjeodetët/kompanitë gjeodezike të licencuara përmes kontrollimit të lëndëve të dorëzuara në ZKK.

Nga faza e 9 dhe e 10 e monitorimit të ZKK-ve dhe gjeodetëve/kompanive gjeodezike të licencuara, të gjeturat ishin si më poshtë:

Për pjesën juridike:


1. Skanimi i lëndëve nuk është i kualitetit të duhur, pasi që dokumentet nuk mund të lexohen, mungojnë dokumente të skenuara në bazë të cilave është vendosur në lëndë
2. Lëndët janë regjistruar me vonesë në SIKTK nga data e aplikimit
3. Nuk është respektuar afati i aprovimit të lëndës
4. Mungon dëshmia e pagesës për regjistrim
5. Afati për pezullimin e lëndës nuk është percaktuar dhe arsyetimi nuk është bërë mbi bazën e dokumenteve të paraqitura;

Për pjesën teknike:

1. Skanimi i lëndëve nuk është i kualitetit të duhur, pasi që dokumentet nuk mund të lexohen
2. Lëndët janë regjistruar me vonesë në SIKTK nga data e aplikimit, vonesat janë edhe mbi një muaj në regjistrim
3. Edhe pas ndryshimit të afatit për regjistrim të ndryshimeve për njësi kadastrale në 15 ditë në 3 ditë sa ka qenë, ende ka vonesa në regjistrim
4. Pezullimet kryesisht janë të pa plotësuar për çështjen për plotësim, por vetëm shablloni nga sistemi
5. Lëndët punohen me legjislacion dhe kornizë të vjetër
6. Nga gjeodetët dhe palët kërkohen dokumente për të cilat AKK I ka liruar (certifikata e pronës, kopja e planit, licenca dhe letërnjoftimi I gjeodetit)
7. Produktet e lëshuara nga ZKK janë të pa nënshkuara dhe pa vulosura
8. Ne Hartë Kadastrale nuk përditësohen të gjitha atributet e paraqitura nga gjeodeti (kuotat dhe kodet)
9. Koordinatat e matura dyfish në të shumtën e rasteve janë me ndryshime 0
10. Korrigjimi i sipërfaqes nuk është kryer
11. Faturat për shërbimet e gjeodetit nuk janë sipas Udhëzimit në fuqi
12. Pagesat e produkteve të lëshuara nga ZKK-të bëhet në ditën e dorëzimit të lëndës për regjistrim
13. Aplikohet pagesa për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta edhe pse me Udhëzim Administrativ janë të liruara

Kurse për çdo komunë veç e veç komentet janë të ndryshme dhe të njëjtat u janë përcjellë ZKK-ve.

PËRMBLEDHJE
E SHËRBIMEVE
DHE STATISTIKAVE
PËR TË DHËNAT
E OFRUARA NGA AKK



14


14.1. | Shpronësimi

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka ofruar përkrahje për institucione të ndryshme në hartimin e elaboreteve të shpronësimit dhe zgjidhjen e problemeve të paraqitura në disa projekte të rëndësishme. Agjencia Kadastrale e Kosovës ka përgatitur një sërë elaboretash të shpronësimit për projekte të interesit publik në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktues, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A., etj.

Disa nga elaboretet e shpronësimit të trajtuara nga AKK-ja gjatë vitit 2024 janë:

1. Përgatitja e elaboretit të shpronësimit ZK Ferizaj për Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sportit
2. Përgatitjen e elaboretit të shpronësimit për ndërtimin e objektit - Qendrën për fëmijët me Autizëm në Komune e Graçanicë për MMPHI,
3. Përgatitja e elaboretit të shpronësimit ZK Lutogllavë Komuna e Pejës për Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.
4. Përgatitja e elaboretit të shpronësimit për Qendrën Kombëtarë të Xhudos për Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sportit
5. Përgatitja e elaboretit të shpronësimit për terminale Doganore Dheu i bardhë, Merdare dhe Hani i Elezit Ministria e Financave

Gjatë vitit 2024 janë aprovuar 193 lëndë **Bartja e pronësisë/posedimit — Shpronësim**



14.2. | Statistika nga SIKTK

Në vitin 2024 nga SIKTK për gjithë territorin e Republikës së Kosovës janë lëshuar gjithsej 137,589 Certifikata , ku prinë Prishtina me 15,386 Certifikata të lëshuara, ndërsa e fundit është Zubin Potoku me 197 Certifikata të lëshuara.

Në nivelin e Kosovës, në sistemin e SIKTK janë aprovuar gjithsej 96,605 lëndë, nga të cilat:

- 23,714 lëndë për shitblerje, ku numri më i madh i tyre është regjistruar në Prishtinë me 4,266 lëndë;
- 6,920 lëndë të trashëgimisë, me numrin më të madh të tyre në Prizren, që arrin në 717 lëndë;
- 12,963 lëndë për ndarje parcele;
- 4,132 lëndë për bashkim parcelash, etj.

Numri i njësive kadastrale në SIKTK deri më 31.12.2024 është si vijon:



2,260,592
Parcela




34,556
Ndërtesa




150,754
Pjesë të
Ndërtesave


Në përmblendje, numri total i pronarëve është 628,764, dhe shpërndahet si më poshtë:



489,176
Meshkuj



127,195
Femra



12,393
Persona
Juridik

Në vitin 2024, në nivel vendi, kemi ofruar mbi 550,000 shërbime kadastrale. Çka është e rëndësishme të theksohet, është se përmes Platformës eKosova, qytetarëve dhe bizneseve u është mundësuar që të pajisen me certifikata të pronës shpejt, lehtë dhe pa asnjë kosto. Ky shërbim ka filluar të rritet ndjeshëm, duke reflektuar një trend të vazhdueshëm të rritjes së certifikatave të shkarkuara përmes eKosovës, një hap i rëndësishëm drejt digjitalizimit dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset në Republikën e Kosovës.

Mbi 550,000 Shërbime Kadastrale

1 Numri i kërkesave për certifikata të pronësisë:

61,850

Certifikata janë lëshuar përmes eKosova



337,002

Certifikata janë lëshuar përmes SIKTK

2 Numri i kërkesave për kopje të planit:

5,507

Kopje plani dhe koordinata janë lëshuar përmes eKosova



105,373

Kopje plani dhe koordinata janë lëshuar përmes SIKTK

3 Numri i kërkesave për lëndë të hipotekave:

4,226
Hipoteka të regjistruara



151
Hipoteka të modifikuara

3,168
Hipoteka të fshira

7,545 Totali i lëndëve të aprovuara për hipoteka

4 Numri i kërkesave për lëndë të bartjeve:

37,901



Lëndë bartje, blerje dhe dhurime të aprovuara

14.3. | Statistika për numrin e kërkesave nga institucionet

Subjekti Juridik	Numri kërkesave
USAID	6
Policia Kosoves	1
Ministria Financave	4
Ministria e Ekonomisë	1
Ministria e Punëve të Brendshme	1
Drejtorati Kadastrit pran AKK-se	
Agjencia per barazi gjinore	2
Televizioni T7, RTK, Telegrafi, Klan Kosova, Gazeta Express,KTV, Radio Evropa e Lirë	7
Komuna Prizrenit	1
Komuna Drenasit	7
Komuna Dragashit	3
Komuna Podujeves	1
Komuna Kamenices	1
Komuna e Mitrovicës	2
Komuna Junik	1
Komuna Gjilanit	4
Komuna Prishtines	2
Komuna Pejës	1
KFOR	4
Agjencia e Statistikave të Kosovës	1
Agjencia Kosovare e Privatizimit	2
Trepça	2
Njesia Per Transformime Digjital pran Zyres Kryeministrit	1
Zyra e Kryeministrit	1
Ndërmarrja Hidro- Ekonomike "Ibër Lepenc"	1
Poste telekomi I Kosoves-PTK	1
Universiteti i Prishtinës	1
Instituti për Planifikim Hapësinor i Kosovës në kuadër të MMPHI-së	2
Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës	1

14.4. | Statistika nga shkëmbimi i të dhënave me institucionet e jashtme

Shkëmbimi i të dhënave kadastrale me institucione tjera i pason realizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit që nënshkruhen në mes të AKK-ës edhe institucionit që ka shprehur interesim për konsumim të dhënave. Institucionet të cilat janë duke konsumuar shërbimet kadastrale janë: Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Oda Përmbauesve Privat, Departamenti i Tatimit në Pronë, Bankat, Institucionet Microfinanciare, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Oda e Noterëve të Kosovës, Këshilli Prokurorial, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, Gjeodetët Privat të Licencuar, Agjencia Pyjore e Kosovës dhe Policia e Kosovës.

Shërbimi i adresave është i vendosur në eKosova dhe mund të konsumohet nga kushdo që ka interes. Po ashtu Administrata Tatimore e Kosovës është duke e përdorur shërbimin e adresës për ti vendosur tatim paguesve adresën zyrtare. Këtë vit pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit Agjencia Pyjore e Kosovës ka filluar të konsumoj shërbimet kadastrale.

Departamenti i Tatimit në Pronë, Bankat dhe Institucionet Microfinanciare, Administrata Tatimore e Kosovës konsumojnë shërbimet tona përmes ueb shërbimeve, ndërsa institucionet tjera konsumojnë shërbimin përmes aplikacionit të cilin e ka zhvilluar AKK për institucionet që nuk mund të komunikojnë me ne përmes ueb shërbimeve.

Përmes aplikacionit(GUI forme) tonë marrin shërbime rreth 348 shfrytëzues nga të gjitha institucionet e lartcekura.

Për të gjitha institucionet që janë duke konsumuar shërbimet kadastrale krijohen raporte mujore dhe përcjellën përmes zyrës së marketingut faturat për pagesë tek institucionet gjegjëse. Gjatë vitit përkrahje në shfrytëzimin e shërbimeve kadastrale tekstuale ju është dhënë përdoruesve që kyçen direkt në sistemin tonë dhe atyre që provojnë të konsumojnë shërbimet kadastrale përmes eKosovës.

Po ashtu edhe gjatë këtij viti Departamenti i Tatimit në Pronë me datën 30 Nëntor përmes ueb shërbimit të AKK-së ka konsumuar të gjitha të dhënat kadastrale me qëllim të faturimit të qytetarëve për tatimin në pronë.

AKK për nevoja të veta konsumon ueb shërbime nga këto institucione: ARBK, ARC, bankat, institucionet mikrofinanciare, ATK dhe OJQ. Disa nga këto shërbime konsumohen përmes platformës së interoperabilitetit. Konsumimi i këtyre ueb shërbimeve ka ngritur në masë të madhe cilësinë e të dhënave kadastrale.

Statistikat në vendosjen e shënimit nga noteri dhe përmbauesi për periudhën Janar -Dhjetor 2024 janë :

- Njësia me shënim Transaksion janë 86870
- Njësia me shënim për Hipotekë janë 5490
- Njësia me shënim përmbarimi janë 74

Statistikat për periudhën Janar-Dhjetor 2024 për konsumin e shërbimeve nga platforma Online(GUI forme) janë si në vijim:


- Administrata Tatimore e Kosovës në sistemin online ka krijuar 74 lëndë
- Përmbauesit në sistemin online kanë krijuar 211 lëndë
- Noterët në sistemin online kanë krijuar 4020 lëndë
- AKP në sistemin online ka krijuar 1562 lëndë
- Gjeodetët Privat në sistemin online kanë krijuar 8839 lëndë
- Policia e Kosovës në sistemin online kanë krijuar 24 lëndë
- Departamenti i Tatimit në Pronë në sistemin online ka krijuar 231 lëndë

Statistikat për periudhën Janar-Dhjetor 2024 përmes sistemit online për regjistrimin, modifikimin, fshirjen e hipotekave si dhe barrës tatimore janë si në vijim:

- Kërkesa të ardhura janë 7734
- Lëndë 'Regjistrim i hipotekës' janë 4220 lëndë të aprovuara
- Lëndë 'Modifikim i hipotekës' janë 203 lëndë të aprovuara
- Lëndë 'Fshirje e hipotekës' janë 3311 lëndë të aprovuara
- Lëndë 'Regjistrim i barrës tatimore' janë 405 lëndë të aprovuara
- Lëndë 'Fshirje e barrës tatimore' janë 191 lëndë të aprovuara

Në proces është realizimi i lidhjes së sistemeve në mes të AKK-se , Ministrisë së Drejtësisë dhe Odës së Noterëve ku kjo lidhje do të kalojë përmes platformës së interoperabilitetit. Këtë lidhje sistemesh e mbështet një memorandum bashkëpunimi i cili është nënshkruar nga Ministrat e linjës.

MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN DHE GJITHËPËRFSHIRJE



15

15.1. | Intervistat e realizuara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024, Agjencia Kadastrale e Kosovës realizoi një seri intervistash për të pasqyruar arritjet, sfidat dhe objektivat e saj. Qëllimi kryesor i këtyre intervistave ishte të ofronte një pasqyrë të hollësishme mbi zhvillimet më të fundit në menaxhimin e pasurive të paluajtshme, përmirësimin e shërbimeve të ofruara e digjitalizimin, si dhe të diskutonte për sfidat dhe planet për të ardhmen.

Këto intervista ishin të dizajnuara për të krijuar një platformë të hapur dhe transparente, ku palët e interesuara mund të kuptonin më mirë veprimtarinë e agjencisë dhe të merrnin informacione të sakta për zhvillimet e fundit. Gjithashtu, përmes këtyre intervistave kemi siguruar një raportim të vazhdueshëm në forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet dhe qytetarët. Viti 2024 filloi me intervistën e realizuar nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, në Tv Dukagjini, ku ai dha një pasqyrë të detajuar mbi arritjet e AKK-së gjatë vitit 2023 dhe prezantoi projektet dhe planet për vitin 2024. Kjo intervistë shërbeu si një mundësi e rëndësishme për të ndarë progresin e arritur dhe për të theksuar prioritetet e vitit 2024.



Viti 2024 u përmbyll me një tjetër intervistë të rëndësishme, këtë herë në formën e Podcast-it të parë të organizuar nga Agjencia, ku z. Avni Ahmeti theksoi sukseset e jashtëzakonshme të vitit 2024 dhe vizionin për të ardhmen. Ky vit shënoi avancime të konsiderueshme, duke hedhur themele të forta për zhvillimin e mëtejshëm të Agjencisë. Intervista e pasur dhe e informuar ofroi një pasqyrë të qartë të rezultateve, sfidave dhe planeve për vitin 2025.




15.2. | Ueb faqja zyrtare e AKK-së

Viti 2024 ka shënuar një rritje të jashtëzakonshme në aktivitetin dhe performancën e ueb faqes së Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), duke ofruar një mundësi të fuqishme për palët e interesuara të aksesojnë informacione dhe shërbime të ndryshme. Ueb faqja është një platformë kyçe për qasje në aplikacionet e ndryshme të AKK-së, si: **KCLIS tekstual, KCLIS grafik, Geoportal, Sistemi Informativ i Regjistrimit të Adresave (ARIS)**, statistikat ditore dhe modulet që do të zhvillohen në të ardhmen.

Gjatë vitit 2024, ueb faqja ka ofruar një pasqyrë më të pasur dhe më të detajuar të aktiviteteve të AKK-së, me **101 lajme** të publikuara, **19 shpallje**, **11 udhëzime administrative** dhe udhëzuesin për matje, krijim, ndryshim dhe regjistrim të njësive kadastrale — parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës. Po ashtu, janë realizuar konfigurime të reja në sistemin e menaxhimit të përmbajtjes (CMS), duke mundësuar një përvojë më të lehtë dhe më efikase për përdoruesit.


Një aspekt i veçantë i vitit 2024 ka qenë rritja e jashtëzakonshme të vizitave, me **154,905 shikime** dhe **29,000 përdorues të rinj**, një ndryshim drastik krahasuar me vitin 2023, ku u regjistruan **21,000 vizita**. Ky përmirësim i dukshëm i angazhimit dhe interaktivitetit të përdoruesve tregon një rritje të besueshmërisë dhe interesit të vazhdueshëm për shërbimet dhe informacionet që ofron Agjencia Kadastrale e Kosovës.



15.3. | Profili zyrtarë i AKK-së në Facebook

Marrë parasysh se mediat sociale kanë marrë një rol të jashtëzakonshëm në informimin e shpejtë dhe gjithëpërfshirës të qytetarëve, Agjencia Kadastrale e Kosovës si kanal kyç për komunikim dhe shpërndarje të informacionit e ka profilin e saj zyrtar në Facebook, si një nga platformat më të rëndësishme, që karakterizohet me lajme më të shpejta, më të sakta e kredibile lidhur me aktivitetet dhe zhvillimet në fushën e kadastrës. **Në vitin 2024, ky profil ka pësuar një rritje të dukshme**, duke pasqyruar angazhimin dhe transparencën e AKK-së në lidhje me punën dhe shërbimet që ofron.

Facebook-u i AKK-së në vitin 2024 ka arritur një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2023. Sot, profili numëron **6,502 ndjekës**, një rritje e dukshme nga **6,000 ndjekës** që kishte në vitin 2023. Pjesëmarrja dhe angazhimi i përdoruesve është rritur gjithashtu, duke regjistruar **212,200 shikime** dhe **56,000 vizitorë** gjatë vitit 2024.



Në vitin 2024 janë realizuar **146 lajme**, **10 postime live**, dhe janë bërë **8,512 like** dhe **244 share**. Këto shifra përfaqësojnë një rritje krahasuar me vitin 2023, kur u regjistruan **85 lajme**, **5,540 like**, dhe **211 share**. Ky progres tregon edhe punën e palodhshme e dinamike që po bëhet në AKK, por edhe angazhimin e rritur të qytetarëve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Agjencia Kadastrale e Kosovës falënderon secilin nga ndjekësit për mbështetjen dhe besimin që kanë në institucionin tonë dhe është e angazhuar të vazhdojë me punë dhe transparencë të lartë edhe në të ardhmen.


15.4. | Gjeoportali Shtetëror

Gjatë vitit 2024 është ruajtur ritmi i qëndrueshëm dhe efektiv i mirëmbajtjes së Gjeoportali-it, njësoj si në vitet e kaluara. Mund të konstatojmë se gjatë këtij viti Gjeoportali ka qenë i qasshëm dhe funksional për 99.8% të kohës, duke mos pasur asnjë problem të madh që do të pengonte funksionimin e tij normal.

Edhe gjatë këtij viti, fokusi kryesor ka qenë përditësimi i të dhënave ekzistuese që janë tashmë të publikuara në Gjeoportali. Në të njëjtën kohë, është vazhduar me publikimin e të dhënave të reja nga institucione të ndryshme ku gjatë këtij viti janë publikuar 22 shtresa të reja në Gjeoportali, duke pasuruar më tej përmbajtjen dhe funksionalitetin e tij.

Gjithashtu, viteve të fundit është vërejtur një rritje e dukshme në përdorimin e Gjeoportalit, si nga qytetarët ashtu edhe nga bizneset, duke e bërë atë një mjet gjithnjë e më të rëndësishëm në shërbim të qytetarëve, institucioneve dhe sektorit privat.

Më poshtë është treguar numri i përdoruesve dhe i klikimeve për 3 vitet e fundit.



15.5. | Barazia gjinore

Me vendim të Qeverisë Nr. 07/138 i datës 12.04.2023 është vazhduar afati i Udhëzimit Administrativ (QRK)Nr.03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të Dy Bashkëshortëve.


Statistikat për regjistrimin e bashkëshortëve si bashkëpronar nëpër vite nga hyrja e Udhëzimit Administrativ e deri me tani është:

VITI	Nr. Femrave me të drejtën Pronësi Posedim i Përbashkët
2021	3042
2022	4230
2023	5104
2024	6689

15.6. | Qasja në dokumente publike

Agjencia Kadastrale e Kosovës është ndër institucionet më transparente në vend. Ajo ka të vendosur kontaktin e personit që jep përgjigje në uebfaqen e Agjencisë. Këtë vit nga dhjetëra kërkesa për qasje në dokumente, që kryesisht vijnë nga mediat, OJQ-të dhe qytetarët, asnjë nuk është refuzuar.

KALENDARI
E NGJARJE
TË NDRYSHME



16 | KALENDARI ME NGJARJE TË NDRYSHME

20 Shkurt 2024 Agjencia Kadastrale e Kosovës mori pjesë në takim online të organizuar nga Kombet e Bashkuara për Menaxhimin Global të Informacioneve Gjeohapsinore (UN-GGIM) për Evropë, si dhe nga Qendra Globale Gjeodezike e Ekselencës (UN-GGCE)

Roli i UN-GGCE është angazhimi i përbashkët me shtetet anëtare dhe organizatat gjeodezike për të forcuar ndikimin në fushat e mëposhtme:

- Rritja e investimeve në zinxhirin global të punëve gjeodezike;
- Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare dhe organizatave të ndryshme gjeodezike;
- Shpërndarja e të dhënave gjeodezike, përmirësimi i standardeve dhe kontribuimi në densifikimin e rrjetit gjeodezik global dhe rajonal, mbi baza vullnetarizmi;
- Ofrimi i asistencës teknike, veçanërisht për zhvillimin e kapaciteteve në gjeodezi për vendet në zhvillim;
- Ngritja e vetëdijes për përfitimet nga gjeodezia, që ato të jenë më të dukshme dhe të kuptueshme për shoqërinë.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi i mbështetjes politike për gjeodezinë, e cila mundëson përshpejtimin e arritjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjen e përfitimeve në fushat sociale, mjedisore dhe ekonomike.



21 Shkurt 2024 Takimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës me Drejtorin Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës

Në vazhdim të aktiviteteve për forcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Avni Ahmeti, priti në një takim Drejtorin Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj.

Në këtë takim, u diskutua rreth zhvillimeve të fundit të të dyja institucioneve në kuadër të procesit të digjitalizimit të regjistrimit të barrës tatimore në Sistemin Informativ të Kadastrës dhe të Tokës (SIKTK). U shqyrtuan avancimet që janë bërë deri tani, sfidat me të cilat përballen AKK-ja dhe ATK-ja gjatë këtij procesi dhe hapat që do të ndërmerren në ditët në vijim për përmbushjen e këtij qëllimi.

Gjatë diskutimeve, AKK-ja u angazhua të ofrojë mbështetje maksimale për përmbushjen e kërkesave të ATK-së, ndërsa ATK-ja u angazhua të përmbushë obligimet e saj në përputhje me kërkesat dhe nevojat e AKK-së.

Në fund të takimit, të dyja institucionet ranë dakord për të vazhduar bashkëpunimin dhe koordinimin e ngushtë për të arritur me sukses qëllimet e përbashkëta, duke përmirësuar dhe digjitalizuar procedurat administrative për lehtësimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.



28 Shkurt 2024 Agjencia Kadastrale e Kosovës Takon Zyrtarët e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas për Qasjen në Të Dhëna Kadastrale

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Avni Ahmeti, me bashkëpunëtorë, ka pritur në një takim zyrtarë të Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas, përfshirë znj. Flutura Berbat Zena, Zv. Drejtore Ekzekutive, si dhe ekipin e saj. Pjesëmarrës në takim ishin gjithashtu përfaqësues nga Programi i USAID-it për drejtësi dhe përfaqësues nga Kompania Komtel.

Qëllimi kryesor i takimit ishte diskutimi mbi mundësinë e ofrimit të qasjes në të dhënat kadastrale për Agjencinë për Ndhimë Juridike Falas, e cila do të mundësojë verifikimin e informacionit për personat që kërkojnë ndihmë juridike falas në këtë agjenci.

Në parim, palët ranë dakord për mundësinë e ofrimit të qasjes në bazë të një marrëveshjeje dhe kriterëve të dakordësuar, të cilat do të pasoheshin nga takime teknike të mëtejshme, si dhe trajnim për përdoruesit që do të përfitojnë nga kjo qasje.

Ky aktivitet është pjesë e reformave të vazhdueshme të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, që ka për qëllim zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve për qytetarët, përmes digjitalizimit të shërbimeve dhe thjeshtësimit të procedurave administrative.



29 Shkurt 2024 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës Takon Zyrtarët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës për Çështje Bashkëpunimi dhe Zhvillimesh të Reja

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Albert Zogaj, ka pritur në një takim Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Avni Ahmeti, dhe Zv. Drejtorin e Drejtoratit Ligjor në AKK, Bashkim Shaqiri.

Gjatë këtij takimi, u diskutua për zhvillimet e fundit në lidhje me ofrimin e të dhënave përmes shërbimeve ueb për institucionet, si dhe implementimin e obligimeve të parashikuara në Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet KGJK-së dhe AKK-së. Po ashtu, u trajtuan çështje të tjera të rëndësishme në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në këtë kuadër, u diskutua gjithashtu për projektet që janë duke u implementuar nga AKK, të cilat synojnë rritjen e sigurisë, ndërlidhjen e databazës së agjencisë me institucionet publike dhe zgjerimin e fondit të shërbimeve.

Kryesuesi Zogaj dhe Drejtori Ekzekutiv Ahmeti shprehën përkushtimin e KGJK-së dhe AKK-së për angazhim të plotë në përmbushjen e obligimeve që dalin nga memorandumi i bashkëpunimit.



3 Mars 2024 Agjencia Kadastrale e Kosovës Diskuton Mundësinë e Bashkëpunimit me “Apple” për Paraqitjen e Adresave në “Apple Maps”

Në kuadër të angazhimeve të vazhdueshme të Agjencisë Kadastrale të Kosovës për promovimin dhe përdorimin e adresave zyrtare dhe unike të Republikës së Kosovës, u mbajt një takim virtual me përfaqësuesit e kompanisë “Apple”, përkatësisht “Apple Maps”.

Në këtë takim, tema kryesore e diskutimit ishte mundësia e bashkëpunimit ndërmjet AKK-së dhe kompanisë “Apple” për paraqitjen e të dhënave zyrtare të adresave të Kosovës në platformën “Apple Maps”. Specialisti i GIS-it, Amir Sogojeva, informoi përfaqësuesin e “Apple” lidhur me aktivitetet e AKK-së në fushën e Sistemit të Adresave dhe më pas u diskutua për çështjen kryesore të paraqitjes së Republikës së Kosovës në platformën “Apple Maps”, në mënyrë që të mund të kërkohen të dhëna si një shtet me kufij të njohur.

Si përfundim i takimit, u dakordua që të vazhdohet komunikimi ndërmjet palëve derisa të zgjidhet çështja e paraqitjes së vijës kufitare të Kosovës në këtë platformë.

Agjencia Kadastrale e Kosovës mbetet e angazhuar në promovimin e produkteve të Kosovës dhe në rritjen e subjektivitetit të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare, përmes produkteve të sajës, siç janë edhe adresat zyrtare.



7 Mars 2024 Drejtori i AKK-së, Avni Ahmeti, Viziton Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz në Nderim të 26-Vjetorit të Epopesë së UÇK-së

Në përkujtim të 26-vjetorit të “Epopesë së UÇK-së”, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Avni Ahmeti, bashkë me një pjesë të stafit të Agjencisë, vizituan Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz. Ky aktivitet ka pasur për qëllim nderimin e trashëgimisë dhe sakrificës së luftëtarëve të UÇK-së, duke theksuar rëndësinë e kujtesës historike.



29 Mars 2024 AKK Takon Përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe USAID

Në një takim të përbashkët, përfaqësues nga Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) dhe Aktiviteti për Qeverisje Pronësore i USAID-it u pritën nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Avni Ahmeti.

Gjatë takimit, z. Ahmeti informoi të pranishmit për projektet dhe aktivitetet e fundit të AKK-së, përfshirë ato të Projektit REGIP të Bankës Botërore, duke theksuar rëndësinë e koordinimit të mirë dhe përfshirjes së politikave të barazisë gjinore.

Përfaqësuesja nga Agjencia për Barazi Gjinore e informoi të pranishmit mbi aktivitetet e këtij institucioni dhe falënderoi AKK-në për bashkëpunimin e vazhdueshëm në ngritjen e vetëdijes qytetare dhe mbështetje për masat afirmative në regjistrimin e të drejtave pronësore në emër të grave.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e USAID-it shprehën angazhimin për të mbështetur AKK-në në këtë fushë, duke përmendur gjetjet e raportit nga monitorimi i komunave partnere në kuadër të Aktivitetit për Qeverisje Pronësore



29 Mars 2024 AKK Dorëzon Raportin me Zgjidhjen Teknike për Regjistrimin e Pronave të Universitetit të Prishtinës

Agjencia Kadastrale e Kosovës, si pjesë e Komisionit të formuar nga Universiteti i Prishtinës, ka përfunduar analizën e të dhënave grafike dhe tekstuale për pronat në pronësi të Universitetit të Prishtinës. Pas marrjes së kërkesës, ekspertët e AKK-së kanë analizuar historinë e ndryshimeve në njësitë kadastrale ku janë vendosur fakultetet e UP-së dhe më pas kanë prezantuar rezultatet para përfaqësuesve të Universitetit të Prishtinës.

Nga kjo punë voluminoze, është përgatitur një raport me gjetjet dhe rekomandimet për hapat që duhet të ndjekë UP-ja në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës për regjistrimin e pronave.


Përfaqësuesit e Universitetit të Prishtinës e vlerësuan lart kontributin e AKK-së, duke theksuar se ky proces do të lehtësojë procedurat për investime dhe ndërtimin e objekteve të reja për nevojat e UP-së, duke pasur parasysh se regjistrimi ishte vonuar për vite të tëra.



3 Prill 2024 AKK Takon Përfaqësuesit e MCA Kosova për Identifikimin e Lokacioneve për Sistemet e Baterive të Energjisë

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, ka pritur në takim përfaqësues të MCA Kosova (Programi i MCC-së). Gjatë takimit, përfaqësuesit e MCA Kosova informuan se njëra nga komponentët e programit është ndërtimi i Sistemeve të Baterive për ruajtjen e energjisë, dhe kërkuan ndihmën e AKK-së për identifikimin e lokacioneve ku do të ndërtohen ato.

Duke theksuar rëndësinë strategjike të projektit, z. Ahmeti siguroi se stafi i AKK-së do të ofrojë mbështetje të plotë për realizimin e kërkesave në afatin më të shkurtër të mundshëm.



5 Prill 2024 **AKK Takon Agjencinë e Regjistrimit Civil për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Projekte të Kadastrit dhe Regjistrimit të Të Dhënave**

Agjencia Kadastrale e Kosovës realizoi takim me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC) për të diskutuar intensifikimin e bashkëpunimit në prag të nisjes së projekteve të AKK-së për ndërlikim dhe qytetarëve me adresat, rindërtimin e kadastrit dhe korrektimin e të dhënave të personave.

Në këtë fazë, AKK-ja kërkoi nga ARC-ja sigurimin e informacionit mbi statusin jetësor të pronarëve të regjistruar në Regjistrin e të Drejtave të Pronësore, për të verifikuar numrin e trashëgimive dhe për të mbledhur informacionet e nevojshme për realizimin e projekteve.

Për realizimin efikas të projekteve, u theksua rëndësia e ofrimit të qasjes në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe ndërlikimja në kohë reale e sistemeve për të përshpejtuar proceset dhe minimizuar gabimet. Agjencia e Regjistrimit Civil premtoi bashkëpunim të plotë me AKK-në për të ofruar të dhëna sa më të plota dhe të sakta për qytetarët.



16 Prill 2024 **"Drejtori Ekzekutiv i AKK-së Takoi Kryeshefin Ekzekutiv të KEK-ut për Çështje Pronësore dhe Digjitalizimin e Shërbimeve"**

Në kuadër të angazhimeve për intensifikimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera, me qëllim digjitalizimin e shërbimeve dhe thjeshtësimin e procedurave administrative, Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, Avni Ahmeti, priti në takim Ud. Kryeshefin Ekzekutiv të KEK-ut, Bekir Gërguri.

Temë kryesore e takimit ishte ofrimi i bashkëpunimit nga ana e AKK-së në lidhje me çështjet pronësore në realizimin e projekteve të KEK-ut. Po ashtu, u diskutua për unifikimin e emërtimeve të KEK-ut, një praktikë e realizuar nga AKK-ja për shumë institucione të tjera gjatë disa viteve, me qëllim të ngritjes së cilësisë së të dhënave. Gjithashtu, u bisedua për ofrimin e qasjes në SIKTK për gjeodetët e KEK-ut.



18 Prill 2024 **"Drejtori Ekzekutiv i AKK-së Takoi Ipeshkvin e Kosovës për Unifikimin e Emërtimeve dhe Bashkëpunimin në Projekte Kapitale"**

Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, Avni Ahmeti, priti në takim Imzot Dodë Gjergjin, Ipeshkvin e Kosovës. Temë e takimit ishte mundësia e unifikimit të emërtimeve të Kishës Katolike, një praktikë e realizuar nga AKK-ja për shumë institucione të tjera, me qëllim të ngritjes së cilësisë së të dhënave. Po ashtu, AKK-ja do të angazhohej maksimalisht për një bashkëpunim të frytshëm me akterët e këtij institucioni fetar, me qëllim të krijimit të lehtësirave procedurale për realizimin e projekteve kapitale të planifikuara.



11 Qershor "Takim me UNDP për Përmirësimin e Qeverisjes së të Dhënave në AKK".

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës u mbajt një takim mes përfaqësuesve të UNDP-së, Z. Alper Gucumengil — specialist i të dhënave, dhe Z. Fatmir Belallari — bashkëpunëtor për TIK dhe udhëheqës i ekipit për të dhëna, si dhe përfaqësuesve të AKK-së nga Departamenti i IT, ligjor dhe kadastrit.

Në këtë takim u diskutua për qeverisjen e të dhënave të AKK-së dhe mundësitë e shkëmbimit të të dhënave me institucione të tjera publike dhe private. Stafi i AKK-së prezantoi të dhënat që posedon dhe mënyrën e menaxhimit të tyre, duke shqyrtuar mundësitë dhe sfidat që hasen gjatë shkëmbimit të këtyre të dhënave. Po ashtu, u diskutuan rekomandimet e stafit të AKK-së për ndihmën e Kornizës Kosovare për Qeverisjen e të Dhënave, e cila është iniciuar nga Njësia e Transformimit Digjital të Kosovës dhe do të ndihmojë UNDP-në për të finalizuar këtë kornizë.



1 Gusht 2024 Priti përfaqësues nga Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore”

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, me bashkëpunëtorë, priti në takim znj. Rrezarta Loxha-Vitaku, Zv. Drejtoreshë në Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, dhe z. Milot Berisha, Ud. Drejtor në Institutin Arkeologjik të Kosovës. Temë kryesore e diskutimit ishte kërkesa për intensifikimin e bashkëpunimit mes institucioneve, me qëllim krijimin e mekanizmave për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore.

Z. Berisha theksoi se misioni i Institutit Arkeologjik të Kosovës është përcaktimi dhe identifikimi i potencialit arkeologjik dhe paraqitja e tij në dokumentet zyrtare, dhe se bashkëpunimi me

Agjencinë Kadastrale të Kosovës do të ishte një hap i rëndësishëm për realizimin e objektivave të përbashkëta. Në anën tjetër, Drejtori Ahmeti premtoi bashkëpunim në ofrimin e qasjes në Regjistrin e të Drejtave Pronësore pas nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit, i cili pritej të realizohej shumë shpejt. Po ashtu, AKK kërkoi ofrimin e të dhënave për këto objekte, duke përfshirë koordinatat dhe përshkrimet historike, që do të mundësojnë vendosjen e tyre në Gjeoportalin shtetëror dhe promovimin e turizmit.



2 Gusht "AKK Takon AKKVP-në për Forcimin e Bashkëpunimit Ndërinstitucional”

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Z. Avni Ahmeti, priti Drejtoreshën Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Znj. Afërdita Beka-Arifaj, me bashkëpunëtorë.

Qëllimi i takimit ishte informimi i ndërsjellët për punët dhe aktivitetet e përbashkëta të AKK-së dhe AKKVP-së, shqyrtimi i mundësive për bashkëpunim ndërinstitucional, si dhe diskutimi i sfidave me të cilat po ballafaqohen të dyja institucionet.

Udhëheqësit e të dyja institucioneve u angazhuan për vazhdimin e bashkëpunimit dhe koordinimit në fushat e interesit të përbashkët.



7 Gusht 2024 "AKK Diskuton me Odën e Ndërmjetësuesve për Shërbime të Reja Digjitale dhe Bashkëpunim të Mëtishëm"

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, priti Kryetaren e Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës, Ganimete Xhelili, për të diskutuar zhvillimet e fundit në AKK dhe mundësitë për ofrimin e shërbimeve të reja digjitale për ndërmjetësues. U diskutua mundësia e regjistrimit të shënimeve në Regjistrin e të Drejtave Pronësore, e cila do të mundësohet për ndërmjetësues, ashtu siç është mundësuar për noterë dhe përmbarues.

AKK-ja do të përgatiste mundësitë teknike për këtë qasje dhe do t'i prezantonte në një takim të përbashkët me të gjithë ndërmjetësuesit, duke marrë sugjerimet e tyre për përshtatjen e sistemit. Po ashtu, u diskutuan edhe sfidat me të cilat përballen ndërmjetësuesit, si dhe angazhimet dhe aktivitetet aktuale të të dyja institucioneve.

Kryetarja falënderoi AKK-në për mundësitë e ofruara dhe bashkëpunimin e deritanishëm, duke premtuar vazhdimin e praktikave të mira bashkëpunuese në të ardhmen.



8 Gusht 2024 "AKK Diskutoi me Postën e Kosovës për Unifikimin e të Dhënave të Adresave dhe Bashkëpunim në Projekte të Reja"

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, priti Kryeshefen Ekzekutive të Postës së Kosovës, Nora Rraci, me bashkëpunëtorë.

Gjatë takimit, u diskutua për nevojën urgjente të Postës së Kosovës për të dhënat e Regjistrit të adresave, për saktësinë dhe unifikimin e këtyre informatave, si dhe për ndërlidhjen e Regjistrit të adresave me sistemet postare.

Drejtori Ahmeti shprehu gatishmërinë e AKK-së për bashkëpunim të ngushtë në këtë proces, duke informuar gjithashtu për projektet që tashmë kanë filluar dhe ato që do të fillojnë së shpejti, si krijimi i aplikacionit mobil për adresat dhe përforcimi i sistemit të adresave.

Gjithashtu, u trajtua kërkesa e Postës së Kosovës për unifikimin e emërtimeve të saj, duke përdorur një numër të saktë dhe unik për të gjitha pronat e saj në tërë territorin e Kosovës. Kryeshefja Rraci premtoi bashkëpunim të plotë për arritjen e objektivave të përbashkëta në një afat sa më të shkurtër, për të siguruar përfitime më të mëdha për qytetarët.



30 prill 2024 Ekspertët e AKK-së u trajnuan për përdorimin e Dronit Wingtra Gen II në Matje Gjeodezike dhe Kadastrale

Agjencia Kadastrale e Kosovës, si institucioni i vetëm shtetëror përgjegjës për matje gjeodezike, kadastrale dhe hartografi, është pajisur me Dronin Ēingtra Gen II, teknologjinë e fundit të droneve. Me anë të këtij droni do të prodhohen ortofoto dhe DTM/DEM me cilësi të lartë, duke përfshirë sipërfaqe të vogla, por me nevoja specifike të AKK-së. Avancimi i teknologjisë në fushën e matjeve ka krijuar mundësi të shumta dhe ka siguruar saktësi të lartë në prodhimin e ortofotove, të cilat, përveç AKK-së, do të mund të shfrytëzohen edhe nga institucione të tjera. Për të përvetësuar aftësi më të mira në përdorimin e Dronit, një grup ekspertësh të AKK-së është trajnuar nga profesionistë të fushës, në vendpunishten e magjistrales Prishtinë-Gjakovë.



30 janar 2024 Punëtorja katërditore për hartimin e Udhëzime Administrative për Ligjin e Kadastrit

Në kuadër të hartimit të Udhëzimeve Administrative për implementimin e Ligjit për Kadastër të Pronave të Paluajtshme, u organizua punëtorja katërditore nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, ku ë këtë punëtori morën pjesë ekspertët të AKK-së dhe zyrës ligjore të MMPHI-së. Punëtorja u organizua pas krijimit të grupeve punuese për këto udhëzime, të caktuara me vendime nga MMPHI. Ekspertët nga AKK dhe MMPHI, trajtuan në detaje përmbajtjen e 11 Udhëzimeve Administrative me qëllim të finalizimit të tyre.



1 shkurt 2024 Punimet e punëtorisë për hartimin e Udhëzimeve Administrative morën përkrahje edhe nga Ministri Liburn Aliu

Në ditën e fundit të punimeve në punëtorinë për hartimin e Udhëzimeve Administrative për Ligjin për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, e vizitoi Ministri i MMPHI-së Liburn Aliu. Drejtori ekzekutiv i AKK-së Avni Ahmeti i prezantoi Ministrin progresin e punës sa i përket trajtimit të Udhëzimeve Administrative dhe fokusin e AKK-së që draftet finale të përfundohen brenda një afati shumë të shkurtër kohor.

Ministri Aliu në fjalën e tij tha se që beson që me fuqizimin e këtyre udhëzimeve po krijohen kushte për krijimin e kadastrit të rregullt, meqë pa kadastër të saktë dhe të rregullt nuk do të kishte as zhvillim ekonomik dhe as qëndrueshmëri financiare vendi, ku në fund premtoi mbështetje për AKK-në edhe në procedurat e mëtutjeshme deri në aprovimin e udhëzimeve.

Pjesë e punimeve ishin edhe përfaqësues nga USAID, ku në fjalën e saj Drejtoresha e Aktivitetit për Qeverisje Pronësore Jeniffer Ober vlerësoi lart progresin e punimeve të punëtorisë dhe falënderoi AKK-në, për bashkëpunimin e shkëlqyer në kuadër të projektit të USAID-it. Drejtori ekzekutiv i AKK-së, Avni Ahmeti falënderoi Ministrin Liburn Aliu për vizitën dhe mbështetjen që i ka ofruar AKK-së në vazhdimësi.



6 shkurt 2024 Punëtori dy ditore AKK, USAID, ZKK-Gjakovë në kuadër të Aktivitetit Qeverisja e Pronës

Agjencia Kadastrale e Kosovës në bashkëpunim me USAID-in, organizuan punëtori dy ditore me Komunën e Gjakovës për të prezantuar: të arriturat, sfidat e rekomandimet për ZKK-në në fushën e të drejtave pronësore si dhe për rritjen e cilësisë së shërbimeve kadastrale.

Në këtë punëtori përveç përfaqësuesve të Agjencisë Kadastrale e Kosovës, përfaqësuesve nga Aktiviteti për Qeverisje Pronësore i USAID-it dhe ZKK-së Gjakovë pjesëmarrës ishin edhe zyrtarë e drejtorë edhe nga drejtori të tjera komunale si ajo e Administratës, Urbanizmit, etj.

Punëtorinë e mbështeti edhe niveli udhëheqës i Komunës së Gjakovës nëpërmjet Kryetarit të Komunës Z. Ardian Gjini, i cili në fjalën e tij theksoi rëndësinë e ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qytetarët e komunës, specifikisht rëndësinë e shërbimeve kadastrale sa më cilësore për të gjithë.

Temë qendrore e diskutimit ishin gjetjet në Raportin e USAID-it për ZKK-në e Gjakovës, në lidhje me organizimin e brendshëm të ZKK-së, rrjedhën e punës së lëndëve, dorëzimin e kërkesave në dy sportele, respektimin e afateve kohore, si dhe kushtet e punës.

Nga kjo punëtori ZKK-ja mori të gjitha rekomandimet dhe hapat që duhet të ndërmerë në drejtim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarë, llojin dhe natyrën e kërkesave që duhet drejtuar drejtorive tjera dhe zyrës së kryetarit për përkrahje, mënyrën e riorganizimit dhe ndryshimeve në staf, si dhe rekomandime të tjera që ndërlidhen me përshtetimin e punës brenda ZKK-së.



9 shkurt 2024 Punëtori dy ditore AKK, USAID, ZKK-Mitrovicë në kuadër të Aktivitetit Qeverisja e Pronës

Agjencia Kadastrale e Kosovës në bashkëpunim me USAID-in, organizuan punëtori dy ditore me Komunën e Mitrovicës për të prezantuar: të arriturat, sfidat e rekomandimet për ZKK-në në fushën e të drejtave pronësore si dhe për rritjen e cilësisë së shërbimeve kadastrale.

Këtë radhë si komunë partnere ishte Komuna e Mitrovicës dhe në punëtori përveç përfaqësuesve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, përfaqësuesve nga Aktiviteti për Qeverisje Pronësore i USAID-it dhe Zyres Kadastrale Komunale të Mitrovicës, pjesëmarrës ishin edhe zyrtarë e drejtorë nga drejtori të tjera komunale si ajo e Tatimit në Pronë, Urbanizmit, etj.

Punëtorinë e mbështeti edhe niveli udhëheqës i Komunës së Mitrovicës nëpërmjet Shefit të Kabinetit të Kryetarit Z.Valon Hetemi, i cili në fjalën e tij theksoi rëndësinë e ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qytetarët e komunës, duke vlerësuar edhe këtë aktivitet si ndihmë për administratën në rritjen e performancës.

Temë qendrore diskutimi ishin gjetjet në Raportin e USAID-it për ZKK-në e Mitrovicës, në lidhje me organizimin e brendshëm të ZKK-së, rrjedhën e punës së lëndëve, respektimin e afateve kohore, kushtet e punës, mungesa e stafit, etj.



12 shkurt 2024 Punimet e punëtorisë për hartimin e Udhëzimeve Administrative morën përkrahje edhe nga komuna e Prishtinës

Në një takim të përbashkët informues, Agjencia Kadastrale e Kosovës ftoi drejtorët e ZKK-ve të regjionit të Prishtinës, me ç'rast drejtori ekzekutiv Avni Ahmeti në fjalën e tij theksoi ndryshimet që parasheh ky Ligj e gjithashtu i informoi të pranishmit edhe për punën që AKK-ja ka bërë në Projekt Udhëzimet Administrative.



13 shkurt 2024 Punimet e punëtorisë për hartimin e Udhëzimeve Administrative morën përkrahje edhe nga rajoni i Gjilanit

Në një takim të përbashkët informues, Agjencia Kadastrale e Kosovës ftoi drejtorët e ZKK-ve të Gjilanit, me ç'rast drejtori ekzekutiv Avni Ahmeti në fjalën e tij theksoi përveç informimit për Ligj dhe Udhëzime administrative, shfrytëzoi rastin që në këtë takim të i informoi të pranishmit edhe për projektet e AKK-së që kanë filluar realizimin, ato që janë në prag të finalizimit si dhe ato që pritet të fillojnë shumë shpejt.



15 shkurt 2024 Përmbyllja me sukses e punimeve të punëtorive me drejtorë të ZKK-ve për Ligjin për Kadastër të Pronave të Paluajtshme dhe Projekt Udhëzimeve Administrative (OSBE — 3 takime)

Organizuar nga AKK-ja dhe mbështetur nga OSBE-ja, në fund, u përmbyllën me sukses punimet e punëtorive me drejtorë të ZKK-ve, për Ligjin për Kadastër të Pronave të Paluajtshme dhe Projekt Udhëzimeve Administrative.

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti në fjalën e tij përveç informimit për Ligj dhe Udhëzime Administrative, shfrytëzoi rastin që në këtë takim të shfrytëzoi rastin që në këtë takim të informoi të pranishmit edhe për projektet e AKK-së që kanë filluar realizimin, ato që janë në prag të finalizimit si dhe ato që pritet të fillojnë shumë shpejt.

Edhe nga drejtorët e komunave nga regjioni i Pejës dhe Prizrenit, z.Ahmeti kërkoi bashkëpunim dhe mbështetje për realizim sa më të mirë të projekteve të lartcekura, por edhe kontributin e tyre edhe me komente për Udhëzimet Administrative.

Gjithashtu në punëtorinë e fundit, u prezentuan shkurtimisht edhe punët dhe aktivitetet e ZKK-ve, statistika për numrin e lëndëve, të hyrat e inkasuara si dhe sfidat e projektet e planifikuara për të ardhmen.



Mbështetja e OSBE-së për AKK-në me praktikantë në Zyren Ligjore

Edhe vitin që e lamë pas, në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes për AKK-në nga OSBE-ja, vazhdoi mbështetja dhe krijimi i mundësisë për punë praktike për të posadiploмуarit në Fakultetin Juridik në zyrën ligjore të AKK-së.

Puna praktike e tyre me një planifikim të zgjatjes prej 1 viti nga data e nënshkrimit të kontratave, përveç pjesës së aftësimin të tyre, të njejtit do të mund ta mbështesin AKK-në edhe në punë e aktivitete të ndryshme në kuadër të institucionit.



3 maj 2024 Shpërndarja e licencave për gjeodetë dhe kompani gjeodete

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës Avni Ahmeti, ka shpërndarë licencat për gjeodetë dhe kompani gjeodete gjatë gjithë vitit 2024, me ç'rast kandidatët për licencim fillimisht kanë ndjekur trajnimet nga stafi i AKK-së, ku më pastaj i janë nënshtruar procesit të licencimit, respektivisht pas plotësimit të kushteve për licencim, ata janë pajisur me licenca.

21 maj 2024 Agjencia Kadastrale e Kosovës Organizoi Punëtori për Krijimin e Udhëzuesve të Punës pas Aprovimit të Ligjit për Kadastër

Pas miratimit të Ligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme dhe fuqizimit të Udhëzimeve administrative që rrjedhin nga ky ligj, Agjencia Kadastrale e Kosovës organizoi punëtori disa ditore për krijimin e Udhëzuesve të Punës, të cilat do të definojnë procedurat dhe detajet teknike të përcaktuara nga legjislacioni i sapo miratuar.

Pjesëmarrës në punëtori, përveç ekspertëve të AKK-së, ishin edhe zyrtarë të Drejtorive të Kadastres dhe Urbanizmit, si dhe gjeodetë nga sektori privat.

Synimi i kësaj punëtorie ishte të definojë me saktësi standardet dhe procedurat për regjistrimin e të drejtave pronësore, azhurnimin e Kornizës së Punës, krijimin e doracakëve të rinj për informimin më të mirë të qytetarëve për procedurat, afatet dhe shërbimet kadastrale. Punimet e kësaj punëtorie u mbështetën nga Aktiviteti për Qeverisje Pronësore i USAID-it.



13 dhjetor 2024 Takimi Informues dhe Koordinues për Sistemin e Adresave Zyrtare dhe Kadastrin e Përçojave

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), u mbajt takimi informues dhe koordinues me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve dhe kompanive relevante, ku u diskutua mbi përdorimin e adresave zyrtare dhe unike, si dhe rëndësinë e ndërveprueshmërisë mes institucioneve për të dhënat e nevojshme për krijimin e Kadastrit të Përçojave.

Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Avni Ahmeti, theksoi rëndësinë e përdorimit të adresave zyrtare nga institucionet dhe kompanitë për rritjen e efikasitetit dhe saktësisë së shërbimeve publike. Ai bëri thirrje për një bashkëpunim më të ngushtë dhe për dërgimin e të dhënave të përçojave nga institucionet dhe kompanitë relevante.

Zv. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil, z. Erdon Arifaj, nënvizoi rëndësinë e lidhjes së qytetarëve me adresat e tyre zyrtare, proces që është në zhvillim dhe do të kontribuojë në përmirësimin e shërbimeve.

Zyrtarët e AKK-së prezantuan dy tema kryesore: Sistemin e Adresave dhe Kadastrin e Përçojave, duke ndarë informacione të detajuara mbi progresin dhe përfitimet që vijnë nga përdorimi i të dhënave të adresave, si dhe rëndësinë e krijimit të kadastrit të përçojave.


Diskutimet përfunduan me një konsensus për rëndësinë e vazhdimin të takimeve dhe koordinimeve të rregullta për të arritur objektivat e planifikuara.



17 | PËRMBYLLJE

Me rastin e përmbylljes së suksesshëm të vitit 2024, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka vlerësuar punën dhe përkushtimin e stafit duke shpërblyer Punëtorin e Vitit dhe duke ndarë Mirënjohje për zyrtarë të dalluar të AKK-së.

Znj. Drenushë Januzi Kukaj është shpallur Punëtorja e Vitit, me ç'rast është vlerësuar për angazhimin e saj të palodhshëm, arritjet dhe kontributin e rëndësishëm në sukseset e institucionit gjatë gjithë vitit që e lamë pas.



Gjithashtu, me Mirënjohje për punën dhe kontributin e tyre u shpërblyen:

Faik Kelmendi
Nadir Shyqeriu
Sandra Jaka Muja

Ardita Megjuani
Kujtim Mustafa
Vjollca Aliu
Reshat Murati

Leonora Hajdari
Naim Nishori
Xhevat Azemi











PLANI I PUNËS PËR VITIN 2025


Avni Ahmeti, drejtori ekzekutiv i AKK-së, në fjalën e tij falënderoi jo vetëm të shpërblyerit, por të gjithë stafin e Agjencisë për një vit plot sfida dhe suksese, duke theksuar se 2024 ka qenë një vit historik për AKK-në, falë një sërë reformash transformuese dhe projekteve që kanë përmirësuar cilësinë e shërbimeve për qytetarët e Kosovës.

Ndër sukseset kryesore të vitit, drejtori përmendi:

Realizimin e dhjetëra projekteve të rëndësishme infrastrukturore dhe digjitale që kanë rritur efikasitetin në administratën kadastrale, publikimin e Udhëzimeve Administrative dhe Udhëzuesve të Punës, organizimin e Konferencës së Parë për Digjitalizimin e Shërbimeve Kadastrale, e cila ka pozicionuar Kosovën si një lider rajonal në këtë fushë, anëtarësimin në Land Portal, duke e bërë Kosovën pjesë të një rrjeti global prej mbi 100 shteteve që ndajnë praktikat më të mira për transparencën dhe qasjen në të dhënat gjeohapësinore.

Kjo ceremoni ishte një dëshmi e përkushtimit të AKK-së për të krijuar një kulturë motivuese dhe për të forcuar bashkëpunimin reciprok, përmes vlerësimit të punës së përbashkët.

AKK do të vazhdojë të jetë një shembull frymëzues i efikasitetit dhe inovacionit, gjithnjë në shërbim të qytetarëve.



18

18 | PLANI I PUNËS PËR VITIN 2025

REFORMAT DHE PROJEKTET

Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e saja, Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë vitit 2025 do të vazhdojë me dinamikën e implementimit të aktiviteteve të filluara gjatë vitit 2024 për zhvillimin dhe modernizimin e Kadastrit, sipas Strategjisë dhe Planit të Biznesit të AKK-së 2021-2025.

Këto aktivitete kryesisht janë pjesë e projektit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP), i financuar nga kredia e Bankës Botërore. Ky projekt ka për qëllim të sigurojë mbështetje ligjore dhe institucionale për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, vazhdimin e punëve për rindërtimin e kadastrit në 115 Zona Kadastrale, krijimin e kadastrit të përçojave, zhvillimin e mëtutjeshëm të kadastrit të ndërtesave, përmirësimin e cilësisë së të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë (SIKTK), kompletimin e Sistemit të Adresave, zhvillimin e mëtejshëm të Teknologjisë Informative të AKK-së, dhe zbatimin e Strategjisë së Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH) në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu Agjencia Kadastrale gjatë vitit 2025 planifikon të vazhdojë edhe me zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit të nivelimit, futjen në SIKTK të elaborateve të shpronësimit, ngritjen në 3D të objekteve, avancimin e Infrastrukturës së TI-së, mirëmbajtjen e SIKTK-së etj.

Nr.	Aktivitetet kryesore	Periudha Kohore
1.	Hartimi i strategjisë për implemetimin e ligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme	2025
2.	Korrektimi i të dhënave në SIKTK	2025 - 2026
3.	Rindërtimi i Kadastrit, në 115 Zona Kadastrale	2025 - 2026
4.	Kontrolli i Kualitetit për projektin e Rindërtimit të Kadastrit	2025 - 2026
5.	Implementimi i Planit të Veprimit për Informim Publik	2024 - 2026
6.	Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave grafike në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit të Ndërtesave	2024 - 2025
7.	Skanimi i Dokumenteve Arkivore Kadastrale	2024 - 2025

8.	Zhvillimi i pilot projektit si dhe regjistrimi i të dhënave për kadastrin e përçojave në 3 qytete	2025 -2026
9.	Renovimi i Zyreve Kadastrale Komunale në Komunitat Veriore të Republikës së Kosovës	2025 - 2026
10.	Regjistrimi i ndërtesave dhe banesave në Komunitat Veriore të Republikës së Kosovës	2025 - 2026
11.	Prodhimi dhe instalimi i tabelave me adresa të rrugëve dhe numrave të hyrjeve të objekteve	2024 - 2025
12.	Finalizimi i sistemit të adresave në Komunitat Veriore	2025 - 2026
13.	Lidhja e sistemit të adresave me regjistrin civil	2024 - 2025
14.	Zhvillimi i mobil aplikacionit/navigacionit për Kosovë (ARIS Mobile)	2025 -2026
15.	Zhvillimi i gjeoportalit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacionit Hapësinor dhe gjeoportalit shtetëror	2024 - 2025
16.	Avancimi i Sistemeve Kadastrale	2024 - 2025
17.	Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive	2025 - 2026
18.	Ngritja 3D e objekteve	2025
19.	Analizimi, korrigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaborateve të shpronësimit	2025
20.	Mirëmbajtja e sistemit të informacioneve kadastrale të tokave të Kosovës	2025-2026
21.	Avancimi i Infrastrukturës së TI-së	2025 - 2026



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

*Për përpilimin e këtij raporti, ka kontribuar i gjithë ekipi i jashtëzakonshëm nga Agjencia Kadastrale e Kosovës,
të cilët kanë ofruar ekspertizën dhe dedikimin e tyre të paçmuar në secilën prej kapitujve.*

